



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

RAPORT VJETOR
2020

PËRMBAJTJA

MESAZHI I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV	4
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE	6
BORDI I AUTORITETIT	7
PËRBALLJA E TREGJEVE NËN MBIKËQYRJE ME SITUATËN E PANDEMISË COVID – 19	8
NGJARJET E TËRMETIT TË VITIT 2019 DHE NDIKIMET NË TREGUN E SIGURIMEVE GJATË VITIT 2020	10
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE: NGJARJET KRYESORE TË VITIT 2020	12

Kapitulli 1

1 ECURIA E TREGJEVE NËN MBIKËQYRJE	15
1.1 Tregu i Kapitaleve dhe Fondeve të Investimit	15
1.2 Tregu i Sigurimeve	17
1.3 Tregu i Fondeve të Pensioneve Vullnetare	19

Kapitulli 2

2 AKTIVITETI MBIKËQYRËS	20
2.1 Mbikëqyrja e Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve të Investimit	20
2.1.1 Pozicioni Financiar	20
2.1.2 Inspektimet	25
2.2 Mbikëqyrja e Tregut të Sigurimeve	26
2.2.1 Pozicioni Financiar	26
2.2.2 Inspektimet	33
2.2.3 Mbikëqyrja e Grupeve	34
2.2.4 Provigjonet Teknike	35
2.2.5 Risigurimet	39
2.2.6 Ecuria e Fondit të Kompensimit	42
2.3 Mbikëqyrja e Tregut të Fondeve të Pensionit Vullnetar	43
2.3.1 Pozicioni financiar	43
2.3.2 Inspektimet	49

Kapitulli 3

3 AKTIVITETI RREGULLUES DHE LICENCUES	50
3.1 Rregullimi i Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve të Investimit	50
3.2 Rregullimi i Tregut të Sigurimeve	53
3.3 Rregullimi i Tregut të Fondeve të Pensionit	54
3.4 Licencimi dhe Qeverisja	55
3.4.1 Tregu i Fondeve	55
3.4.2 Tregu i Kapitalit	58
3.4.3 Tregu i Sigurimeve	58

3.5	Masat Mbikëqyrëse dhe Administrative	62
-----	--------------------------------------	----

Kapitulli 4

4 PROCESET INTEGRUESE E BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL 64

4.1	Proceset integruese për tregjet nën mbikëqyrje	64
4.2	Parandalimi i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit	65
4.3	Bashkëpunimi Rajonal dhe Ndërkombëtar	66
4.4	Projekte	70
4.5	Bashkëpunimi me Institucionet e Vendit	72

Kapitulli 5

5 MBROJTJA KONSUMATORE DHE TRANSPARENCA ME PUBLIKUN 73

5.1	Mbrojtja e Konsumatorit dhe Investitorit	73
5.2	Monitorimi i Ndërmjetësve Financiarë	76
5.3	Edukimi Financiar	77
5.4	Transparenca dhe Marrëdhëniet me Publikun	78

Kapitulli 6

6 ORGANIZIMI INSTITUCIONAL 81

6.1	Burime Njerëzore	81
6.2	Sistemet e Teknologjisë së Informacionit	83
6.3	Auditi i Brendshëm	86

STRATEGJI DHE OBJEKTIVA 87

SHTOJCA 90

MESAZHI I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Viti 2020 ishte një vit i vështirë dhe i pazakontë për ekonominë dhe sektorin financiar. Efektet e gjithanshme të pandemisë COVID-19 dhe pasojat e tërmeteve të fundvitit 2019 ishin sfiduese për autoritetet rregullatore financiare, roli i të cilëve në situata të tilla të jashtëzakonshme bëhet edhe më i rëndësishëm për ruajtjen e stabilitetit, garantimin e vijueshmërisë së veprimtarisë së subjekteve nën mbikëqyrje dhe mirëfunksionimin e tregjeve.

Sektori financiar jobankar, edhe pse pati luhatje të treguesve në fillimet e pandemisë, vlerësohet se u rezistoi ndikimeve. Tregjet nën mbikëqyrjen e Autoritetit paraqiten të qëndrueshëm, me tregues të mirë të likuiditetit e të shëndetit financiar, si edhe të mbulimit me provigjone.

Gjatë vitit 2020 u realizua pjesa më e madhe e pagesave të dëmshpërblimit të tërmeteve. Vlera e përgjithshme e dëmeve llogaritet në 4.7 miliardë lekë, për 6295 praktika të raportuara, ku deri në fund të vitit 2020 janë paguar 90% e tyre. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka monitoruar në vijimësi procesin e pagesave të dëmshpërblimit të tërmeteve, si edhe ka mbajtur komunikim me të gjitha palët e përfshira. Përsa i përket nivelit të ekspozimit ndaj rrezikut, konstatohet se ngjarjet e tërmetit nuk kanë patur efekt të konsiderueshëm në marrëveshjet e risigurimit.

Më gjerë, në përgjigje të situatës së jashtëzakonshme pandemike, AMF mori një sërë masash në funksion të garantimit të stabilitetit financiar dhe vijueshmërisë së veprimtarisë së operatorëve të tregjeve nën mbikëqyrje. Në tre-mujorin e dytë, Autoriteti intensifikoi monitorimin e treguesve të likuiditetit të shoqërive të sigurimit dhe të shlyerjeve neto nga fondet e investimeve. Gjithashtu, në linjë me rekomandimet e rregullatorëve evropianë, Autoriteti u kërkoi shoqërive të tregjeve nën mbikëqyrje që të përditësojnë dhe të kenë funksionale planet e vijimësisë së veprimtarisë dhe planet e përballimit të krizave, ndërkohë që rishikoi dhe miratoi planin e tij të vazhdimësisë së aktivitetit në raste të jashtëzakonshme. Për ruajtjen e gjendjes së likuiditetit, me vendim të Autoritetit, u shty shpërndarja e dividendit për shoqëritë e sigurimit. Bordi i Autoritetit miratoi një udhëzim të posaçëm për shoqëritë e tregjeve nën mbikëqyrje, me qëllim sigurimin e qëndrueshmërisë, si edhe rritjen e transparencës në funksion të mbrojtjes së konsumatorit dhe investitorit.

Sa i përket ecuresë së tregjeve, totali i aktiveve në tregun e fondeve të investimeve, sigurimeve dhe fondeve të pensioneve private vullnetare u rrit me 1%, duke arritur vlerën 110 miliardë lekë, ose 6.8% e PBB-së. Tregu i sigurimeve shënoi rënie të të ardhurave me 5.73% dhe rritje të pagesave të dëmeve me 17.45%, kryesisht si rrjedhojë e dëmshpërblimeve në kategorinë e sigurimit nga zjarri dhe forcat e natyrës. Tregu i fondeve të investimeve u rrit me 0.9% në vitin 2020, duke arritur vlerën neto të aktiveve 67.4 miliardë lekë. Edhe tregu i fondeve të pensioneve private u rrit me 23.8%, por ende mbetet në një nivel modest për sa i përket vlerës së aktiveve neto prej 3.6 miliardë lekë.

Në aspektin rregullator, ligjet e reja të miratuara në vitin 2020 nga Kuvendi (“Për Tregjet e Kapitalit”, “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive” dhe “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”), si edhe Ligji “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” i miratuar në vitin 2021, riformatojnë dhe modernizojnë shtyllat kryesore të mbikëqyrjes së Autoritetit. Miratimi në vijimësi i akteve nënligjore nga AMF do të plotësojë kuadrin ligjor dhe rregullator për këto tregje.

Gjatë vitit 2021 do të synohet avancimi i mëtejshëm i praktikave mbikëqyrëse dhe kuadrit rregullator, në funksion të rritjes së cilësisë në mbikëqyrje dhe zhvillimit të tregjeve. Autoriteti do të përmbyllë procesin e hartimit të akteve rregullatore në zbatim të ligjeve të reja, për të krijuar të gjithë infrastrukturën e nevojshme për mirëfunksionimin e tregjeve. Procesi i digjitalizimit dhe modernizimit të sistemeve të teknologjisë së informacionit do të thellohet më tej si nevojë për rritjen e efikasitetit në mbikëqyrje. Diversifikimi dhe evoluimi i tregjeve, mbrojtja e konsumatorëve dhe investitorëve, si dhe avancimi drejt mbikëqyrjes së plotë me fokus rrezikun mbeten prioritetet e Autoritetit.

Ervin METE

Drejtore i Përgjithshëm Ekzekutiv

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) u krijua në bazë të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si institucion juridik publik, i pavarur në ushtrimin e kompetencave të tij, që raporton në Kuvendin e Shqipërisë.

Ai licencon, rregullon dhe mbikëqyr aktivitetin e tregut të sigurimeve, tregut të letrave me vlerë, tregut të fondeve të pensioneve vullnetare dhe operatorëve të tyre, si dhe veprimtari të tjera financiare jobankare.

Misioni themelor i Autoritetit është të sigurojë funksionimin efektiv të tregjeve financiare jobankare nën mbikëqyrje, si dhe stabilitetin, promovimin dhe zhvillimin e tyre. Përmbushjen e misionit të tij, Autoriteti e ushtron me anë të funksionit rregullativ dhe mbikëqyrës. Objektivi parësor i Autoritetit, i cili udhëheq këto dy funksione është Mbrojtja e Interesave të Konsumatorit dhe Investitorit. Në ushtrimin e funksionit rregullativ dhe mbikëqyrës, AMF udhëhiqet nga parimet dhe normat e pavarësisë, transparencës dhe integritetit.

BORDI I AUTORITETIT

Në vitin 2020, Bordi i Autoritetit përbëhej nga:

Kryetar: Z. Ervin Mete¹
Anëtarë: Z. Ervin Mete / Ervin Koçi² Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv
 Znj. Mimoza Kaçi³, Nëndrejtor Ekzekutiv
 Z. Ildir Gjata, Anëtar Joekzekutiv
 Z. Deniz Deralla, Anëtar Joekzekutiv

Bordi i Autoritetit, me qëllim përmbushjen e detyrave dhe funksioneve të tij, gjatë vitit 2020, ka zhvilluar 15 mbledhje dhe ka marrë 216 vendime. Numri më i madh i vendimeve, lidhet me tregun e sigurimeve. Vendime të rëndësishme janë marrë për tregun e sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe në tregun e titujve për shkak edhe të miratimit të ligjeve të reja në këto tregje. Me qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, janë nënshkruar disa marrëveshje, me institucione brenda dhe jashtë vendit.

Duke patur në fokus përmirësimin dhe plotësimin e kuadrit rregullator që rregullon veprimtarinë e tregjeve të mbikëqyrura, Bordi i Autoritetit ka miratuar 12 rregullore, 2 udhëzime, si dhe ka ndryshuar 14 rregullore ekzistuese.

Tabelë 1: Ndarja e vendimeve të Bordit të AMF-së sipas llojit të vendimit

<i>Llojet e vendimeve</i>	<i>Numër</i>
Vendime për shoqëritë që veprojnë në tregun e sigurimeve	101
Vendime për Bursën dhe shoqëritë që veprojnë në tregun e letrave me vlerë	15
Vendime për shoqëritë që veprojnë në tregun e pensioneve private vullnetare dhe SIK	27
Vendime për bashkëpunimin institucional	5
Vendime për masa administrative e korrigjuese ndaj subjekteve të mbikëqyrura	18
Vendime për kuadrin rregullues të AMF-së dhe tregjeve të mbikëqyrura	50
<i>Vendime në tërësi</i>	<i>216</i>

¹ Z. Ervin Mete ka qëndruar në detyrë si Kryetar i Bordit deri më datë 28.05.2020, kur emërohet nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv.

² Mandati i z. Ervin Koçi, i emëruar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfundoi më datë 25.03.2020.

³ Znj. Mimoza Kaçi është emëruar në pozicionin e Nëndrejtorit Ekzekutiv nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë më datë 07.10.2020.

PËRBALLJA E TREGJEVE NËN MBIKËQYRJE ME SITUATËN E PANDEMISË COVID-19

Në përgjigje të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19, Autoriteti gjatë vitit 2020 ka qenë në monitorim të vazhdueshëm të zhvillimeve në tregjet nën mbikëqyrje dhe ka vlerësuar rregullisht ndikimin e pandemisë në këto tregje.

Situata financiare e shoqërive të sigurimit u paraqit me një nivel të përshtatshëm likuiditeti, duke ruajtur treguesit financiarë në nivel tregu. Në kuadër të situatës së krijuar nga përhapja e pandemisë COVID-19, Autoriteti ka kërkuar nga shoqëritë administruese të SIK informacion në lidhje me planet e veprimit ose masat konkrete të ndërmarra prej tyre. Gjithashtu shoqërive administruese iu kërkuan hapat konkrete që do të ndërmerrnin në zbatim të planeve të tyre të vazhdimësisë së biznesit (BCP), në rast se situata do të përshkallëzohej. Gjithashtu, në fund të muajit mars 2020, shoqëritë administruese të SIK me kërkesë të Autoritetit rritën frekuencën e raportimit të flukseve të shlyerjeve neto nga dyjavore në ditore, si dhe të treguesit të likuiditetit nga tremujore në javore. Gjithashtu, me frekuencë ditore është monitoruar edhe ecuria e çmimeve të kuotave të fondeve të investimit.

Nga monitorimi i raportimeve të bëra nga shoqëritë administruese të Sipërmarrjeve të Investimeve Kollective, edhe pse u vu re një rritje në flukset dalëse të fondeve të investimit, kryesisht në fondet me një historik të gjatë në treg, në asnjë prej fondeve të investimit flukset dalëse nuk ju afruan skenarëve që shoqëritë administruese kanë parashikuar për raste krizash. Në lidhje me luhatjen në çmimet e kuotave gjatë vitit 2020 u vu re se vetëm fondet të cilat kanë investuar në tregjet e huaja jashtë Republikës së Shqipërisë pësuan luhatje më të mëdha. Si pasojë e këtyre luhatjeve, dy fonde gjatë vitit 2020 patën një ndryshim në rritje të treguesit të rrezikut sintetik. Treguesit e likuiditetit për të gjitha fondet e investimit gjatë vitit 2020 kanë qenë në përputhje me kërkesat e bazës rregullatore për likuiditetin.

Në tregun e kapitaleve dhe në tregun e fondeve të pensioneve vullnetare nuk janë evidentuar problematika të shkaktuara nga situata COVID-19. Gjatë vitit 2020, edhe në kushtet e pandemisë së COVID-19, anëtarët e skemave të pensioneve vullnetare kanë vazhduar të derdhin kontribute në fondet e pensionit. Monitorimi i tregjeve është kryer duke marrë të dhëna nëpërmjet komunikimeve të vazhdueshme me shoqëritë administruese dhe raporteve periodike të depozituara në Autoritet, ku është vëzhguar ecuria e treguesve të veçantë të këtyre tregjeve.

Në përgjithësi, gjatë vitit 2020 situata në tregjet financiare jobankare nën mbikëqyrjen e Autoritetit u paraqit e stabilizuar dhe pa efekte negative në sistemin financiar në tërësi. Subjektet nën mbikëqyrje vijuan rregullisht biznesin e tyre.

Sikurse të gjithë rregullatorët në nivel global, edhe Autoriteti ndërmori një sërë masash për të adresuar efektet e pandemisë në tregjet nën mbikëqyrje. Kështu, me qëllim ruajtjen e nivelit të likuiditetit dhe treguesve financiarë të aftësisë paguese dhe të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike, në funksion të mbrojtjes të interesave të policëmbajtësve Autoriteti miratoi Vendimin nr. 56, datë 10.04.2020 “Mbi marrjen e masave nga shoqëritë e sigurimeve për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19”, mbi bazën e të cilit u kërkoi shoqërive të sigurimit pezullimin e shpërndarjes së dividendit, si edhe zbatimin e një qasje të kujdesshme në lidhje me shpërblimet e stafit, duke i shtyrë ato në kohë. Ky vendim ishte në linjë me rekomandimet e Autoritetit Evropian Rregullator të Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA), për të rikuperuar luhatjet e mundshme në nivelin e kapitalit, si dhe me qëllim që likuiditetet e disponueshme të mbeten në sistem.

Në fund të muajit mars 2020, për shoqëritë administruese të fondeve të investimit, Autoriteti kërkoi rritjen e frekuencës së raportimit të flukseve të shlyerjeve neto nga dyjavore në ditore si dhe të treguesit të likuiditetit nga tremujore në javore. Gjithashtu, me frekuencë ditore është monitoruar edhe ecuria e çmimeve të kuotave të fondeve të investimit.

Përsa i përket tregut të kapitaleve, në funksion të kërkesave rregullatore për transparencë dhe mbrojtje të investitorit, Autoriteti në përputhje edhe me rekomandimet e Autoritetit Evropian të Titujve dhe Tregjeve (ESMA) sugjeroi që në rubrikën e risqeve që përmban prospekti i emetuesit të titujve të borxhit, të bëhet i njohur për investitorin edhe çdo informacion i rëndësishëm mbi efektet e COVID-19 në performancën e aktivitetit të emetuesit. Po kështu, u miratua Udhëzimi nr. 94 datë 29.07.2020 "Për pritshmëritë rregullatore ndaj subjekteve nën mbikëqyrje, për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19". Udhëzimi përmban një sërë kërkesash ndaj subjekteve nën mbikëqyrje me qëllim sigurimin e integritetit të tregjeve, ruajtjen e shëndetit dhe stabilitetit financiar të tyre, si dhe me qëllim rritjen e transparencës dhe mbrojtjen e investitorit dhe konsumatorit.

Masat e marra nga Autoriteti në kuadër të këtij udhëzimi konsistuan kryesisht në:

- Kërkesën ndaj operatorëve të tregjeve nën mbikëqyrje për zbatimin, testimin përditësimin dhe depozitimin në Autoritet të Planeve të Vazhdimësisë së Biznesit me qëllim sigurimin e vijimit të veprimtarisë së tyre;
- Kërkesën ndaj të gjithë operatorëve të tregjeve nën mbikëqyrje për implementimin e kujdesshëm të planeve të përballimit të krizave, ku të detajohen të gjithë elementët teknikë, logjistikë, njerëzorë dhe financiarë për përballimin e efekteve të mundshme;
- Kërkesën për raportim nga ana e operatorëve të tregjeve nën mbikëqyrje mbi planin e masave të marra prej tyre në përgjigje të situatës COVID-19;

- Kërkesën ndaj subjekteve nën mbikëqyrje për të përditësuar faqet zyrtare të internetit, me seksione të dedikuara lidhur me ndikimin e pandemisë shkaktuar nga COVID-19, duke pasqyruar dhe masat e marra nga vetë shoqëritë;
- Kërkesën ndaj shoqërive të sigurimit për rishikimin e kushteve të kontratave të sigurimit, për të reflektuar çdo ndryshim të ekspozimit ndaj risqeve gjatë periudhës së pandemisë;
- Vlerësimin nga shoqëritë e sigurimit të produkteve të cilat mund të ndikohen nga pandemia duke informuar personat e siguruar;
- Shtimin e vëmendjes ndaj administrimit të rrezikut dhe vijimin e zbatimit dhe monitorimit të kërkesave rregullatore për shoqëritë administruese;
- Rritjen e kërkesës ndaj shoqërive administruese të fondeve të investimit për të përditësuar dokumentin që përmban informacion kyç për investitorin (KIID), në rast se ka ndryshuar rreziku sintetik.

Në zbatim të këtij udhëzimi të Autoritetit, të gjitha subjektet nën mbikëqyrje kanë përditësuar planet e vazhdimësisë së biznesit si dhe kanë miratuar plane të posaçme masash për t'iu përgjigjur situatës në kushtet e pandemisë. Shoqëritë e sigurimit që ushtrojnë aktivitetin në klasat e Jetës kanë përditësuar procesin e marrjes në sigurim, me fokus rritjen e transparencës dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorit. Gjithashtu, shoqëritë e sigurimit kanë përditësuar kushtet e përgjithshme të kontratave me qëllim qartësimin e rasteve përjashtimore në kontratat e produkteve vullnetare, si ato të Jetës dhe shëndetit.

Fokusi i Autoritetit do të vijojë të jetë monitorimi i vazhdueshëm i treguesve të shëndetit financiar të subjekteve nën mbikëqyrje, si dhe nxitja e zhvillimeve të reja në drejtim të krijimit të produkteve dhe shërbimeve inovative nëpërmjet digjitalizimit.

NGJARJET E TËRMETIT TË VITIT 2019 DHE MONITORIMI I TRAJTIMIT TË KËRKESAVE PËR DËMSPËRBLIM

Me ndodhjen e dy ngjarjeve të tërmetit gjatë vitit 2019 në Shqipëri, me pasoja të rënda në jetë të humbura dhe dëme materiale, Autoriteti rriti frekuencën e raportimit të trajtimit të kërkesave për dëmshpërblim nga ana e shoqërive të sigurimit që ushtrojnë aktivitetin në klasat e Jo-Jetës.

Me kërkesë të posaçme të Autoritetit, shoqëritë e sigurimit kanë raportuar me bazë javore ecurinë e trajtimit të kërkesave për dëmshpërblim si dhe rimbursimin e kryer nga risiguruesit për të dy ngjarjet e tërmetit. Informacioni i raportuar, për qëllime mbikëqyrjeje, është monitoruar nga Autoriteti, si dhe është ndarë me Komitetin Ndërmnistror për Emergjencat Civile. Gjithashtu, gjatë vitit 2020, janë kryer takime me përfaqësuesit e shoqërive të sigurimit ku është diskutuar në lidhje me procesin e trajtimit të kërkesave për dëmshpërblim, mbajtjen maksimale për shoqëri sigurimi, si dhe mbulimin maksimal nga risiguruesit. Në vijim janë kryer inspekte tematike

pranë shoqërive të sigurimit në lidhje me verifikimin e trajtimit të kërkesave për dëmshpërblim për ngjarjet e tërmetit.

Për ngjarjet e tërmetit, duke qenë ngjarje me probabilitet të ulët, por me ndikim të lartë në rast ndodhjeje, Autoriteti vlerëson me baza gjashtëmujore ekspozimin e tregut ndaj rrezikut të tërmetit, dëmin potencial standard, kapacitetin e sigurimit nga tërmeti si dhe normën e mbajtjes agregate. Bazuar në analizën aktuariale konstatohet që tregu i sigurimeve rezultoi i mirëprovigjonuar dhe përballoi me efikasitet faturën financiare të dëmeve të ndodhura nga dy ngjarjet e tërmetit duke e ndarë këtë faturë edhe me shoqëritë e risigurimit. Përsa i përket nivelit të ekspozimit ndaj rrezikut dhe nivelit të mbajtjes agregate, konstatohet se ngjarjet e tërmetit nuk kanë patur ndikim të konsiderueshëm në marrëveshjet e risigurimit në fuqi. Risigurimi për këto dy ngjarje është kryer në bazë dhe zbatim të rregullores nr. 85/1, datë 30.09.2015 "Për kriteret e risigurimit", të ndryshuar. Cilësia e risiguresve kryesorë, që mbulojnë aktualisht shoqëritë e sigurimit, është A+ e lart, sipas agjencive klasifikuese Standard & Poors, AM Best, Fitch, etj.

Referuar numrit të dëmeve të raportuara për ngjarjet e tërmetit, në lidhje me pronat e siguruara, vihet re që rreth 83% e tyre i përkasin të siguruarve, të cilët kanë siguruar pronën për efekt kredie, ndërsa pjesa tjetër janë prona të siguruara në mënyrë vullnetare. Bazuar në vlerësimet e shoqërive të sigurimit, për këto ngjarje, totali i numrit të dëmeve të raportuara rezulton 6,295 me vlerë rreth 4.7 miliardë lekë. Referuar periudhës 31 dhjetor 2020, dëmet e paguara rezultojnë në nivelin 90% në numër dhe 72% në vlerë, pavarësisht situatës së pandemisë në vend.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE: NGJARJET KRYESORE TË VITIT 2020

Situata në tregjet financiare jobankare nën mbikëqyrjen e Autoritetit u paraqit me luhatje jo domethënëse dhe i rezistoi efekteve të pandemisë. Subjektet nën mbikëqyrje vijuan rregullisht veprimtarinë e tyre. Autoriteti gjatë vitit 2020 ka qenë në monitorim të vazhdueshëm të zhvillimeve në tregjet nën mbikëqyrje dhe ka vlerësuar rregullisht ndikimin e pandemisë në këto tregje, të cilat u përballën me sfida të reja. Në përmbushje të funksioneve dhe kompetencave të tij, Autoriteti vijoi punën për mbikëqyrjen efektive dhe rregullimin e tregjeve, bazuar në "Procedurën e Mbikëqyrjes në Raste Krizash" të Autoritetit.

Përsa i përket aktiviteteve në fushën e tregut të sigurimeve dhe risigurimeve, Autoriteti ka vijuar të mbikëqyrë dhe analizojë tregun e sigurimeve, duke vlerësuar pozicionin financiar të shoqërive që operojnë në këtë treg, si në nivel individual ashtu edhe në tërësi për të gjithë tregun. Situata financiare e shoqërive të sigurimit u paraqit me një nivel të përshtatshëm likuiditeti, duke ruajtur treguesit financiarë në nivel tregu.

Prej muajit mars 2020 AMF, rriti frekuencën e raportimeve mbi ecurinë e normës së likuiditetit të shoqërive të sigurimeve me baza javore. Performanca financiare e tregut të sigurimeve edhe pse në një vit të vështirë, ishte pozitive dhe u shoqërua me rritje të investimeve financiare me rreth 3 miliardë lekë, krahasuar me 31.12.2019. Niveli i të ardhurave në këtë treg u ul me 5.73% krahasuar me vitin 2019, duke arritur në rreth 16.6 miliardë lekë prime të shkruara bruto. Në sigurimin Jo-Jetë, i cili vijoi të dominojë tregun e sigurimeve me 93% të vëllimit të përgjithshëm të këtyre primeve, ulja e të ardhurave erdhi kryesisht nga portofoli i sigurimit të detyrueshëm motorik, Karton Jeshil dhe Sigurimi Kufitar, ku si pasojë e pandemisë u ndalua lëvizja e mjeteve motorike jashtë kufirit. Pavarësisht kësaj, tregu i sigurimeve në 31.12.2020, ka pësuar një rritje në kapitalet e veta, me 1.5 miliardë lekë, si dhe një rritje me rreth 11% të nivelit të aktiveve likuide, krahasuar me 31.12.2019. Treguesi i mbulimit të provigjoneve teknike me aktive të përshtatshme për shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës, në këtë periudhë është rritur në 131.65% nga 121.2% që ishte në 31.12.2019.

Për shoqëritë e sigurimit të Jetës, mbulimi i provigjoneve matematike është rritur në 129.61%, nga 120.8% që ishte në 31.12.2019. Rritja në këta tregues është ndikuar edhe nga kapitalizimi i fitimit të vitit 2019, në zbatim të Vendimit të Bordit nr. 56, datë 10.04.2020 për pezullimin e shpërndarjes së dividendit, duke dëshmuar efektivitetin e masave të marra nga Autoriteti. Këto masa ndikuan në ruajtjen e nivelit të likuiditetit në sistem dhe të treguesve financiarë, atij të mjaftueshmërisë së kapitalit dhe aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike.

Primi mesatar i paguar nga të siguruarit për kategoritë kryesore të mjeteve motorike ka pësuar një ulje afërsisht me 3.8% gjatë vitit 2020, krahasuar me vitin 2019, kryesisht si pasojë e hyrjes në fuqi të masave kufizuese për qarkullimin e mjeteve motorike.

Në vitin 2020 dëmet e paguara bruto arritën në 7.5 miliardë lekë, përfshirë dhe dëmet objekt Fond Kompensimi, duke u rritur me 17.45%, në krahasim me vitin 2019. Rritja e konsiderueshme e dëmeve të paguara bruto erdhi nga portofoli i zjarrit dhe rreziqe shtesë pas kërkesave për dëmshpërblime të shkaktuara nga dy tërmetet e vitit 2019.

Në vitin 2020 përfundoi procesi i hartimit dhe bashkërendimit të Projektligjit “Për sigurimin e detyrueshëm motorik në sektorin e transportit”. Këshilli i Ministrave me VKM-në nr. 1052 datë 09.12.2020, miratoi projektligjin “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” dhe e dërgoi për shqyrtim në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë. Projektligji u miratua në Kuvendin e Shqipërisë në datën 16.03.2021.

Tregu i fondeve të investimeve, i cili për shkak të rritjes së konsiderueshme përfaqëson tashmë një pjesë të rëndësishme të sektorit financiar në Shqipëri pati një rritje të lehtë të vlerës neto të aseteve. Asetet e fondeve të investimeve në fund të vitit 2020 arritën në rreth 67.4 miliardë lekë, duke shënuar një rritje me 0.92% krahasuar me fundvitin 2019. Viti 2020 u shoqërua edhe me licencimin e subjekteve të reja në këtë treg, konkretisht një shoqëri administruese, një bankë si depozitar i fondeve të investimeve alternative dhe tre fonde investimi nga të cilët dy prej tyre kanë nisur aktivitetin gjatë vitit 2020. Edhe numri i anëtarëve në fondet e investimeve vijoi tendencën në rritje dhe arriti në 32,655 anëtarë, duke u rritur me 11.67% krahasuar me një vit më parë.

Tregu i fondeve të pensionit vullnetar, edhe pse me peshë modeste ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto, shënoi një rritje të pjesëmarrjes në këto fonde me 9.72% krahasuar me vitin 2019, duke arritur në 31.020 anëtarë. Totali i aseteve neto në këtë treg arriti në 3.6 miliardë lekë, me një rritje prej 23.81% krahasuar me vitin 2019. Në shkurt të vitit 2020 filloi veprimtarinë e tij një fond i ri pensionesh, duke e çuar numrin e tyre në 4 fonde që operojnë në tregun e pensioneve vullnetare.

Tregu i kapitaleve mbetet në një stad ende të ulët zhvillimi. Për vetë rëndësinë e këtij tregu, zhvillimi i tij përbën sfidë dhe është njëkohësisht një ndër prioritetet kryesore të Autoritetit. Aktualisht tregu i kapitaleve përbëhet nga tregu i titujve të qeverisë shqiptare, që përbëjnë segmentin më të madh dhe aktiv në këtë treg, dhe tregu i obligacioneve me ofertë private. Në tregun e kapitaleve gjatë vitit 2020 vepruan 12 shoqëri komisionere, nga të cilat 9 banka, të cilat janë operatorët më aktivë në tregtimin e titujve të qeverisë. Edhe tregu i obligacioneve të emetuara me ofertë private, i cili është aktiv që prej vitit 2011 ka përjetuar një dinamikë në rritje. Shuma e pashlyer e këtij lloj instrumenti financiar arriti nga 7.45 miliardë lekë në fund të vitit 2019 në rreth 8 miliardë Lekë në fund të vitit 2020, me një rritje prej 7.71%. Përmes licencimeve të reja përgjatë vitit 2020 tregut të kapitalit iu shtua një shoqëri e re komisionere për ushtrimin e veprimtarisë së brokerimit në tituj në bursë.

Në muajt prill dhe maj të vitit 2020, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligje të rëndësishme në fushën e tregjeve të kapitalit dhe të fondeve të investimit, të cilat forcojnë mbikëqyrjen dhe rregullimin e këtyre tregjeve, si dhe përmirësojnë ndjeshëm kuadrin ligjor të fushës:

- Ligji nr. 56/2020, datë 30.04.2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”;
- Ligji nr. 62/2020, datë 14.05.2020 “Për Tregjet e Kapitalit”;
- Ligji nr. 66/2020, datë 21.05.2020 “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”.

Ligjet e reja në fushën e tregut të kapitaleve dhe fondeve kanë për synim nxitjen e zhvillimit të mëtejshëm të tregjeve, sigurimin e integritetit të tyre dhe rritjen e transparencës në funksion të mbrojtjes së interesave të investorëve. Këto ligje përbëjnë bazën për mundësi të reja të financimit për biznesin, alternativa të reja investimi, nxitjen e investorëve të huaj për të investuar në Shqipëri, duke ndikuar pozitivisht në rritjen ekonomike të vendit dhe ruajtjen e një sistemi financiar të qëndrueshëm.

Domosdoshmëria e këtyre ligjeve lidhet ngushtë edhe me procesin e integritetit evropian të Shqipërisë. Ligjet janë hartuar në përputhje me direktivat dhe praktikat më të mira të Bashkimit Evropian në fushën e tregut të kapitaleve dhe fondeve, përkatësisht MIFID II dhe UCITS.

Gjatë vitit 2020 në zbatim të paketës së re ligjore Autoriteti miratoi akte nënligjore të rëndësishme në fushën e tregjeve të kapitalit dhe të sipërmarrjeve të investimeve kolektive. Në vijim do të punohet për plotësimin e kuadrit rregullator të ligjit të ri “Për Tregjet e Kapitalit” edhe me asistencën teknike të Projektit “Forcimi i Kapaciteteve Mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare me fokus Zhvillimin i Tregut të Kapitaleve”. Ky projekt do të mbështesë Autoritetin në forcimin e kapaciteteve të tij në rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregut të kapitaleve. Edhe në tregun e sigurimeve Autoriteti ka vijuar bashkëpunimin me konsulentët e Bankës Botërore për zbatimin e projektit të financuar nga SECO, “Përmirësimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare - “Fokus Zhvillimi i Tregut të Sigurimeve”.

Këto projekte të asistencës teknike financohen nga një grant i Qeverisë së Konfederatës Zvicerane e përfaqësuar nga Sekretariati Shtetëror për Çështje Ekonomike (SECO) dhe mbështeten nga Banka Botërore.

Në fokus të punës së Autoritetit për vitin 2020 ka qenë edhe digjitalizimi dhe modernizimi i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit. COVID-19 bëri të domosdoshme zhvillimet dhe përmirësimet në teknologji dhe digjitalizimin e shumë proceseve të punës. Në këtë kuadër u përfundua analiza teknike për integrimin e sistemeve të Autoritetit me platformën e-Albania për disa shërbime që ofron Autoriteti.

Kapitulli 1

ECURIA E TREGJEVE NËN MBIKËQYRJE

Gjatë vitit 2020, totali i aktiveve në tregjet nën mbikëqyrjen e Autoritetit arritën në rreth 110 miliardë lekë, duke u rritur me 1% krahasuar me vitin 2019. Totali i aseteve në raport me PBB-në rezultoi të jetë 6.8%. Nga pikëpamja e aktiveve, tregu më i madh për t'u mbikëqyrur vijon të jetë tregu i fondeve të investimeve i cili përbën rreth 4.2% të PBB-së.

1.1 Tregu i Kapitaleve dhe Fondeve të Investimit

Tregu i fondeve të investimeve

Në tregun e fondeve të investimeve, vlera neto e aseteve në fund të vitit 2020 arriti në rreth 67.4 miliardë lekë. Gjatë këtij viti janë licencuar një shoqëri administruese dhe tre fonde investimi, nga të cilët dy prej tyre kanë nisur aktivitetin gjatë vitit 2020. Gjatë këtij viti është licencuar edhe një depozitar i fondeve të investimeve alternative.

Tregu i fondeve të investimeve, që nga fillimi i veprimtarisë së tij në vitin 2012 është rritur në mënyrë të konsiderueshme dhe përfaqëson tashmë një pjesë të rëndësishme të sektorit financiar në Shqipëri. Në vitin 2020, totali i aseteve neto të tregut të fondeve të investimit, krahasuar me vitin 2019, ka patur një rritje me 0.92%. Numri i anëtarëve në fondet e investimeve është 32,655 dhe është rritur me 11.67%.

Gjatë vitit 2020 asetet e fondeve të investimit u administruan nga katër shoqëri administruese, tre prej të cilave kryejnë veprimtarinë e administrimit si për fondet e investimit ashtu edhe për fondet e pensionit vullnetar. Ky treg dominohet kryesisht nga investimet në obligacione qeveritare brenda dhe jashtë R.SH., të cilat përbëjnë 68.48% të aseteve të këtij tregu. Në kuadër të respektimit të kërkesave të rregullores së likuiditetit shoqëritë administruese kujdesen që fondet e investimit të cilat investojnë në tregje jo aktive të mbajnë likuiditet në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Tregu i kapitaleve

Tregu i kapitaleve vijon të jetë i përqendruar në dy segmente kryesore: tregun e titujve të Qeverisë dhe tregun e Obligacioneve me Ofertë Private.

Aktualisht në tregun e titujve ushtrojnë veprimtarinë e tyre subjektet si më poshtë:

- 12 shoqëri komisionere, nga të cilat: 9 banka, 1 shoqëri që kryen veprimtarinë e këshillimit në tituj dhe blerjen dhe shitjen e titujve me porosi të klientit, 1 shoqëri për blerjen dhe shitjen e titujve me porosi të klientit në Bursën Shqiptare të Titujve, dhe Posta Shqiptare;

- 4 agjentë të lidhur të shoqërive të huaja komisionere;
- 21 të punësuar në rolin e brokerave;
- 2 këshilltarë individë të punësuar;
- 9 banka kujdestare titujsh të qeverisë (3 prej të cilave janë kujdestare për obligacionet e shoqërive);
- 1 Bursë Titujsh;
- 2 Regjistrarë Titujsh, një prej të cilëve kryen edhe funksionin e klerimit dhe të shlyerjes së titujve korporative që do të tregtohen në Bursë.

Tabelë 2: Pjesëmarrës dhe subjekte të tregut të kapitaleve, dhjetor 2020

Shoqëri Komisionere/Banka	Agjentë të Lidhur të Shoqërive Komisionere të Huaja	Kujdestarë të Titujve të Qeverisë (3 prej të cilëve edhe për obligacionet e shoqërive aksionare)
12	4	9
Regjistrarë Titujsh	Bursë Titujsh	Depozitar Qendror Titujsh
1	1	1
Emetues të Obligacioneve me Ofertë Private	Broker Individë	Këshilltar Individë për Investime në Tituj
7	21	2

Tregu me pakicë i titujve të Qeverisë


Tregu i Titujve të Qeverisë Shqiptare mbetet segmenti më i madh dhe aktiv që mbizotëron në tregun e kapitaleve.

Sipas të dhënave statistikore të Autoritetit për periudhën janar-dhjetor 2020, në tregun me pakicë të Titujve të Qeverisë ka vijuar të dominojë transaksioni “Blerje në tregun primar” me 43.77% kundrejt vëllimit të përgjithshëm të transaksioneve. Përsa i përket aktivitetit në tregun sekondar ai mbetet ende i ulët me rreth 13.75% të totalit të transaksioneve të kryera në këtë treg, ku në veçanti transaksioni “Blerje para afatit të maturimit” ka pësuar një rritje prej 7.95% krahasuar me një vit më parë.


Me qëllim zhvillimin e mëtejshëm të tregut të titujve të Qeverisë, nxitjen e tregut sekondar si dhe rritjen e likuiditetit, në Shqipëri që prej vitit 2018 është zbatuar një sistem, me pjesëmarrjen e 5 bankave në rolin e Zhvilluesit të Tregut, të cilat kanë ekskluzivitetin e tregtimit të obligacioneve referencë 3-vjeçare dhe 5-vjeçare nëpërmjet sistemit të Zhvilluesve të Tregut.

Zhvillimi i mëtejshëm i tregut të titujve të Qeverisë është një domosdoshmëri për zhvillimin e tregut të kapitaleve, pasi ky treg përbën edhe bazën e vlerësimit të instrumenteve të tjera financiare joqeveritare që mund të tregtohen në tregun e kapitaleve në vend.

Grafik 1: Transaksione në Tregun me Pakicë të Titujve të Qeverisë, 2020 (Në %)



Grafik 2: Vëllimi i Tregtimit në Tregun me Pakicë sipas llojit të Titujve (Në %)




1.2 Tregu i Sigurimeve

Në tregun e sigurimeve edhe gjatë vitit 2020 operuan 12 shoqëri sigurimi. Vëllimi i primeve të shkruara bruto të gjeneruara në këtë treg arriti në rreth 16.6 miliardë lekë duke pësuar një tkurrje prej 5.73% krahasuar me vitin 2019. Të ardhurat nga primet e shkruara bruto u ulën si në aktivitetin e Jetës ashtu dhe në atë të Jo-Jetës.


Në aktivitetin e Jetës primet e shkruara bruto u tkurrën kryesisht si pasojë e mos rilidhjes së disa kontratave në sigurimin Jetë e kombinuar.

Në sigurimin Jo-Jetë, ulja e të ardhurave erdhi kryesisht nga portofoli i sigurimit të detyrueshëm motorik, Karton Jeshil dhe Sigurimi Kufitar ku si pasojë e pandemisë u ndalua lëvizja e mjeteve motorike jashtë kufirit.

Grafik 3: Primi i shkruar bruto (Në mld. lekë)




Grafik 4: Ndarja e primit të shkruar bruto, sipas llojit të sigurimit, viti 2020 (Në %)



Në vitin 2020 dëmet e paguara bruto arritën në 7.5 miliardë lekë duke u rritur me 17.45% në krahasim me vitin 2019. Dëmet e paguara bruto sipas llojit të sigurimit Jo-Jetë dhe Jetë arritën përkatësisht në 6.9 miliardë lekë dhe 0.3 miliardë lekë. Dëme të paguara Fond Kompensimi kapën vlerë 0.4 miliardë lekë. Rritja e konsiderueshme e dëmeve të paguara bruto erdhi nga portofoli i zjarrit dhe rreziqe shtesë pas kërkesave për dëmshpërblime të shkaktuara pas dy tërmete të ndodhura në vitin 2019.

Grafik 5: Ecuria e dëmeve të paguara bruto në vite

(Në mld. lekë)



1.3 Tregu i Fondeve të Pensioneve Vullnetare

Tregu i fondeve të pensionit vullnetar ka përjetuar një tendencë në rritje, e shprehur kjo në rritjen e vlerës neto të aseteve dhe numrit të anëtarëve. Në krahasim me vitin 2019, asetet neto të këtij tregu më 31.12.2020 kanë pësuar një rritje me 23.81%, ndërsa numri i anëtarëve është 31,020 me një rritje prej 9.72% krahasuar me fundin e vitit 2019. Vlera neto e aseteve prej 3.6 miliardë lekë është në masën 0.2% kundrejt PPB-së, gjë që tregon domosdoshmërinë e zhvillimit të këtij tregu. Gjatë vitit 2020, në tregun e pensioneve private vullnetare ushtruan aktivitetin e tyre 4 fonde pensioni vullnetar të administruar nga katër shoqëri administruese, tre prej të cilave kryejnë veprimtarinë e administrimit si për fondet e investimit ashtu edhe për fondet e pensionit vullnetar. Investimet e tregut të pensioneve në vitin 2020 arritën në 3.46 miliardë lekë duke shënuar një rritje me 24.92% krahasuar me vitin 2019. Këto investime konsistojnë kryesisht në obligacione të thesarit të Republikës së Shqipërisë me 95.65% ndaj totalit të aseteve. Me gjithë ecurinë pozitive, rritja e pjesëmarrjes në fondet private të pensionit përbën sfidë për zhvillimin e këtij tregu.

Kapitulli 2

AKTIVITETI MBIKËQYRËS


2.1 Mbikëqyrja e Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve të Investimit

2.1.1 Pozicioni financiar

Tregu i fondeve të investimeve

Gjatë vitit 2020, në tregun e fondeve të investimit ushtruan aktivitetin e tyre shtatë fonde investimi, pesha në nivel asetesh e të cilëve pasqyrohet në grafikun e mëposhtëm.

Grafik 6: Pesha që zënë asetet neto të secilit fond investimi në treg 31.12.2020 (Në %)



Që nga fillimi i veprimtarisë së fondit të parë të investimeve në vitin 2012, tregu i fondeve të investimeve është rritur në mënyrë të konsiderueshme dhe ky treg tashmë përfaqëson një pjesë të rëndësishme të sektorit financiar në Shqipëri. Gjatë këtyre viteve, asetet neto të tregut të fondeve të investimeve arritën në 67.4 miliardë lekë. Krahësuar me vitin 2019 asetet neto të fondeve të investimit gjatë vitit 2020 pësuan një rritje me 615 milionë lekë ose 0.92%. Numri i anëtarëve në fondet e investimeve është 32,655 nga të cilët 99.94% janë investitorë individualë.

Investimet e tregut të fondeve të investimit konsistojnë në Obligacione Qeveritare brenda dhe jashtë R.SH., Bono thesari të Qeverisë së R.SH., Obligacione të shoqërive jashtë vendit, kuota në fonde investimi si dhe aksione në shoqëri të huaja.

Në tabelën e mëposhtme është pasqyruar ecuria e portofolit të tregut të fondeve të investimit gjatë tremujorëve të vitit 2020.

Tabelë 3: Të dhëna mbi portofolin e fondeve të investimeve, sipas periudhave tremujore, viti 2020

<i>Përshkrimi</i>	<i>Vlera (në mln. lekë)</i>			
Periudha	31.03.2020	30.06.2020	30.09.2020	31.12.2020
Asetet neto të fondeve	66,865	65,475	66,853	67,404
Totali i aseteve të fondeve	67,523	66,219	67,400	67,546
<i>nga të cilët:</i>	-	-	-	-
Obligacione Qeveritare	45,779	45,750	45,494	46,256
Obligacione të Shoqërive	1,645	2,216	2,442	2,339
Bono Thesari	8,934	8,617	9,615	9,923
Investime në kuota të fondeve të investimit	1,157	1,901	1,790	2,063
Aksione në shoqëri të huaja	100	117	125	151
Mjete Monetare	9,231	6,884	6,876	6,102
Asete të tjera	677	734	1,058	711
Totali i Detyrimeve të Fondeve	658	744	547	142

Në tabelën e mëposhtme është pasqyruar ndryshimi i portofolit të tregut të fondeve të investimit të vitit 2020 kundrejt vitit 2019 si dhe pesha që zë secili nga përbërësit e portofolit në totalin e aktiveve si në vitin 2019, ashtu dhe në vitin 2020.

Tabelë 4: Ndryshimi në përbërjen e portofolit të fondeve të investimeve, 31.12.2019-31.12.2020

<i>Përshkrimi</i>	<i>Vlera (në mln. lekë)</i>		<i>Ndryshimi (në %)</i>	<i>Pjesa ndaj totalit (në %)</i>	
Periudha	31.12.'19	31.12.'20	31.12.'19 - 31.12.'20	31.12.'19	31.12.'20
Asetet neto të fondit	66,788	67,404	0.92		
Totali i aseteve të fondeve	67,173	67,546	0.56	100	100
<i>nga të cilët:</i>	-	-	-		
Obligacione Qeveritare (të R.SH. dhe të huaja)	44,884	46,256	3.06	66.82	68.48
Obligacione të Shoqërive	2,136	2,339	9.50	3.18	3.46
Bono Thesari	9,568	9,923	3.71	14.24	14.69
Investime në kuota të fondeve të investimit	2,807	2,063	(26.51)	4.18	3.06
Aksione në shoqëri të huaja	118	151	27.97	0.18	0.22
Mjete Monetare	6,949	6,102	(12.19)	10.34	9.04
Asete të tjera	711	711	-	1.06	1.05
Totali i Detyrimeve të Fondeve	385	142	(63.12)	0.57	0.21


Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet vlera e kuotës për secilin fond investimi në fund të viteve 2019 dhe 2020.

Tabelë 5: Vlera e kuotës së fondeve të investimeve më 31.12.2019 dhe 31.12.2020 (Në lekë)

<i>Përshkrimi</i>	<i>Vlera neto e aseteve për kuotë 31.12.2019</i>	<i>Vlera neto e aseteve për kuotë 31.12.2020</i>
Raiffeisen Prestigj	1,524	1,537
Raiffeisen Invest EURO ⁴	14,564	14,587
Credins Premium	1,282	1,300
WVP Top Invest	1,083	1,000
Raiffeisen Vizion	1,057	1,075
Albsig Standard	-	998
Raiffeisen Miks ⁵	-	12,372

Në grafikët e mëposhtëm është pasqyruar struktura e aseteve të tregut të fondeve të investimeve në vitet 2019 dhe 2020.

Grafik 7: Struktura e aseteve të fondeve të investimeve 31.12.2019/ 31.12.2020 (Në %)




⁴ Vlerat e Raiffeisen Invest EURO janë konvertuar me kursin në periudhën përkatëse

⁵ Vlerat e Raiffeisen Miks janë konvertuar me kursin në periudhën përkatëse

Në kuadër të respektimit të kërkesave të rregullores së likuiditetit shoqëritë administruese kujdesen që fondet e investimit të cilat investojnë në tregje jo aktive të mbajnë likuiditet deri në një muaj minimalisht 10%. Sic shihet, në grafikun e mëposhtëm investimet e tregut të фондеве të investimit me maturim deri në një muaj janë 14.36%.

Grafik 8: Profili i Investimeve të tregut të фондеве të investimeve 31.12.2020 (Në %)




Tregu i kapitaleve

Autoriteti monitoroi rregullisht veprimtarinë e subjekteve të licencuara në tregun me pakicë të Titujve të Qeverisë. Ky treg është organizuar në formën e Tregut Mbi Banak dhe përfshin vetëm tregtimet ndërmjet shoqërive komisionere të licencuara për të kryer transaksione në tregun me pakicë të titujve (kryesisht banka) dhe investitorëve individualë apo investitorëve - persona juridikë. Në kuadër të mbikëqyrjes, Autoriteti edhe gjatë vitit 2020 ishte në komunikim të vazhdueshëm me subjektet e këtij segmenti të tregut me synim rakordimin e të dhënave të raportuara prej subjekteve dhe të dhënave të sistemit GSRM për këtë treg.

Tregu i rregulluar - Bursa

Autoriteti, në statusin e vëzhguesit të sistemit të tregtimit të Bursës Shqiptare të Titujve ndoqi në kohë reale transaksionet e Bursës në çdo seancë tregtimi. Nga monitorimi nuk rezultoi ndonjë problematikë lidhur me sjelljen e Anëtarëve në Bursë.

Që prej fillimit të aktivitetit në shkurt të vitit 2018 deri në dhjetor të vitit 2020 në Bursën Shqiptare të Titujve, ALSE është realizuar një vëllim tregtimi prej 3.3 miliardë lekë, prej të cilave rreth 1.47 miliardë lekë i përketin volumit të tregtimit të realizuar gjatë vitit 2019, ndërsa rreth 452 milionë Lekë, i përketin volumit të tregtimit të realizuar përgjatë vitit 2020. Titujt e Qeverisë Shqiptare janë të vetmit tituj që janë tregtuar në Bursë.

Grafik 9: Vëllimi i Tregtimit në Bursë (Në mln. lekë)

Bursa Shqiptare e Titujve numëron aktualisht 3 anëtarë (3 shoqëri komisionere banka), të cilët kryejnë transaksione për llogari të portofolit të tyre dhe për llogari të klientëve. Në totalin e transaksioneve të kryera dominojnë transaksionet në obligacione thesari, të kryera në monedhën lekë dhe për llogari të personave juridikë.

Tabela 6: Raporti i transaksioneve të kryera në Bursë midis bankave për llogari të portofolit të tyre ndaj transaksioneve të kryera për llogari të klientëve, 2020 (Në % ndaj totalit)

Lloji i transaksionit	Nr. i transaksioneve	Vlera e Tregtimit
Ndërbankare	32.14%	1.97%
për Klientët	67.86%	98.03%
Individë	53.57%	1.73%
Pers. Juridik	14.29%	96.30%

Infrastruktura e pastregtimit

Tregu i kapitaleve ka përjetuar zhvillime pozitive si në infrastrukturën ligjore me miratimin e Ligjit nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit”, ashtu edhe në infrastrukturën e pastregtimit, të cilat shërbejnë si parakusht për zhvillimin e këtij tregu. Që prej licencimit të saj, në vitin 2019, për të vepruar fillimisht si regjistruar i titujve korporative që do të tregtohen në bursë e më pas për klerimin e shlyerjen e këtyre titujve, shoqëria “Regjistri Shqiptar i Titujve – ALREG” ka regjistruar 6 emetime të obligacioneve me ofertë private, me një vlerë prej rreth 2.78 miliardë lekë. Gjatë 2020, ALREG ka regjistruar 5 emetime në shumën prej 2.15 miliardë lekë, nga ku rreth 53% e kësaj shume të regjistruar është në monedhën EUR dhe 5.6 % në monedhën USD.

Tregu i obligacioneve me ofertë private

Tregu i obligacioneve të emetuara me ofertë private, i cili është aktiv që prej vitit 2011, ka përjetuar një dinamikë në rritje. Shuma e pashlyer e këtij lloji instrumenti financiar arriti nga 7.45 miliardë lekë në fund të vitit 2019, në rreth 8 miliardë lekë në fund të vitit 2020, me një rritje prej 7.71%.

Deri në fund të vitit 2020 rezultojnë 7 emetues të obligacioneve me ofertë private, nga të cilët 3 banka, 2 institucione mikrokredie dhe 2 shoqëri tregtare. Përgjatë vitit 2020 Autoriteti ka miratuar prospektet e 5 emetuesve (3 banka, 1 institucion mikrokredie dhe 1 kompani). Investitorët e këtyre obligacioneve janë kryesisht individë (mbi 95%) dhe disa persona juridikë.

2.1.2 Inspektimet

Tregu i фондеве të investimeve

Gjatë vitit 2020 janë kryer dy inspektime tematike me objekt “Kryerja e stres-testeve, rezultatet e tyre dhe masat e marra në kushtet e pandemisë COVID 19”. Këto inspektime u përqendruan në veçanti në:

- Shpeshhtësinë e kryerjes së stres-testeve për fondet nën administrim;
- Ndryshimin e supozimeve si pasojë e kushteve të krijuara nga pandemia COVID 19;
- Rezultatet e testeve më të fundit me sqarimet përkatëse;
- Masat e marra në vijim të rezultateve;
- Rezultati i treguesit të rrezikut sintetik (SRRI) në kushtet e krijuara nga pandemia COVID-19.

Në të dy inspektimet rezultoi se shoqëritë administruese të SIK kanë marrë masat e nevojshme dhe kanë vepruar në kohë për përballimin e situatës të krijuar nga pandemia COVID-19.

Tregu i kapitaleve

Gjatë vitit 2020 u zhvilluan 4 inspektime në vend pranë subjekteve që kryejnë veprimtari në tregun e kapitaleve. Autoriteti zhvilloi inspektim në vend pranë një banke me objekt veprimtarinë e kujdestarisë për titujt e qeverisë dhe obligacionet e shoqërive aksionare, planin e rimëkëmbjes dhe vazhdimësisë së biznesit për veprimtarinë e kujdestarisë, si dhe respektimin e rregullave në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave dhe luftën kundër terrorizmit.

Autoriteti realizoi inspektim në vend pranë një shoqërie me veprimtari këshillimi për investime në tituj. Inspektimi, i cili kishte për objekt veprimtarinë e shoqërisë lidhur me këshillimin në tituj, u fokusua në çështje të qeverisjes së shoqërisë, veprimtarinë e këshillimit, procedurat për njohjen e klientit dhe transparencën me klientët.

Autoriteti realizoi inspektim në vend pranë dy shoqërive komisionere, të licencuara për të vepruar në Bursë, me objekt kryesor kryerjen e veprimtarisë në përputhje me licencën. Inspektimi u fokusua në respektimin e kërkesave të licencimit, funksionimin e organeve drejtuese të shoqërive, shqyrtimin e të dhënave nga llogaritë bankare të shoqërive.

2.2 Mbikëqyrja e Tregut të Sigurimeve

2.2.1 Pozicioni financiar


Autoriteti, gjatë vitit 2020, ka mbikëqyrur dhe ndjekur në vazhdimësi dinamikën e tregut të sigurimeve, duke vlerësuar pozicionin financiar të shoqërive në nivel individual dhe në tërësi të gjithë tregut të sigurimeve. Autoriteti ka vijuar ndjekjen e përmbushjes së kërkesave ligjore mbi Fondin e Garancisë të shoqërive të sigurimit dhe zbatimin e rregullave për investimin e tij, në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullatore.

Tabelë 7: Të dhëna financiare për tregun e sigurimeve, Aktivet* (Në mln. lekë)

	31.12' 16	31.12' 17	31.12' 18	31.12' 19	31.12' 20
Totali i aktiveve	29,688	30,579	31,564	38,803	38,865
Jeta	3,287	3,382	3,327	4,104	4,814
Jo-Jeta	26,401	27,197	28,237	34,699	34,051
Totali i investimeve	18,811	19,425	20,648	22,151	25,029
Jeta	2,743	2,851	2,822	3,578	4,258
Jo-Jeta	16,068	16,574	17,826	18,574	20,770
*Në aktivet e tregut të Jo-Jetës nuk janë të përfshira investimet në kapital të shoqërisë SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a. tek Sigal Life UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a dhe Eurosig sh.a. tek Insig sh.a. dhe Albsig sh.a të Albsig Jetë sh.a.					

Në 31.12.2020 totali i aktiveve të tregut të sigurimeve është rreth 39 miliardë lekë, ku 88% e totalit të aktiveve zotërohen nga shoqëritë e tregut të Jo-Jetës dhe 12% i përket shoqërive të tregut të Jetës. Për këtë periudhë, aktivet kanë pësuar një rritje të lehtë me 62 milionë lekë krahasuar me 31.12.2019. Rritja e totalit të aktiveve është ndikuar kryesisht nga rritja e sektorit të Jetës, me rreth 710 milionë lekë ose rreth 17% më shumë, krahasuar me 31.12.2019. Sektori i Jo-Jetës ka pësuar rënie të lehtë të totalit të aktiveve me rreth 647 milion lekë ose 1.8% më pak krahasuar me 31.12.2019.

Grafik 10: Totali i aktiveve për tregun Jo-Jetë, Jetë në vite (Në mln. lekë)




Për sektorin e Jetës, rritja e aktiveve ka ardhur kryesisht nga rritja e zërit “Investime në toka, ndërtesa dhe investime financiare” me rreth 681 milionë lekë ose 19% më shumë krahasuar me 31.12.2019. Rritja e investimeve financiare paraqitet me rreth 226 milionë lekë dhe rritja e zërit “toka dhe ndërtesa” me rreth 432 milionë lekë, krahasuar me 31.12.2019.

Për sektorin e Jo-Jetës, rënia e totalit të aktivitetit ka ardhur kryesisht nga rënia e zërit “Pjesa e risiguruesve në provigjonet teknike” me rreth 2 miliardë lekë ose 27% më pak krahasuar me 31.12.2019, si pasojë e pagesës së pjesës më të konsiderueshme të dëmeve të shkaktuara nga dy tërmetet e ndodhura gjatë vitit 2019 – pjesa e risiguruesit, të cilat ishin të provigjonuara.

Gjithashtu, rënie ka pësuar dhe zëri “Llogari të arkëtueshme tregtare”, me rreth 1 miliardë lekë ose 23% më pak, krahasuar me 31.12.2019. Ndërsa, zëri “Investime në toka, ndërtesa dhe investime financiare” është rritur me rreth 2.2 miliardë lekë ose 11.8% më shumë krahasuar me 31.12.2019, ku ndikimi më i madh është rrjedhojë e rritjes së investimeve në toka dhe ndërtesa me rreth 935 milionë lekë ose 27.5% më shumë krahasuar me 31.12.2019.

Në 31.12.2020 investimet kanë vijuar të dominojnë totalin e aktiveve të tregut të sigurimeve me vlerë 25 miliardë lekë, duke zënë rreth 64% të totalit të aktiveve. Rritja e investimeve krahasuar me vitin paraardhës është 3 miliardë lekë ose 13% më shumë.

Grafik 11: Totali i investimeve për tregun Jo-Jetë, Jetë në vite (Në mln. lekë)




Struktura e aktiveve për të dy sektorët e tregut të sigurimeve, krahasuar me 31.12.2019 ka shfaqur zhvillimet kryesore të mëposhtme:

Depozitat vazhdojnë të zënë peshën kryesore të aktiveve me 31% ndjekur nga zëri “Pjesa e risiguruesve në provigjonet teknike” me 13.6%, i cili ka pësuar rënie në peshë me 5.2% në krahasim me vitin 2019. Rënia e këtij zëri vjen si rezultat i pagesave dhe rishikimit të provigjoneve të llogaritura nga shoqëritë për dëmet e shkaktuara nga tërmetet e ndodhura në vitin 2019. Zëri

“Toka dhe ndërtesa” përbën 11.5% të strukturës së aktiveve dhe është rritur me 2.7% në krahasim me 31.12.2019.

Më poshtë, paraqitet grafiki i ecuria e strukturës së aktiveve për periudhën 31.12.2016 deri më 31.12.2020.

Grafik 12: Struktura e Aktivit për tregun e sigurimeve (Në %)




Përsa i përket strukturës së pasiveve të tregut të sigurimeve, ajo dominohet nga zërat e provigjoneve teknike, ku përfshihen provigjonet për primin e pafituar për pjesën që i përket periudhës së mbulimit pas mbylljes së vitit financiar dhe provigjonet e dëmeve, si dhe “kapitalet e veta”, të cilat përfaqësojnë interesin e mbetur në aktivet e entitetit pas zbritjes së të gjitha detyrimeve të tij.

Tabelë 8: Të dhëna financiare për tregun e sigurimeve, Pasivi* (Në mln. lekë)

	31.12.'16	31.12.'17	31.12'18	31.12'19	31.12' 20
Totali i Pasivit	29,688	30,579	31,564	38,803	38,865
Jeta	3,287	3,382	3,327	4,104	4,814
Jo-Jeta	26,401	27,197	28,237	34,699	34,051
Provigjonet teknike bruto	15,568	15,840	16,393	22,100	20,986
Jeta	1,690	1,702	1,728	1,902	2,031
Jo-Jeta	13,878	14,138	14,665	20,199	18,956
Totali i kapitaleve të veta	9,688	9,418	10,665	11,145	12,651
Jeta	1,503	1,542	1,509	2,019	2,419


Jo-Jeta	8,185	7,876	9,156	9,126	10,232
Totali i kapitalit të nënshkruar	7,721	6,953	7,366	7,366	7,473
Jeta	1,234	1,221	1,230	1,632	1,882
Jo-Jeta	6,487	5,732	6,136	5,734	5,591
*Në pasivet e tregut të Jo-Jetës nuk janë të përfshira investimet në kapital të shoqërisë SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a. tek Sigal Life UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a. dhe Eurosig sh.a. tek Insig sh.a. dhe Albsig sh.a. te Albsig Jetë sh.a.					

Grafik 13: Struktura e Pasivit për tregun e sigurimeve (Në %)



Në 31.12.2020 provigjonet teknike zënë 54% të totalit të pasiveve dhe “kapitalet e veta” zënë 33% të totalit të pasiveve. Provigjonet teknike në total për tregun e sigurimeve kanë pësuar një rënie me rreth 1 miliardë lekë krahasuar me 31.12.2019, si rrjedhojë e rënies së provigjoneve teknike të sektorit të Jo-Jetës, me rreth 1.12 miliardë lekë. Rënia e provigjoneve teknike për sektorin e Jo-Jetës është ndikuar nga ndryshimet në provigjonet e përlllogaritura të dëmeve të shkaktuara nga dy tërmetet e ndodhura gjatë vitit 2019, rënie të dëmeve të ndodhura për shkak të pandemisë, si dhe rënie të primeve të shkruara bruto gjatë vitit 2020. Në sektorin e Jetës provigjonet matematike dhe teknike janë rritur me rreth 0.13 miliardë lekë krahasuar me 31.12.2019.

Kapitalet e veta, në 31.12.2020 pësuan një rritje me 1.5 miliardë lekë më shumë krahasuar me 31.12.2019. Kjo rritje është ndikuar edhe nga kapitalizimi i fitimit të vitit 2019, në zbatim të Vendimit të Bordit të Autoritetit nr. 56, datë 10.04.2020, i cili u mor në kushtet e pandemisë globale Covid-19. Vendimi pezulloi shpërndarjen e fitimit në formën e dividendëve, si dhe kërkoi zbatimin e një qasje konservative në lidhje me shpërblimet variabël. Këto masa synojnë ruajtjen e nivelit të likuiditetit në sistem dhe treguesve financiarë të mjaftueshmërisë së kapitalit dhe të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike. Pesha specifike e këtij zëri në strukturën e pasivit të tregut të sigurimeve përbën 33%, në rritje me 3.7% nga viti i kaluar.

Grafik 14: Struktura e aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike⁶ (Në %)

Aktivitet në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike në 31.12.2020 për tregun e sigurimeve në total, janë në vlerën rreth 27.6 miliardë lekë, ku për tregun e sigurimit të Jo-Jetës këto aktive janë në vlerën 24.9 miliardë lekë dhe për tregun e sigurimit të Jetës janë në vlerën rreth 2.7 miliardë lekë. Treguesi i mbulimit të provigjoneve teknike me aktive të përshtatshme për shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës, në këtë periudhë është rritur në 131.65%, nga 121.2% që ishte në 31.12.2019. Ndërsa për shoqëritë e sigurimit të Jetës, mbulimi i provigjoneve matematike në 31.12.2020 është rritur në 129.61%, nga 120.8% që ishte në 31.12.2019.

Rezultati financiar


Gjatë vitit 2020, tregu i sigurimeve është ndikuar nga masat e marra si pasojë e pandemisë Covid-19, të cilat kufizuan lëvizjen e automjeteve dhe qytetarëve duke shkaktuar ulje në të ardhurat e primeve nga sigurimet. Megjithatë, në tërësi rezultati financiar për 31.12.2020 ka pësuar një rritje me 195.7 milionë lekë, krahasuar me periudhën paraardhëse 31.12.2019. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i rritjes prej 203.2 milionë lekë të tregut të Jo-Jetës, ndërkohë që tregu i Jetës ka rezultuar me ulje të rezultatit financiar në vlerën 7.4 milionë lekë ose 5% më pak se në 31.12.2019.

⁶ Aktivitet në mbulim të provigjoneve teknike janë aktivitet e shoqërisë së sigurimit të cilat shërbejnë për mbulimin e përgjegjësi të ardhshme që rrjedhin nga kontratat e sigurimit dhe që mbulojnë humbje si pasojë e rreziqeve që lindin nga ushtrimi i veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit për të cilat kjo e fundit detyrohet të krijojë provigjone teknike.

Rritja e rezultatit financiar të tregut të Jo-Jetës për vitin 2020 është e ndikuar kryesisht nga ecuria e provigjoneve teknike dhe rishikimi i tyre për shkak të pagesës së dëmeve nga ngjarjet e tërmetit në fund të vitit 2019, si dhe ulja e shpenzimeve operative të tregut të sigurimit të Jo-Jetës.


Raporti dëme/prime: Në tregun e sigurimeve gjatë vitit 2020 dëmet e paguara bruto u rritën me 17.45% në krahasim me një vit më parë. Dëmet e paguara pa përfshirë pagesën e dëmeve nga risiguruesit (dëmet neto) në raport me primet e fituara neto në 31.12.2020, për tregun e Jo-Jetës rezultuan në nivelin 32%, nga 38% në 31.12.2019. Ky raport për vitin 2020 është i ndikuar ndjeshëm nga pagesat e risiguruesve për dëmet nga ngjarjet e tërmetit të vitit 2019, duke ulur peshën financiare për shoqëritë e tregut shqiptar të sigurimeve. Për tregun e Jetës raporti dëme/prime neto për 31.12.2020 është 26.7%, nga 22.9% në 31.12.2019.

Grafik 15: Raporti dëme/prime për tregun e Jo-Jetës dhe Jetës (Në %)



Raporti i shpenzimeve, përfaqëson raportin midis shpenzimeve operative neto dhe shpenzimeve të tjera neto për sigurimet kundrejt primeve të fituara neto, për tregun e Jo-Jetës për 31.12.2020 rezulton rreth 61%, nga 60% në 31.12.2019. Për tregun e Jetës raporti i shpenzimeve për 31.12.2020 është rreth 61%, nga 63% në 31.12.2019.

Grafik 16: Raporti i shpenzimeve për tregun e Jo-Jetës dhe Jetës (Në %)



Mbikëqyrja në distancë

Në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, Autoriteti ka ushtruar mbikëqyrje në distancë nëpërmjet monitorimit, mbledhjes dhe verifikimit të raportimeve të depozituara nga shoqëritë e sigurimit dhe institucione të tjera. Mbikëqyrja në distancë fokusohet tek përpunimi dhe analiza e informacionit të mbledhur nga raportimet periodike apo *ad-hoc* të shoqërive të sigurimit, me theks të veçantë tek analizat financiare dhe aktuariale. Konkretisht, në fokus të mbikëqyrjes në distancë për periudhën raportuese ishin:

- Përgatitja e raporteve të analizave financiare në distancë për shoqëritë e sigurimit Jo-Jetë dhe Jetë për periudhat tremujore raportuese, bazuar në shqyrtimin dhe përpunimin e të dhënave të dërguara nga raportimet e shoqërive të sigurimit si dhe informacioneve nga inspektimet në vend dhe analizat financiare të mëparshme;
- Shqyrtimi i raporteve të audituesve të jashtëm për shoqëritë e sigurimit për veprimtarinë e tyre gjatë vitit paraardhës;
- Monitorimi i ecurisë të normës së likuiditetit për shoqëritë e sigurimit;
- Shqyrtimi i raporteve vjetore të audituesve të brendshëm të shoqërive të sigurimit;
- Shqyrtimi i planeve vjetore të biznesit të shoqërive;
- Monitorimi i publikimit të raportit vjetor të shoqërive si dhe publikimi i informacionit lidhur me ndikimin e pandemisë shkaktuar nga Covid-19;
- Analizimi i raporteve të vetëvlerësimit për shoqëritë e sigurimit Jo-Jetë;
- Llogaritja me bazë tremujore e provigjoneve teknike dhe matematike, si dhe llogaritja e kufirit minimal të aftësisë paguese për shoqëritë e sigurimit;
- Analizimi i marrëveshjeve të risigurimit, si dhe vlerësimi i cilësisë së risiguruesit;
- Monitorimi i rreziqeve me vlerë mbi 10 përqind të kapitalit për çdo rrezik të veçantë dhe monitorimi i dëmeve mbi 10 milionë lekë;
- Llogaritja e primit të rrezikut në nivel tregu, për kontratat e sigurimit të detyrueshëm motorik, në përputhje me rregullat e profesionit të aktuarit dhe legjislacionit në fuqi.

2.2.2 Inspektimet

Në kuadër të mbikëqyrjes efektive të tregut të sigurimeve, Autoriteti ka vijuar kryerjen e inspektimeve, ndonëse më të kufizuara në numër, për shkak të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19.

Inspektime të plota me fokus rrezikun

Gjatë vitit 2020 u kryen dy inspektime të plota të planifikuara tek shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës sipas metodologjisë me fokus rrezikun, bazuar në Manualin e Mbikëqyrjes së Shoqërive të Sigurimit, ku njëri prej tyre u finalizua në fillin të vitit 2021. Inspektimet u përqendruan në vlerësimin e rreziqeve kryesore ndaj të cilave ekspozohen shoqëritë e sigurimit sipas aktiviteteteve

të biznesit, si dhe administrimi dhe zbutja e këtyre rreziqeve nga drejtimi i lartë i shoqërisë. Inspektimi sipas metodologjisë me fokus rrezikun përqendrohet edhe në përgjegjësitë e Këshillit Mbikëqyrës dhe menaxhimit të lartë të shoqërisë së sigurimit në drejtim të ruajtjes së stabilitetit financiar të saj.

Në mënyrë më të detajuar këto inspektime konsistuan në vlerësimin e rrezikut të kreditit të sigurimit, operacional, ligjor/rregullator dhe strategjik si dhe në vlerësimin e cilësisë së kapitalit, fitimeve dhe elementeve të veçantë të aktiveve të pasqyrave financiare të shoqërisë. Gjithashtu në fokus të këtyre inspektimeve ishte dhe vlerësimi i menaxhimit të rrezikut, të sistemeve të kontrollit të brendshëm, përfshirë edhe mbikëqyrjen e veprimtarisë nga nivelet drejtuese të shoqërisë.

Në përfundim të këtyre inspektimeve, Autoriteti vlerësoi rrezikun për çdo aktivitet të shoqërive të sigurimit të inspektuara dhe përditësoi profilin e rrezikut të tyre. Profili i rrezikut shërben si bazë për vendosjen e prioriteteve mbikëqyrëse dhe shpërndarjen e kapaciteteve të duhura sipas nivelit të ekspozimit të rrezikut. Gjithashtu, në fund të procesit të inspektimit, gjetjet dhe rekomandimet e Autoritetit iu komunikuan subjekteve përkatëse nëpërmjet letrës për drejtim. Zbatimi i tyre po ndiqet nga Autoriteti në mënyrë sistematike.

Inspektime tematike

Gjatë vitit 2020 janë kryer 4 inspektime tematike pranë shoqërive të sigurimit të Jo-Jetës. Këto inspektime kanë pasur objekte të ndryshme dhe janë fokusuar në çështje që lidhen drejtpërdrejt me mbrojtjen e konsumatorëve, si verifikimi i procesit të trajtimit të dëmeve, me fokus të veçantë dëmet e shkaktuara nga tërmetet e vitit 2019, si dhe zbatimi i rekomandimeve të vendimeve të Bordit të Autoritetit. Inspektimet tematike në shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës janë kryer në përputhje me kërkesat e “Manualit praktik mbi inspektimin në vend për dëmet motorike dhe të pronës”. Konkretisht në fokus të këtyre inspektimeve ishin verifikimi i:

- Respektimit të kriterëve ligjore e rregullatore gjatë procesit të trajtimit të kërkesave për dëmshpërblim, duke përfshirë edhe verifikimin e akteve të vlerësimit;
- Procedurës së trajtimit dhe vlerësimit të dëmeve të shkaktuara nga tërmetet e vitit 2019;
- Kontratave të bashkësigurimeve;
- Trajtimit të ankesave nga të dëmtuarit;
- Shpenzimeve të marrjes në sigurim;
- Zbatimit të Vendimeve të Bordit dhe rekomandimeve të lëna nga inspektimet e mëparshme të Autoritetit, lidhur me aktivitetet e ndryshme të shoqërive të sigurimit.

Në përfundim të këtyre inspektimeve, Autoriteti u komunikoi shoqërive rekomandimet përkatëse, në funksion të përmirësimit të sistemit të dëmshpërblimit, zbatimit të afateve të trajtimit të kërkesës për dëmshpërblim, plotësimit të dokumentacionit sipas kërkesave të kuadrit rregullator në fuqi, raportimit dhe provigjonimit të saktë të dëmeve, përmirësimit të procedurave për trajtimin dhe

zgjidhjen e ankesave si dhe zbatimit të bazës ligjore lidhur me aktivitetin e bashkësigurimeve. Zbatimi i rekomandimeve, sipas afateve kohore të përcaktuara, ndiqet dhe monitorohet në vijimësi nga Autoriteti.

2.2.3 Mbikëqyrja e grupeve

Në përputhje me Ligjin nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, seksioni IV, Autoriteti kryen mbikëqyrje plotësuese ndaj shoqërive të sigurimit të strukturuar në grup sigurimi sipas dispozitave të këtij ligji. Grupi i sigurimit, për qëllime të mbikëqyrjes, përbëhet nga dy ose më shumë persona juridikë ku të paktën njëri është shoqëri sigurimi dhe tjetri ka ndikim të rëndësishëm në shoqërinë e sigurimit. Ndikimi i rëndësishëm përcaktohet bazuar në kriterin e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë ose të tërthortë, ndikimit dhe/ose detyrimeve të ndryshme kontraktuale, lidhjet brenda grupit, ekspozimit ndaj rrezikut, përqendrimit të rrezikut, transferimit të rrezikut, përqindjes së zotërimit të pronësisë dhe/ose transaksionet brenda grupit.

Në tregun e sigurimeve në Shqipëri, gjatë vitit 2020 kanë ushtruar veprimtari 4 grupe sigurimi, nga të cilat 2 grupe janë me kapital vendas dhe dy të tjerat me kapital të huaj.

Mbikëqyrja efektive e grupeve të sigurimit, bazohet në parimet themelore të sigurimeve (ICP), dhe në marrëveshjet e bashkëpunimit të nënshkruara nga Autoriteti me mbikëqyrësit e shteteve ku ushtrojnë veprimtarinë shoqëritë e sigurimit me kapital shqiptar dhe mbikëqyrësit e grupeve të sigurimit ndërkombëtarë që ushtrojnë veprimtari në Shqipëri.

Në vitin 2020, janë kryer takime virtuale midis Autoritetit dhe kolegjeve mbikëqyrëse të grupeve të sigurimeve Uniqa Insurance Group dhe Vienna Insurance Group. Këto kolegje janë në funksion të mbikëqyrjes efektive të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit, nëpërmjet shkëmbimit të informacionit në lidhje me ecurinë e aktivitetit të tyre. Në këto kolegje, Autoriteti raportoi mbi mbarëvajtjen e shoqërive të sigurimit, pjesë e grupeve Uniqa Insurance Group dhe Vienna Insurance Group, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Shqipëri. Pjesë e raportimit ishin rreziqet që karakterizojnë funksionimin e tyre në tregun shqiptar të sigurimit, si dhe sjelljen në vëmendje të çështjeve dhe problematikave të konstatuara nga mbikëqyrja.

Në zbatim edhe të Strategjisë 2018–2022 të Autoritetit, përfaqësues të tij dhe Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) morën pjesë në dy kolegje mbikëqyrëse të grupit të sigurimeve me kapital vendas që ushtron aktivitet edhe në Republikën e Kosovës, në bazë të Udhëzimit Metodologjik “Mbi mbikëqyrjen e grupit të sigurimit”. Qëllimi i këtyre kolegjeve është shkëmbimi i informacionit në funksion të mbikëqyrjes efektive në nivel grupi për shoqëritë vendase të sigurimit dhe risigurimit, të cilat kanë investime apo degë të tyre në vende të huaja. Çështjet kryesore të trajtuara në këto kolegje kanë qenë ndër të tjera vlefshmëria reciproke e policave të sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, detyrimet reciproke mbi praktikën e dëmeve apo

trajtimin dhe pagesën e dëmeve, ndikimi i pandemisë Covid-19 në treguesit financiarë të shoqërive të grupit, etj.

2.2.4 Provigjonet Teknike

Në analizën e shëndetit financiar të shoqërive të sigurimit, Autoriteti vlerëson nëse provigjonet teknike janë të mjaftueshme dhe në përputhje me nivelin e rrezikut të kontraktuar nga shoqëritë. Mjaftueshmëria e provigjoneve teknike, vlerësohet në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe mospërmbushja e këtij detyrimi përbën shkelje të rregullave të menaxhimit të rrezikut.

Ecuria në nivel tregu e provigjoneve teknike ndër vite shfaq një tendencë në rritje duke ruajtur dhe strukturën e aktivitetit Jetë dhe Jo-Jetë. Për tremujorin e katërt të vitit 2020, provigjonet teknike bruto, në total për aktivitetin Jetë dhe Jo-Jetë, janë rreth 20.99 miliardë lekë. Peshën më të lartë nga pikëpamja e veprimtarisë së ushtruar e mbajnë provigjonet teknike bruto të shoqërive të Jo-Jetës, me 90.32% të totalit të provigjoneve teknike bruto ose rreth 18.96 miliardë lekë, ndërkohë që provigjonet teknike bruto për aktivitetin e Jetës arrijnë në 2.03 miliardë lekë ose 9.68% e totalit të provigjoneve teknike bruto. Kjo strukturë reflekton gjithashtu edhe raportin e primeve të shkruara bruto për aktivitetin e Jo-Jetës kundrejt atyre të Jetës, përkatësisht 92.98% dhe 7.02%.

Provigjoni Teknik

Provigjoni teknik është shuma e llogaritur në bazë të një parashikimi dhe sipas mënyrave aktuariale të caktuara, e cila mbahet nga sigurosi, për të mbuluar përgjegjësitë që rrjedhin nga kontratat e sigurimit.

Provigjonet teknike përfshijnë:


- Provigjonet për prime, të cilat përbëhen nga provigjonet për primet e pafituara dhe për rreziqe të paskaduara. Këto provigjone krijohen në përpjesëtim me primet e shkruara që lidhen me mbulimet e sigurimit, të cilat janë ende të vlefshme pas përfundimit të periudhës financiare gjatë së cilës janë krijuar këto provigjone;
- Provigjonet për bonuse dhe rabate, të cilat krijohen në nivel të njëjtë me shumën e pagesave që merr i siguruari bazuar në të drejtën për përfitimet që rrjedhin nga kontratat e sigurimit, të drejtën për reduktim të pjesshëm të primit të sigurimit (rabat) si dhe të drejtën e rimbursimit të një pjese të primit të sigurimit në rast të përfundimit të parakohshëm të kontratës së sigurimit;
- Provigjonet teknike të dëmeve, të cilat krijohen në rastin e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit para përfundimit të periudhës së sigurimit të kontratës së sigurimit dhe vlerësimi i tyre bëhet në nivel të njëjtë me përgjegjësitë e marra përsipër nga shoqëria e sigurimit nëpërmjet kontratës së sigurimit;
- Provigjone për mbrojtjen për rrezikun ndaj investimit;
- Provigjone të tjera teknike. Këto provigjone krijohen nga shoqëritë e sigurimit me qëllim për të mbuluar përgjegjësitë e pritshme dhe rreziqet për dëme të mëdha, të cilat rrjedhin nga sigurimi i përgjegjësisë për humbje nga rreziqe bërthamore, përgjegjësinë e prodhuesit të produkteve farmaceutike si dhe rreziqet e përmbytjes dhe tërmetit.

Provigjonet matematike krijohen në nivel të njëjtë me vlerën aktuale të detyrimeve të ardhshme që rrjedhin nga kontratat e sigurimit të Jetës, duke zbritur vlerën aktuale të parashikuar për primet e ardhshme për t'u paguar sipas kontratës në fjalë.

Nga të dhënat në nivel tregu, të pasqyruara në grafikun e mëposhtëm, vihet re tendenca në rritje e treguesit të provigjoni teknik të dëmeve dhe primeve. Në vazhdimësi Autoriteti ka dhënë rekomandime për përmirësimin në rritje të treguesit të provigjoni teknik të dëmeve nga sigurimi i detyrueshëm në përputhje me rritjen e aktivitetit të tregut të sigurimeve. Këto rekomandime janë bazuar në analizat e të dhënave të shoqërive të sigurimit, në gjetjet e konstatuara gjatë inspektimeve në vend, si dhe nga informacioni për dëmet në proces gjyqësor, lidhur me detyrimet dhe rrezikun ndaj të cilit janë të ekspozuara shoqëritë e sigurimit.

Grafik 17: Provigjoni teknik bruto

(Në mld. lekë)



Provigjoni teknik bruto për sigurimin e detyrueshëm motorik (MTPL)

Provigjoni teknik bruto për produktin MTPL zë peshën specifike më të lartë në totalin e provigjoneve teknike të tregut të Jo-Jetës. Ky tregues, për 31.12.2020, arrin në rreth 12.37 miliardë lekë, duke pësuar kështu një rritje me 4.79% krahasuar me vitin e kaluar. Pesha e provigjoneve teknike bruto për portofolin e MTPL ka pësuar rritje në 65%, nga 58% që rezultoi në fund të vitit 2019. Ndikimin kryesor e ka dhënë rënia e provigjoneve teknike bruto të dëmeve për linjën e biznesit Zjarri dhe Forcat e Natyrës.

Referuar tabelës më poshtë, vërehet që peshën më të lartë e mban provigjoni teknik i dëmeve në krahasim me provigjoniin e primit të pafiturar. Edhe gjatë vitit 2020 është ruajtur e njëjta strukturë ndarjeje. Për këtë portofol dëmet që kanë ndodhur dhe akoma nuk janë paguar, janë më të larta se provigjonet për dëmet që pritet të ndodhin në të ardhmen për kontratat që janë akoma në fuqi pas mbylljes së vitit financiar.

Tabelë 9: Pesha dhe struktura provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm (Në mld. lekë)

Periudha Ushtrimore	31.12.'14	31.12.'15	31.12.'16	31.12.'17	31.12'18	31.12'19	31.12'20
Provigjone teknike bruto MTPL (në mld. lekë)	7.61	8.26	9.76	9.82	10.73	11.80	12.37
Provigjone teknike bruto Jo-Jeta (në mld. lekë)	9.66	12.41	13.87	14.14	14.67	20.20	18.96
Raporti i Provigjone teknike bruto MTPL ndaj Provigjone teknike bruto Jo-Jeta (në %)	79	67	70	69	73	58	65

Periudha Ushtrimore	31.12.'14	31.12.'15	31.12.'16	31.12.'17	31.12'18	31.12'19	31.12'20
Provigjoni teknik për dëmet MTPL (në %)	53	52	52	52	54	56	56
Provigjoni i Primit të pafituar MTPL (në %)	47	48	48	48	46	44	44
Total	100	100	100	100	100	100	100

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik

Primi i rrezikut

Me liberalizimin e tarifave në vitin 2011, Autoriteti ka përcaktuar modelin e llogaritjes së primit të rrezikut për kontratën e sigurimit të detyrueshëm motorik TPL, metodologji e cila zbatohet nga shoqëritë e sigurimit edhe në vlerësimin e primit të rrezikut për kontratën e sigurimit të Kartonit Jeshil dhe atij Kufitar. Bazuar në kërkesat e kësaj metodologjie, ku elementët kryesorë për përcaktimin e primit të rrezikut, janë frekuenca dhe kostoja mesatare e dëmeve, shoqëritë e sigurimit marrin në konsideratë inflacionin e dëmit ndër vite si dhe bëjnë projeksionin e tij për periudhat e ardhshme financiare, element ky i rëndësishëm në përcaktimin e një vlere sa më të saktë të primit të rrezikut të ardhshëm.

Autoriteti, mbi bazën e të dhënave të shoqërive të sigurimit, llogarit primin e rrezikut në nivel tregu, si dhe për çdo shoqëri sigurimi, për produktet e sigurimit të detyrueshëm motorik brenda datës 31 mars të çdo viti pasardhës. Në vijim, shoqëritë e sigurimit llogarisin nivelin e provigjoneve teknike të primit të pafituar të sigurimit të detyrueshëm motorik, duke u kujdesur që njëherazi:

- Provigjonet teknike të llogariten për çdo policë sigurimi;

- Vlera e provigjoneve teknike të jetë të paktën sa vlera më e lartë midis primit të rrezikut të llogaritur nga vetë shoqëria e sigurimit dhe primit të rrezikut në nivel tregu të llogaritur nga Autoriteti.

Primi mesatar i sigurimit

Primi i paguar nga të sigurvearit përfshin primin e rrezikut, pjesën e llogaritur për mbulimin e shpenzimeve të marrjes në sigurim dhe shpenzimeve administrative, përfshirë dhe komisionet, si dhe pjesën e llogaritur për fitimin e shoqërisë së sigurimit.

Tabelë 10: Primi mesatar i paguar për motoçikleta, autovetura, furgonë për vitet 2015 –2020 (Në lekë)

Viti/Kategoria	A1/1	A1/2	B1/1	B1/2	B2/1	B2/2
2015	5,640	8,550	15,100	15,850	24,500	29,050
2016	6,150	9,210	16,330	17,120	26,500	31,440
2017	6,040	9,280	16,050	16,880	26,260	30,550
2018	6,140	9,350	16,400	17,230	26,650	31,400
2019	6,450	9,820	17,220	18,090	27,980	32,970
2020	6,200	9,300	16,900	17,900	26,900	31,000

Primi mesatar i paguar nga të sigurvearit për kategoritë kryesore të mjeteve motorike ka pësuar një ulje afërsisht me 3.8% gjatë vitit 2020, krahasuar me vitin 2019, kryesisht si pasojë e hyrjes në fuqi të masave kufizuese për qarkullimin e mjeteve motorike, të cilat sollën ulje të frekuencës të dëmeve të ndodhura gjatë periudhës së pandemisë.

2.2.5 Risigurimet

Bazuar në kuadrin ligjor dhe aktet rregullatore të miratuara nga Autoriteti, shoqëria e sigurimit është e detyruar të risigurojë në një shoqëri risigurimi atë pjesë të rrezikut të sigurvearit që tejkalon limitin e lejuar prej 10% të vlerës së kapitalit. Shoqëritë e sigurimit kanë kryer transferim të rrezikut, me anë të kontratave të risigurimit, edhe për arsyt e mëposhtme:

- Kufizimin e ekspozimit ndaj risqeve të mëdha;
- Zbutjen e luhatjeve të rezultateve financiare ndër vite;
- Përmirësimin e kërkesave të kapitalit (aftësisë paguese);
- Rritjen e kapacitetit për të pranuar risqe; si dhe
- Asistencë teknike dhe financiare.

Në bazë të kërkesave rregullatore, shoqëritë e sigurimit, raportojnë në Autoritet programin e risigurimit. Bazuar në funksionin e saj mbikëqyrës, Autoriteti ndjek ecurinë e zbatimit të këtij programi dhe kontratave specifike të lidhura, duke synuar të sigurojë stabilitetin e vazhdueshëm

financiar në lidhje me standardet e mbajtjes së rrezikut nga këto shoqëri risigurimi dhe kriterëve të lidhura me cilësinë e risiguruesve.

Marrëveshjet e risigurimit në portofolet e sigurimit të Jo-Jetës kanë qenë të formës jo proporcionale, kryesisht të tipit *Excess of Loss* (Tejkalim humbjeje) dhe të formës proporcionale, të tipit *Quota Share/Surplus*. Në sigurimin e Jetës, mbulimi me risigurim është kryer nëpërmjet marrëveshjeve risiguruese të formës proporcionale të tipit *Surplus* dhe të tipit *Quota Share*.

Primet e ceduara në risigurim për 31.12.2020 rezultojnë:

- Për totalin e tregut të sigurimeve në vlerën e rreth 2.65 miliardë lekë ose sa 15.96% e vlerës së primeve të shkruara bruto në nivel tregu. Vlera e primeve të ceduara në risigurim, në nivel tregu, krahasuar me fundin e vitit 2019, është ulur me rreth 354 milionë lekë ose rreth -11.79%;
- Për aktivitetin e Jo-Jetës në vlerën prej 2.6 miliardë lekë ose sa 16.85% e vlerës së primeve të shkruara bruto për sigurimin e Jo-Jetës. Vlera e primeve të ceduara në risigurim, për gjithë aktivitetin e Jo-Jetës, krahasuar me fundin e vitit 2019, është ulur me rreth 362 milionë lekë ose -12.2%;
- Për sigurimin e Jetës në vlerën prej 50 milionë lekë ose sa 4.29% e vlerës së primeve të shkruara bruto për sigurimin e Jetës. Primet e ceduara në risigurim për sigurimin e Jetës, janë rritur me rreth 7.8 milionë lekë ose 18.56% më shumë krahasuar me fundin e vitit 2019.


Në tabelën 11 dhe grafikun 18 pasqyrohen primet e ceduara në risigurim, të ndara sipas makroklasave të biznesit për aktivitetin e Jo-Jetës. Në vitin 2020, krahasuar me vitin 2019, kemi rritje të primeve të ceduara në risigurim vetëm për makroklasën Aksidente dhe Shëndeti, ndërsa për makroklasat e tjera, primet e ceduara janë ulur. Gjithashtu, për vitin 2020, konstatohet se peshën më të madhe ndaj primeve totale të ceduara, e zënë produktet motorike, me 57.7% të totalit dhe Zjarri dhe të tjera të pronës me rreth 31.4%.

Tabela 11: Primet e ceduara në risigurim, sipas makroklasave të biznesit, 2019 dhe 2020

(Në mln. lekë)

Lloji i Sigurimit	2020	2019
Aksidente dhe shëndet	88	80
Motorike	1,500	1,537
Zjarri e të tjera të pronës	816	939
Përgjegjësi	125	201
Të tjera	72	206
TOTAL	2,601	2,963

Grafik 18: Pesha specifike e risigurimeve sipas makroklasave të biznesit për vitin 2020 krahasuar me vitin 2019 (Në %)



Krahasuar me vitin 2019, në aktivitetin e Jo-Jetës ka një rënie të primeve të ceduara në risigurim me 12.2 %. Arsyet kryesore të rënies së primeve të ceduara lidhen me rënien e primeve të shkruara bruto si dhe mosrinovimi i disa kontratave të sigurimit për 2020.

Raportet e vetëvlerësimit të rreziqeve (ORSA)

Në zbatim të kërkesave dhe afateve të përcaktuara në Rregulloren nr. 18, datë 28.04.2015 për “Rregullat e organizimit të sistemit të administrimit të rrezikut në shoqërinë e sigurimit”, shoqëritë e sigurimit gjatë vitit 2020 kanë paraqitur raportin vjetor mbi vlerësimin e rreziqeve dhe aftësisë paguese (ORSA), raport i ngjashëm kërkohet dhe për shoqëritë e sigurimit nën regjimin e *Solvency* 2. Qëllimi i hartimit të raportit, me krijimin e sistemit të administrimit të rrezikut, është që vetë shoqëria të identifikojë, vlerësojë, mbikëqyrë, administrojë dhe raportojë, në vijimësi, rreziqet me të cilat është përballur ose mund të përballë, në nivel të shoqërisë, si një e tërë, dhe/apo në nivel grupi.

Autoriteti ka analizuar raportet e vetëvlerësimit të shoqërive të sigurimit, ku vëmendje e veçantë i është kushtuar shqyrtimit të:

- Strategjive, me anë të të cilave përcaktohet qasja e shoqërisë së sigurimit për të trajtuar zonat e veçanta të rrezikut dhe detyrimet ligjore e rregullatore;
- Politikave, me anë të të cilave përcaktohen procedurat dhe kërkesat e tjera që janë të detyrueshme për t’u zbatuar nga Këshilli i Administrimit/Mbikëqyrjes, drejtuesit e lartë ekzekutivë, funksionarët kryesorë dhe punonjësit e shoqërisë së sigurimit;

- Procesteve, me anë të të cilave zbatohen strategjitë dhe politikat e shoqërisë së sigurimit, si edhe;
- Kontrolleve, me anë të të cilave sigurohet që strategjitë, politikat dhe proceset ekzistojnë, mbikëqyren dhe funksionojnë në përmbushje të objektivave.

Në vijim të analizimit të raporteve të vetëvlerësimit, është kryer vlerësimi i ekspozimit agregat ndaj rreziqeve, administrimit të rrezikut dhe nevojave të kapitalit.

2.2.6 Ecuria e Fondit të Kompensimit


Fondi i kompensimit për vitin 2020

Bordi i Autoritetit me Vendimin nr. 250, datë 24.12.2019, ka miratuar Fondin e Kompensimit për vitin 2020. Byroja Shqiptare e Sigurimit gjatë periudhës janar-korrik 2020, në raportimet periodike nuk kishte pasqyruar, llogaritur dhe shpërndarë Fondin e Kompensimit për vitin 2020, dhe rrjedhimisht niveli i pagesave gjatë kësaj periudhe rezultonte në nivele shumë të ulëta.

Zgjidhja e problematikës u bë e mundur me datë 24.08.2020, me marrjen e vendimit nr. 16, nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve të BSHS-së. Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve të BSHS-së, me Vendimin nr. 16, miratoi vlerën 478,520,718 lekë, si detyrim Fond Kompensimi për t'u paguar për vitin 2020, si dhe shpërndarjen e Fondit të Kompensimit sipas shoqërive të sigurimit.

Duke filluar nga muaji shtator 2020, niveli i pagesave ka shënuar një rritje të dukshme, siç pasqyrohet më poshtë.

Grafik 19: Ecuria e pagesave janar-dhjetor 2020 (Në mln. lekë)



Referuar të dhënave të depozituara nga BSHS, gjatë periudhës janar-dhjetor 2020, vlera e paguar për Fondin e Kompensimit të vitit 2020 është rreth 369 milionë lekë, ose rreth 77% e detyrimit të periudhës. Rreth 56% e kësaj vlere janë paguar vetëm gjatë muajve shtator-dhjetor.

Me qëllim monitorimin dhe ndjekjen e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura, janë kryer inspekte në 8 shoqëritë e sigurimit si dhe inspektim pranë BSHS, për verifikimin e saktësisë së të dhënave në Sistemin Elektronik të Administrimit të dëmeve Fond Kompensimi, përmbushjen e kërkesës së Autoritetit për pasqyrimin dhe përditësimin e statuseve dhe vlerave të praktikave të dëmeve pezull objekt Fond Kompensimi, si dhe saktësimin e vlerës së rezervave në pasqyrimin e raportimit periodik mujor.

Çështje që lidhen me Byronë Shqiptare të Sigurimit

- Monitorimi i zbatimit të kushteve të monitorimit të vendosura nga Këshilli i Byrove për BSHS-në, ka qenë në vëmendje dhe gjatë vitit 2020. Gjatë këtij viti në sistemin *online* të Këshillit të Byrove janë raportuar 3 “Thirrje Garancie”, të cilat janë shlyer menjëherë nga shoqëritë e sigurimit. Autoriteti me qëllim mospërsëritjen e rasteve të raportimeve të thirrjeve të garancive, nisur dhe nga statusi i Byrosë Shqiptare të Sigurimit, si Byro në monitorim, ka kërkuar angazhimin e shoqërive të sigurimit për respektimin e afateve të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Këshillit të Byrove, për çdo kërkesë dëmi të konfirmuar nga BSHS.
- Përditësimi i faqes zyrtare në internet e BSHS-së në mënyrë periodike, me informacion të plotë dhe lehtësisht të kuptueshëm për konsumatorët. Në përgjigje të kërkesës së Autoritetit, BSHS ka përmirësuar faqen e saj zyrtare në internet.
- Procesi i inventarizimit të policave të sigurimit, i cili është kryer në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve nëpërmjet inspektimit pranë shoqërive të sigurimit Jo-Jetë.

2.3 Mbikëqyrja e Tregut të Fondeve të Pensionit Vullnetar

2.3.1 Pozicioni financiar

Tregu i fondeve të pensionit vullnetar që prej fillimit të aktivitetit të tij, ka patur tendencë në rritje, përse i përket aseteve që menaxhon, si dhe numrit të kontribuesve.


Siç shihet edhe në tabelën e mëposhtme, totali i aseteve neto të këtij tregu më 31.12.2020 është 3.6 miliardë lekë me një numër prej 31,020 anëtarë. Asetet neto të këtij tregu më 31.12.2020 kanë pësuar një rritje me 23.81%, ndërsa numri i anëtarëve është rritur me 9.72% krahasuar me fundin e vitit 2019.

Tabelë 12: Asetet neto të fondeve të pensionit vullnetar


<i>Përshkrimi</i>	<i>Vlera (mln. lekë)</i>			<i>Ndryshimi (në %)</i>	
<i>Periudha</i>	<i>2018</i>	<i>2019</i>	<i>2020</i>	<i>31.12.'18- 31.12.'19</i>	<i>31.12.'19- 31.12.'20</i>
Asetet neto të tregut të FP	2,289.10	2,910.44	3,603.27	27.14	23.81

Në 31.12.2020 fondi i pensionit vullnetar “Sigal” zë peshën më të madhe të këtij tregu përse i përket vlerës së aseteve neto 44.19%, kurse fondi i pensionit vullnetar “Raiffeisen”, fondi i pensionit vullnetar “Credins Pension” dhe ai “Albsig” zënë respektivisht 24.41%, 30.11% dhe 1.29% të tregut, siç shihet edhe në grafikun e mëposhtëm.

Grafik 20: Ndarja e tregut sipas vlerës së aseteve neto të fondeve të pensionit më 31.12.2020 (Në %)



Në grafikun e mëposhtëm është pasqyruar ndarja e tregut sipas vlerës së aseteve neto të fondeve të pensionit vullnetar gjatë tre viteve të fundit.

Grafik 21: Ndarja e tregut sipas vlerës së aseteve neto të fondeve të pensionit vullnetar (Në %)

Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet vlera e kuotës për secilin fond pensioni vullnetar gjatë tre viteve të fundit.

Tabelë 13: Vlera e kuotës së fondeve të pensionit vullnetar (Në lekë)

<i>Fondi i pensionit</i>	<i>Vlera e aseteve neto për kuotë 2018</i>	<i>Vlera e aseteve neto për kuotë 2019</i>	<i>Vlera e aseteve neto për kuotë 2020</i>
Sigal	1,394	1,449	1,496
Raiffeisen	1,724	1,809	1,888
Credins Pension	1,406	1,475	1,517
Albsig	-	-	1,016

Nga tabela e mësipërme shihet se vlera e aseteve neto për kuotë për secilin nga fondet e pensionit ka pasur një tendencë në rritje. Në fund të vitit 2020 vlera e aseteve neto për kuotë e fondit të pensionit “Sigal” është rritur me 3.26% krahasuar me fundin e vitit 2019, kurse për fondin e pensionit vullnetar “Raiffeisen” dhe “Credins Pension” ky tregues është rritur respektivisht me 4.35% dhe 2.85%.

Asetet e këtij tregu në 31.12.2020 janë në vlerën 3.6 miliardë lekë dhe janë investuar kryesisht në obligacione të qeverisë shqiptare. Investimet në obligacione të RSH-së përbëjnë 95.65% të totalit të aseteve të tregut të fondeve të pensionit dhe janë rritur me 24.92% krahasuar me fundvitin 2019. Pjesa tjetër e aseteve e këtij tregu konsiston në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare dhe në llogari të arkëtueshme. Struktura e aseteve të këtij tregu gjatë tre viteve të fundit dhe ndryshimi i kësaj strukture jepet në tabelat e mëposhtme.

Tabelë 14: Struktura e asetëve të tregut të фондеве të pensionit vullnetar gjatë tre viteve të fundit
(Në mln. lekë)

<i>Përshkrimi</i>	<i>Vlera</i>		
Periudha	31.12.'18	31.12.'19	31.12.'20
Asetet neto të фондеве të pensionit	2,289.10	2,910.44	3,603.27
Totali i asetëve të фондеве	2,303.26	2,921.48	3,618.80
<i>nga të cilët:</i>			
Mjete Monetare dhe Ekuivalentë të Mjeteve Monetare	47.73	91.86	83.26
Obligacione Thesari të RSH	2,210.16	2,770.77	3,461.31
Depozita bankare	0.00	0.00	0.00
Asete të tjera	45.37	58.85	74.22
Totali i Detyrimeve të Фондеве	14.16	11.03	15.52

Tabelë 15: Ndryshimi i strukturës së asetëve të tregut të фондеве të pensionit vullnetar më 31.12.2020 krahasuar me 31.12.2019

<i>Përshkrimi</i>	<i>Vlera (Në mln. lekë)</i>		<i>Ndryshimi (Në %)</i>	<i>Pjesa ndaj totalit (Në %)</i>	
Periudha	31.12.'19	31.12.'20	31.12.'19- 31.12.'20	31.12.'19	31.12.'20
Asetet neto të фондеве të pensionit	2,910.44	3,603.27	23.81		
Totali i asetëve të фондеве	2,921.48	3,618.80	23.87	100	100
<i>nga të cilët:</i>					
Mjete Monetare dhe Ekuivalentë të Mjeteve Monetare	91.86	83.26	-9.36	3.14	2.30
Obligacione Thesari të RSH	2,770.77	3,461.31	24.92	94.84	95.65
Depozita bankare	0.00	0.00	-	0.00%	0.00
Asete të tjera	58.85	74.22	26.13	2.01	2.05%
Totali i Detyrimeve të Фондеве	11.03	15.52	40.73	0.38	0.43


Gjatë vitit 2020, totali i investimeve të фондеве të pensionit ka qenë 3.46 miliardë lekë dhe këto investime konsistojnë kryesisht në obligacione të thesarit të Republikës së Shqipërisë (95.65% ndaj totalit të asetëve).

Investimet e tregut të pensioneve kanë shënuar një rritje me 24.92% krahasuar me 31.12.2019. Ecuria e investimeve gjatë tre viteve të fundit paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Tabelë 16: Vlera e investimeve të tregut të fondeve të pensionit vullnetar (Në mln. lekë)

<i>Përshkrimi</i>	<i>Vlera</i>		
<i>Periudha</i>	<i>2018</i>	<i>2019</i>	<i>2020</i>
Totali i investimeve të tregut të FP	2,210.16	2,770.77	3,461.31

Duke qenë se detyrimet e fondeve të pensionit vullnetar janë afatgjata pasi anëtarët mund të tërhiqen kur arrijnë moshën e pensionit, atëherë dhe politika e investimeve për të tre fondet e pensionit, të cilat operojnë në treg është afatgjatë duke mbartur në këtë mënyrë dhe rrezikun e tregut. Kështu kjo politikë e investimeve të fondeve të pensionit ka synuar në maturime 5, 7 dhe 10 vjeçare siç shihet dhe në grafikun më poshtë.

Grafik 22: Ndarja sipas maturimit të investimeve të tregut të fondeve të pensionit vullnetar më 31.12.2020 (Në %)

Në grafikun më sipër vihet re se pjesën më të madhe e zënë investimet në obligacione me afat maturimi 10 vjeçar në masën 66.84%. Ky fakt tregon se fondet e pensionit vullnetar synojnë të ndërtojnë një portofol të përbërë kryesisht nga letra me vlerë afatgjatë.


Numri i anëtarëve që kanë kontribuar në fondet e pensionit vullnetar gjatë tre viteve të fundit si dhe ndryshimi në përqindje për këto periudha pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

Tabelë 17: Numri i anëtarëve sipas fondeve të pensionit vullnetar

<i>Përshkrimi</i>	<i>Numri i anëtarëve në FP</i>			<i>Ndryshimi (në %)</i>	
<i>Periudha</i>	<i>2018</i>	<i>2019</i>	<i>2020</i>	<i>31.12.'18-31.12.'19</i>	<i>31.12.'19-31.12.'20</i>
Sigal	7,067	8,084	8,431	14.39	4.29
Raiffeisen	2,911	3,052	3,118	4.84	2.16
Credins Pension	15,320	17,137	17,617	11.86	2.80
Albsig	0	0	1,854	-	-
Total	25,298	28,273	31,020	11.76	9.72

Në grafikun më poshtë është pasqyruar ndarja e tregut sipas numrit të anëtarëve në fondet e pensionit vullnetar e shprehur në përqindje për fundvitin 2020.


Grafik 23: Ndarja e tregut sipas numrit të anëtarëve në fondet e pensionit vullnetar më 31.12.2020 (Në %)



Në fund të vitit 2020, 17,240 anëtarë të tregut të fondeve të pensionit vullnetar janë përfshirë në planet individuale të pensionit vullnetar, ndërsa 13,780 anëtarë janë përfshirë në planet profesionale të pensionit vullnetar të krijuara nga punëdhënësit për punonjësit e tyre.

Në grafikun më poshtë është paraqitur ndarja e anëtarëve të tregut të fondeve të pensionit vullnetar sipas planeve të pensionit për fundvitin 2020, ku 55.58% e anëtarëve të këtij tregu bëjnë pjesë në planet individuale të pensionit, kurse 44.42% e tyre bëjnë pjesë në planet profesionale të pensionit.

Grafik 24: Ndarja e anëtarëve të tregut të fondeve të pensionit vullnetar sipas planeve të pensionit më 31.12.2020 (Në %)



Pjesa më e madhe e anëtarëve të fondeve të pensionit vullnetar “Albsig”, “Sigal” dhe atë “Raiffeisen” janë përfshirë në planet profesionale të pensionit përkatësisht 91.59%, 74.96% dhe 70.65%, ndërsa 79.80% e anëtarëve të fondit të pensionit vullnetar “Credins Pension” janë përfshirë në planet individuale të pensionit.

Tabela më poshtë tregon ndarjen anëtarëve në secilin prej fondeve të pensionit vullnetar sipas planeve individuale dhe profesionale të pensionit për fundvitin 2020.

Tabelë 18: Ndarja e anëtarëve të fondeve të pensionit vullnetar sipas planeve të pensionit më 31.12.2020

<i>Fond Pensioni</i>	<i>Numri i anëtarëve në planet individuale të pensionit</i>	<i>Numri i anëtarëve në planet profesionale të pensionit</i>
Sigal	2,111	6,320
Raiffeisen	915	2,203
Credins Pension	14,058	3,559
Albsig	156	1,698
Total	17,240	13,780

Mbikëqyrja me bazë rrezikun dhe analiza e rreziqeve të tregut

Nëpërmjet metodologjisë me bazë rrezikun evidentohen rreziqet më të mëdha që prekin këtë treg dhe njëkohësisht strategjitë që duhen ndjekur për zbutjen e tyre në një nivel të pranueshëm. Metodologjia me bazë rrezikun, me qëllim zhvillimin e një procesi të shëndoshë për gjykimin e vlerësimit të rrezikut, ka parashikuar gjithashtu ngritjen e Komitetit të Rrezikut për Fondet e Pensionit, i cili ka filluar aktivitetin e tij në vitin 2016 me miratimin e Metodologjisë së re mbikëqyrëse.

Gjatë mbledhjeve të Komitetit të Rrezikut në vitin 2020 janë prezantuar matricat e rrezikut të pranishëm dhe rrezikut të mbetur në sistem dhe u dakordësua vlerësimi i këtyre rreziqeve, duke identifikuar rreziqet që kërkojnë ndërhyrje më të shpejtë në sistem. Kështu, si rreziku më i madh në kushtet e Shqipërisë u identifikua rritja e pjesëmarrjes së kontribuesve në sistem, gjë që ka lidhje edhe me rritjen e besueshmërisë në sistem. Komiteti i Rrezikut, duke pasur si objektiv zbutjen e rreziqeve, miraton planin e mbikëqyrjes për një periudhë afatmesme për tregun e fondeve të pensionit.

2.3.2 Inspektimet

Për tregun e fondeve të pensionit vullnetar, Autoriteti gjatë këtij viti ka ndjekur plotësimin e rekomandimeve të lëna gjatë inspektimeve në vend që janë kryer në periudhat e mëparshme, kryesisht inspektime bazuar në metodologjinë me bazë rrezikun.

Fokusi i këtyre inspektimeve ka qenë vlerësimi i nivelit të zbatimit të parimeve të mirëqeverisjes dhe menaxhimit të rrezikut. Aktiviteti i subjekteve të mbikëqyrura nga Autoriteti duhet të jetë në përputhje me këto parime. Rekomandimet e lëna nga Autoriteti konsistojnë kryesisht në plotësimin e dokumentacionit dhe kryerjen e veprimtarisë në përputhje me parimet e organizimit dhe

strukturës së subjekteve, planifikimit strategjik dhe vendimmarrjes së kujdesshme si dhe menaxhimit të rreziqeve si p.sh: vlerësimi i cilësisë së menaxhimit të rrezikut të sigurisë së aseteve, të pagesave nga fondet, të mbajtjes dhe sigurisë së të dhënave.

Kapitulli 3

AKTIVITETI RREGULLUES DHE LICENCUES

Zhvillimet Kryesore

Gjatë vitit 2020 u miratuan nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë tre ligje që rregullojnë fushën e shërbimeve financiare në tregun e kapitaleve si:

- Ligji nr. 62/2020, datë 14.05.2020 “Për Tregjet e Kapitalit”;
- Ligji nr. 56/2020, datë 30.04.2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”;
- Ligji nr. 66/2020, datë 21.05.2020 “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”.

Në tregun e sigurimeve përfundoi procesi i hartimit dhe bashkërendimit të Projektligjit “Për sigurimin e detyrueshëm motorik në sektorin e transportit”. Këshilli i Ministrave me VKM-në nr. 1052 datë 09.12.2020, miratoi projektligjin “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”. Miratimi i paketës së akteve ligjore lidhet ngushtë edhe me procesin e integritetit të Shqipërisë në strukturat evropiane.

3.1 Rregullimi i Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve të Investimit

Tregu i kapitaleve

Miratimi i Ligjit nr. 62/2020, datë 14.05.2020 “Për Tregjet e Kapitalit” solli përmirësim të kuadrit ligjor dhe rregullativ, si dhe harmonizimin me direktivat e Bashkimit Evropian. Ligji ka si qëllim rregullimin e tregjeve të kapitalit, mënyrës dhe kushteve për ofrimin, blerjen dhe shitjen e instrumenteve financiare në Republikën e Shqipërisë, si dhe përcaktimin e procedurave për rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregjeve të instrumenteve financiare.

Ky ligj i përgjigjet si realitetit shqiptar ashtu edhe dinamikës së kërkesave të tregjeve evropiane. Ligji për tregjet e kapitalit është në përputhje me direktivat e Bashkimit Evropian, me parimet e Organizatës Ndërkombëtare të Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO) dhe me udhëzimet e Autoritetit Evropian të Letrave me Vlerë dhe Tregjeve (ESMA).

Aktet nënligjore në tregun e kapitaleve

Janë hartuar dhe miratuar nga Bordi i Autoritetit 5 rregulloret. Rregulloret janë konsultuar me grupet e interesit dhe subjektet që veprojnë në tregun e kapitaleve.

- Rregullore nr. 197, datë 29.12.2020 “Për vlerësimin e përshtatshmërisë së klientit”, objekti i së cilës është përcaktimi i mënyrës së vlerësimit të përshtatshmërisë së klientit duke përdorur formate standarde të pyetësorit të përshtatshmërisë, nëpërmjet të cilave shoqëria komisionere/banka që ofron shërbime investimesh siguron informacionin e nevojshëm për të vlerësuar përshtatshmerinë e klientit me instrumentin financiar apo shërbimin e investimit të ofruar/kërkuar.
- Rregullore nr. 196, datë 29.12.2020 “Për procedurën e certifikimit dhe kualifikimet e punonjësve me funksione kyçe të shoqërisë komisionere”, objekti i së cilës është përcaktimi i procedurës së certifikimit të aftësisë dhe përshtatshmërisë së punonjësve me funksione kyçe të shoqërisë komisionere dhe bankës që ofron shërbime investimi në tituj, si dhe kualifikimeve që duhet të zotërojnë punonjësit me funksione kyçe të shoqërisë komisionere dhe personelit kyç të bankës që ofron shërbime investimi në tituj, në përputhje me pozicionin dhe përgjegjësitë e vendit të punës.
- Rregullore nr. 195, datë 29.12.2020 “Për licencimin e shoqërisë komisionere, regjistrimin e degës së shoqërisë së huaj komisionere dhe njohjen e shoqërisë së huaj komisionere”, objekti i së cilës është përcaktimi i formës së kërkesës, paketës së dokumentacionit të nevojshëm, procedurës dhe afateve për licencimin e shoqërisë komisionere, regjistrimin e degës së shoqërisë së huaj komisionere dhe njohjen e shoqërisë së huaj komisionere.
- Rregullore nr. 188, datë 16.12.2020 “Për regjistrimin dhe veprimtarinë e agentit të lidhur të shoqërisë komisionere”, objekti i së cilës është përcaktimi i formës dhe përmbajtjes së kërkesës për regjistrimin e agentit të lidhur të shoqërisë komisionere, të përmbajtjes së dokumentacionit dhe procedurës për regjistrimin e kërkesës për agentin e lidhur, të detyrimeve të shoqërisë komisionere, si dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së agentit të lidhur.
- Rregullore nr. 187, datë 16.12.2020 “Për formën dhe procedurën e regjistrimit të akt-ofertës për emetimin e obligacioneve”, objekti i së cilës është përcaktimi i formës së akt-ofertës për ofertat e obligacioneve që janë të përjashtuara nga përgatitja e prospektit të plotë, sipas nenit 244 të ligjit nr.62, datë 14.5.2020 “Për Tregjet e Kapitalit” dhe procedurës për regjistrimin e akt-ofertës për emetimin e obligacioneve.

Tregu i fondeve të investimit

Miratimi i Ligjit nr. 56/2020, shënon një hap të rëndësishëm në përmirësimin e mëtejshëm të bazës ligjore që rregullon këtë fushë, adreson më mirë kërkesat e tregut, standardet evropiane, si dhe siguron mbrojtje më të mirë të investitorëve.

Ligji nxit zhvillimin e tregut nëpërmjet ofrimit dhe rregullimit të disa formave të reja të fondeve të investimit, siç janë fondet kryesore, fondet furnizuese apo fondet ombrellë, apo fondet alternative të investimit. Zhvillimi i tregut të fondeve, nxit paralelisht edhe zhvillimin e tregut të kapitaleve, pasi këto fonde janë një investitor institucional shumë i rëndësishëm për këtë treg.

Më konkretisht ky ligj rregullon:

- Themelimin, regjistrimin dhe veprimtarinë e shoqërive administruese të fondeve, të shoqërive administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike dhe të shoqërive administruese të fondeve të investimeve alternative, në Republikën e Shqipërisë;
- Themelimin, regjistrimin dhe veprimtarinë e depozitarëve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive në Republikën e Shqipërisë;
- Themelimin, regjistrimin dhe veprimtarinë e sipërmarrjeve të investimeve kolektive në Republikën e Shqipërisë;
- Shitjen dhe marketimin në Republikën e Shqipërisë të sipërmarrjeve të investimeve kolektive të themeluara në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, nëpërmjet shoqërive administruese të fondeve, vendase ose të huaja;
- Marketimin dhe administrimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive jashtë Republikës së Shqipërisë nga shoqëri administruese të themeluara në Republikën e Shqipërisë.

Aktet nënligjore në tregun e fondeve të investimit

Janë hartuar dhe miratuar nga Bordi i Autoritetit 5 (pesë) rregullore. Rregulloret janë konsultuar me grupet e interesit dhe subjektet që veprojnë në këtë treg.

Rregullore të miratuara gjatë vitit 2020

- Rregullore nr. 112, datë 31.08.2020 “Për licencimin dhe rregullat shtesë të licencimit të shoqërive administruese të fondeve, depozitarëve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, licencimin dhe regjistrimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive të themeluara në Republikën e Shqipërisë”, objekti i së cilës është përcaktimi i kërkesave për licencimin e shoqërive administruese të fondeve, depozitarëve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, licencimin dhe regjistrimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive që ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë.
- Rregullore nr.132, datë 30.09.2020 “Për formën, llogaritjen dhe shumën e fondeve të veta që duhet të ketë detyrimisht shoqëria administruese e fondeve”, objekti i së cilës është përcaktimi i formës, llogaritjes dhe shumës së fondeve të veta që duhet të ketë detyrimisht dhe në çdo kohë shoqëria administruese e fondeve.

- Rregullore nr.133, datë 30.09.2020 “Mbi komunikimin me investitorët”, objekti i së cilës është përcaktimi i kërkesave për dhënien e informacionit për investitorët nga shoqëria administruese e fondeve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike.
- Rregullore nr.156, datë 23.10.2020 “Për administrimin e rrezikut nga shoqëria administruese e fondeve” objekti i së cilës është përcaktimi i rregullave për organizimin dhe funksionimin e sistemit të administrimit të rrezikut që krijon shoqëria administruese e fondeve.
- Rregullore nr.189, datë 16.12.2020 “Mbi pezullimin, mbylljen, marrjen në administrim dhe likuidimin e shoqërive administruese të fondeve, depozitarëve dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive me oferte publike, si dhe mbi zëvendësimin e shoqërive administruese të fondeve dhe depozitarëve”, objekti i së cilës është përcaktimi i rregullave mbi pezullimin, mbylljen, marrjen në administrim dhe likuidimin e shoqërive administruese të fondeve, depozitarëve dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike si dhe mbi zëvendësimin e shoqërive administruese të fondeve dhe depozitarit.

Bordi i Autoritetit ka miratuar gjithashtu ndryshime të akteve nënligjore në fuqi. Ndryshime janë miratuar me vendimin e Bordit nr. 99, datë 29.07.2020 në Rregulloren nr. 89, datë 27.06.2016 “Për kriteret dhe kërkesat për miratimin e shoqërisë audituese të shoqërive administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe shoqërive administruese të fondeve të pensionit vullnetar” e ndryshuar.

Tregu financiar i bazuar në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë

Miratimi i Ligji nr. 66/2020, datë 21.05.2020 "Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë", përbën një hap të rëndësishëm pasi ky ligj vendos kushtet për licencimin, monitorimin, mbikëqyrjen e subjekteve që ushtrojnë aktivitetin e shpërndarjes, tregtimit e ruajtjes së tokenëve digjitalë dhe/ose monedhave virtuale, të agentit të tokenëve digjitalë, ofruesit të shërbimeve inovative dhe sipërmarrjes së automatizuar të investimeve kolektive.

Ligji do të krijojë një mjedis të rregulluar për emetimin, ofrimin dhe tregtimin e aseteve virtuale dhe mbështet zhvillimin e tregjeve financiare në tërësi.

3.2 Rregullimi i tregut të sigurimeve

Në vitin 2020 përfundoi procesi i hartimit dhe bashkërendimit të Projektligjit “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”. Projektligji kaloi në një procedurë të gjatë bashkërendimi me ministritë e linjës, institucione të tjera shtetërore si dhe koordinimi me Shoqatën e Siguruesve

të Shqipërisë në nivel teknik. Autoriteti ka shqyrtuar gjithashtu komentet ndër vite të ekspertëve të Bankës Botërore lidhur me këtë projektligj si dhe ka patur komunikim me ta për reflektimin e komenteve. Këshilli i Ministrave me VKM-në nr. 1052 datë 09.12.2020, miratoi projektligjin “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”. Projektligji u miratua në Kuvendin e Shqipërisë në datën 16.03.2021.

Nevoja për këtë ligj ishte angazhim në përmbushje të rekomandimeve të Komisionit Evropian, nëpërmjet progres raporteve si dhe nëpërmjet takimeve vjetore të Nën-Komitetit BE-Shqipëri “Tregu i brendshëm dhe Konkurrenca”.

Me qëllim përmirësimin e bazës ligjore ekzistuese në tregun e sigurimeve, gjatë vitit 2020 Autoriteti ka miratuar ndryshime në dy rregullore:

- Rregullore nr.37, datë 28.05.2015 “Për përcaktimin e kriterëve dhe kërkesave për përzgjedhjen e shoqërisë audituese për shoqërinë e sigurimit”, ndryshuar me vendimin e Bordit nr. 98, datë 29.07.2020;
- Rregullore nr. 119, datë 06.06.2019 “Mbi administrimin e Fondit të Kompensimit” ndryshuar me vendimin e Bordit nr. 114, datë 31.08.2020.

3.3 Rregullimi i tregut të fondeve të pensionit vullnetar

Autoriteti është duke punuar për të përshtatur Ligjin nr. 10 197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar” sipas Direktivës (BE) 2016/2341 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit datë 14 Dhjetor 2016 “Për veprimtaritë dhe mbikëqyrjen e institucioneve të pensionit profesional (IORP II). Gjatë vitit 2020 për tregun e fondeve private të pensionit vullnetar Autoriteti ka amenduar këto rregullore:

- Rregulloren nr. 139, datë 26.09.2012 "Për përlllogaritjen e vlerës neto të aseteve të fondit të pensionit vullnetar dhe afatet e publikimit të informacionit", ndryshuar me vendimin e Bordit nr. 3, datë 22.01.2020; dhe
- Rregulloren nr. 25, datë 23.02.2011 "Për raportimin në AMF të veprimtarisë së shoqërisë administruese të fondeve të pensionit", ndryshuar me vendimin e Bordit nr. 2, datë 22.01.2020, në kuadër të zhvillimit të sistemit të raportimit *online* të tregut të fondeve të pensionit vullnetar.

Të tjera

- Në kuadër të rritjes së standardeve të kualifikimit profesional dhe edukimit në vazhdim Autoriteti miratoi Rregulloren nr. 198, datë 29.12.2020 “Mbi kualifikimin profesional dhe edukimin në vazhdim”, objekti i së cilës është të përcaktimi i kriterëve dhe procedurave për njohjen e programit të aktiviteteve të kualifikimit profesional dhe edukimit në vazhdim si dhe monitorimin e këtyre aktiviteteve, njohjen e krediteve të edukimit në vazhdim, si

dhe standardet minimale të kualifikimit profesional, të subjekteve nën mbikëqyrje të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

- Ndryshime, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm, janë bërë edhe në akte të tjera nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e vetë Autoritetit. Gjatë vitit 2020 janë ndryshuar rregulloret si më poshtë:
 - Rregullore nr.102, datë 30.09.2015 “Për krijimin, investimin dhe përdorimin e fondit të rezervës së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”, ndryshuar me vendimin e Bordit nr.185, datë 12.11.2020;
 - Rregullore nr. 17, datë 28.04.2015 “Për funksionimin dhe mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes së Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare” ndryshuar me vendimin e Bordi nr.150 datë 30.09.2020.
- Rregullore nr. 118, datë 19.09.2011 "Për kartën e auditimit të brendshëm", ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 81, datë 29.06.2020.
- Me qëllim adresimin e rekomandimeve të lëna nga Komiteti MONEYVAL i Këshillit të Evropës lidhur me çështjet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit e terrorizmit, Autoriteti ndryshoi Rregulloren nr. 58, datë 30.06.2015 “Mbi masat e vigjilencës së duhur dhe të zgjeruar nga subjektet e ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, me Vendimin e Bordit nr. 97, datë 29.07.2020 dhe me Vendimin e Bordit nr. 199, datë 29.12.2020.

3.4 Licencimi dhe Qeverisja

3.4.1 Tregu i fondeve

Aktiviteti i Licencimit

Autoriteti licençoi shoqërinë “ABI Invest” sh.a., për ushtrimin e veprimtarisë së administrimit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike, shoqërinë “Credins Invest” sh.a., edhe si shoqëri administruese të fondeve të investimeve alternative, shoqërinë “Banka Amerikane e Investimeve” sh.a., për të ushtruar veprimtarinë edhe si depozitar i fondeve të investimeve alternative dhe 3 sipërmarrje të investimeve kolektive, me pjesëmarrje të hapur, me ofertë publike, të veçanta.

Aktualisht në tregun e fondeve ushtrojnë aktivitet 6 shoqëri administruese nga të cilat 2 janë shoqëri administruese të fondeve të pensionit vullnetar dhe të sipërmarrjeve të investimeve kolektive (SIK) me ofertë publike, 2 janë shoqëri administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike, 1 është shoqëri administruese vetëm e fondeve të pensionit vullnetar dhe 1 është shoqëri administruese të fondeve të pensionit vullnetar, të sipërmarrjeve të investimeve

kolektive (SIK) me ofertë publike dhe të fondeve të investimeve alternative, për klientët profesionistë dhe të kualifikuar.

Shoqëritë administruese të fondeve, administrojnë 9 SIK në formën ligjore të Fondit të Investimit, me pjesëmarrje të hapur, me ofertë publike dhe 4 Fonde pensioni vullnetar.

Në tregun e fondeve ushtrojnë aktivitetin e Depozitarit të fondeve 6 banka, nga të cilat 3 banka janë të licencuara si depozitar i aseteve të fondeve të pensionit vullnetar dhe të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, 2 banka janë depozitar të fondeve të pensionit vullnetar dhe 1 bankë është depozitar i aseteve të fondeve të pensionit vullnetar, të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike dhe të fondeve të investimeve alternative, për klientët profesionistë dhe të kualifikuar.

Të dhënat mbi shoqëritë administruese, sipërmarrjet e investimeve kolektive, fondet e pensionit vullnetar dhe depozitarët, jepen në tabelën e mëposhtme:

Tabelë 19: Të dhëna mbi subjektet që ushtrojnë veprimtari në tregun e fondeve (Në numër)

Subjekte	2016	2017	2018	2019	2020
Shoqëri Administruese:	3	3	4	5	6
Shoqëri Administruese të SIK me ofertë publike	-	-	1	1	2
Shoqëri Administruese të Fondeve të Pensionit vullnetar	1	1	1	1	1
Shoqëri Administruese të Fondeve të Pensionit vullnetar dhe SIK me ofertë publike	2	2	2	3	2
Shoqëri Administruese të Fondeve të Pensionit vullnetar dhe SIK me ofertë publike dhe fondeve të investimit alternativ për klient profesionist dhe të kualifikuar.	-	-	-	-	1
Sipërmarrje të Investimeve Kolektive	3	3	5	6	9
(Fonde investimi)					
Fonde Pensioni Vullnetar	3	3	3	4	4
Depozitarë të fondeve:	4	5	5	6	6
Depozitar i Fondeve të Pensionit	3	3	3	2	2
Depozitar i Fondeve të Pensionit dhe Fondeve të Investimit	1	2	2	4	3
Depozitar i Fondeve të Pensionit vullnetar dhe SIK me ofertë publike dhe Fondeve të investimit alternativ për klient profesionist dhe të kualifikuar.	-	-	-	-	1

Qeverisja

Në mbështetje të kërkesave ligjore dhe nënligjore, shoqëritë administruese janë të organizuara sipas sistemit të organizimit me një nivel. Autoriteti miratoi 8 riemërime në funksione drejtuese si anëtar të këshillit administrues/mbikëqyrës ose administrator të shoqërive administruese të fondeve, si dhe ka miratuar 2 emërime në këto funksione.

Tabelë 20: Të dhëna për aksionarët e shoqërive administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe fondeve të pensionit vullnetar

<i>Subjekte</i>	<i>Numër</i>	<i>%</i>
Shoqëri administruese	6	
Aksionarë gjithsej	17	
<i>Klasifikimi i aksionarëve sipas pjesëmarrjes zotëruese</i>		100
nën 10%	7	41.18
mbi 10% nën 20%	2	11.76
mbi 20% nën 33 %	1	5.88
mbi 33% nën 50%	1	5.88
mbi 50%	6	35.29
<i>Klasifikimi i aksionarëve sipas vendit të origjinës:</i>		100
Aksionarë të huaj	8	47.06
Aksionarë vendas	9	52.94
<i>Klasifikimi i aksionarëve sipas statusit</i>		100
Aksionarë individë	9	52.94
Aksionarë shoqëri	8	47.06

Tabelë 21: Të dhëna mbi miratimin e ndryshimeve statutore (Në numër)

<i>Arsyeja e Ndryshimit të Statutit</i>	<i>2016</i>	<i>2017</i>	<i>2018</i>	<i>2019</i>	<i>2020</i>
Statut i ri/ndryshime të tjera	2	-	-	5	1
Rritje kapitali	-	1	2	1	1
Ndryshim i strukturës aksionere	-	1	-	2	-

3.4.2 Tregu i kapitaleve

Aktiviteti i Licencimit

Autoriteti licenoi shoqërinë “Brokas Securities” sh.a., për ushtrimin e veprimtarisë së brokerimit në tituj, për blerjen dhe shitjen e titujve me porosi të klientit, në “Bursën Shqiptare të Titujve ALSE” sh.a. Janë hequr licencat e dy shoqërive për ushtrimin e veprimtarisë së brokerimit në tituj, për shkelje të dispozitave ligjore. Gjithashtu, është hequr licenca e një shoqërie për ushtrimin e veprimtarisë së këshillimit për investime në tituj dhe këshilltarit të investimeve, si rrjedhojë e mbylljes së aktivitetit nga shoqëria.

Në vitin 2020, në tregun e kapitaleve ushtrojnë veprimtari 3 shoqëri komisionere dhe 9 banka që ofrojnë shërbime investimi në tituj, 4 agjentë të lidhur, 9 kujdestarë të titujve të Qeverisë (3 prej të cilëve edhe për obligacionet e shoqërive aksionare) dhe 2 regjistrarë.

Tabelë 22: Të dhëna historike mbi subjektet që veprojnë në tregun e kapitalit (Në numër)

<i>Subjekte⁷</i>	<i>2016</i>	<i>2017</i>	<i>2018</i>	<i>2019</i>	<i>2020</i>
Bursë titujsh	0	1	1	1	1
Shoqëri komisionere/Banka	15	17	17	14	12
Kujdestarë të titujve të Qeverisë së R.Sh.	8	9	9	9	9
Regjistar titujsh	1	1	1	2	2
Agjentë të lidhur të shoqërive komisionere të huaja	2	4	3	5	4

3.4.3 Tregu i sigurimeve

Aktiviteti i licencimit

Aktiviteti licencues i Autoritetit në tregun e sigurimeve u fokusua kryesisht në licencimin/miratimin e ndërmjetësve në sigurime.

Shoqëri sigurimi

Aktualisht në tregun e sigurimeve ushtrojnë aktivitet 12 shoqëri sigurimi nga të cilat 8 në sigurimin e Jo-Jetës dhe 1 shoqëri në sigurimin e Jetës, duke mos pasur ndryshime krahasuar me vitin 2019. Autoriteti licenoi një shoqëri sigurimi Jo-Jetë për të ushtruar veprimtari edhe në klasën 14 “Sigurimi i kreditit”.

⁷ Emërtimet e subjekteve që operojnë në tregun e kapitaleve janë sipas Ligjit 62/2020 “Për tregjet e kapitalit”

Ndërmjetës në sigurime

Veprimtaria e ndërmjetësimit në sigurime mund të ushtrohet si broker në sigurime ose si agjent në sigurime. Brokerimi në sigurime mund të kryet nga individët e licencuar si broker në sigurime si broker fizik i pavarur, nga shoqëritë e brokerimit dhe bankat e licencuara për të ushtruar këtë veprimtari nëpërmjet brokerit të licencuar.

Autoriteti licenoi një bankë për të ushtruar veprimtarinë e brokerimit për sigurimin Jo-Jetë dhe Jetë. Një individ i licencuar si broker fizik në sigurime kërkoi tërheqjen e licencës. Në tregun e sigurimeve aktualisht janë të licencuara për të ushtruar veprimtarinë e brokerimit në sigurime 14 shoqëri brokerimi, 5 banka dhe 4 brokera fizik.

Të dhënat mbi numrin e brokerave të licencuar në sigurime, jepen në tabelën e mëposhtme:

Tabelë 23: Të dhëna mbi brokerat e licencuar në sigurime (Në numër)

<i>Statusi i Brokerit</i>	<i>Të licencuar në fund të vitit 2019</i>	<i>Licenca të reja në vitin 2020</i>	<i>Tërhequr licenca gjatë vitit 2020</i>	<i>Të licencuar në fund të vitit 2020</i>
Shoqëri brokerimi	19	1	1	19
nga këto:				
Banka	4	1	-	5
Broker individ	52	1	1	52

Nga 14 shoqëritë e brokerimit, 7 prej tyre dhe 1 bankë, ushtrojnë veprimtari vetëm në fushën e sigurimit të Jo-Jetës, ndërsa 4 shoqëri ushtrojnë veprimtari brokerimi në sigurime të Jetës, të Jo-Jetës dhe risigurime, 3 shoqëritë e tjera, si edhe 5 bankat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në të dy fushat e sigurimit, të Jetës dhe Jo-Jetës.

Tabelë 24: Shoqëri brokerimi sipas klasave të sigurimit (Në numër)

Viti	2016	2017	2018	2019	2020
Shoqëri brokerimi Jo-Jetë	6	8	9	9	8
Shoqëri brokerimi Jo-Jetë dhe Jetë	5	5	6	6	7
Shoqëri brokerimi Jo-Jetë, Jetë, Risigurime	3	3	4	4	4
Totali	14	16	19	19	19

Autoriteti miratoi 106 persona fizikë (agjentë) për ushtrimin e veprimtarisë si agjentë në sigurime si dhe licenoi 7 subjekte juridike për të vepruar si agjentë në sigurime. Në tregun e sigurimeve janë të miratuar 756 individë për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime si dhe janë të

licencuar 44 subjekte juridike nga të cilat 4 janë banka tregtare. Të dhënat për licencimin/miratimin për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime jepen në tabelën më poshtë.

Tabelë 25: Të dhëna mbi agjentë të licencuar në sigurime

(Në numër)

Statusi i agjentit	Të licencuar në fund të vitit 2019	Licenca të reja në 2020	Tërheqje licence, ndërprerje kontrate në 2020	Të licencuar në fund të vitit 2020
Persona juridikë	38	7	1	44
Nga ky numër, në banka	4	-	-	4
Person fizikë	679	106	29	756

Vlerësuesit e dëmeve në sigurime

Në tregun e sigurimeve janë të licencuar 54 individë si vlerësues dëmsh në sigurime nga të cilët 22 individë e ushtrojnë këtë veprimtari si të punësuar pranë një shoqërie sigurimi dhe 31 individë si vlerësues të pavarur.

Në 2020 u përfundoi afati i licencës 14 individëve nga të cilat 2 licenca u rinovuan brenda vitit, si dhe Autoriteti mori masa duke revokuar licenca si vlerësues dëmsh në sigurime për 6 individë për mos përmbushje të kërkesave ligjore.

Të dhëna mbi numrin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime, sipas statusit të vlerësuesit (i punësuar/i pavarur) dhe llojit të licencës (për dëme materiale dhe/ose shëndetësore) jepen në tabelën e mëposhtme.

Tabelë 26: Të dhëna mbi numrin e vlerësuesve të dëmeve të licencuar në sigurim

(Në numër)

Vlerësues sipas statusit/llojit të licencës	Të licencuar në fund të vitit 2019	Rinovuar licenca në 2020	Licenca të reja në 2020	Përfunduar afati i licencës në 2020	Hequr licenca, në 2020	Të licencuar në fund të vitit 2020
Sipas statusit të personit						
Të pavarur	35	-	-	4	3	31
Të punësuar	36	2	-	10	3	22
Sipas llojit të Licencës						
Dëme materiale	4	-	-	-	1	3

Dëme shëndetësore	18	-	-	3	-	15
Dëme materiale dhe shëndetësore	49	2	-	11	5	35
TOTALI	71	2	-	14	6	53

Qeverisja

Shoqëritë e sigurimit që operojnë në tregun shqiptar janë të organizuara sipas sistemit me një dhe me dy nivele qeverisjeje. Në shoqëritë me një nivel qeverisjeje, këshilli i administrimit ushtron funksionet e administrimit dhe të mbikëqyrjes, ndërsa tek shoqëritë me dy nivele qeverisjeje, këshilli mbikëqyrës ushtron funksione mbikëqyrjeje dhe administratori, apo bordi i drejtorëve, ushtron funksione administrimi. Nga 12 shoqëri sigurimi në fund të vitit 2019, 10 prej tyre ishin të organizuara sipas sistemit me dy nivele dhe vetëm dy shoqëri me një nivel. Gjatë vitit 2020, një prej shoqërive si rezultat edhe i ndryshimit të aksionarit kontrollues, ndryshoi formën e organizimit nga një nivel në dy nivele duke ndarë funksionet mbikëqyrëse nga ato administruese.

Autoriteti miratoi 34 riemërime në funksione drejtuese si anëtar të këshillit administrues/mbikëqyrës ose administrator të shoqërive të sigurimi, si dhe ka miratuar 11 emërime në këto funksione.

Shoqëritë e sigurimit janë kryesisht me kapital vendas, konkretisht nga 12 shoqëri sigurimi 9 janë me kapital vendas dhe 3 me kapital të huaj. Gjithashtu, nga 12 shoqëri sigurimi 11 prej tyre kanë aksionar influencues që zotëron mbi 50% të aksioneve.

Tabelë 27: Të dhëna për aksionarët e shoqërive të sigurimit

Subjekte	Numër	%
Shoqëri sigurimi	12	
Aksionarë gjithsej	38	
<i>Klasifikimi i aksionarëve sipas pjesëmarrjes zotëruese</i>		100
nën 10%	19	50
mbi 10% nën 20%	5	13.16
mbi 20% nën 33 %	2	5.26
mbi 33% nën 50%	1	2.63
mbi 50%	11	28.95
<i>Klasifikimi i aksionarëve sipas vendit të origjinës:</i>		100
Aksionarë të huaj	2	5.26
Aksionarë vendas	36	94.74

<i>Klasifikimi i aksionarëve sipas statusit</i>		100
Aksionarë individë	29	76.32
Aksionarë shoqëri	9	23.68

Autoriteti ka miratuar kërkesat e shoqërive të sigurimit në lidhje me ndryshimet statutores, sipas tabelës së mëposhtme:

Tabelë 28: Të dhëna mbi miratimin e ndryshimeve statutores (Në numër)

Arsyeja e ndryshimit të Statutit	2016	2017	2018	2019	2020
Statut i ri/ndryshime të tjera	4	2	3	1	-
Rritje kapitali	2	1	3	1	2
Ndryshim i strukturës aksionare	4	1	1	-	3

3.5 Masat mbikëqyrëse dhe administrative

Legjislacioni që rregullon veprimtarinë e subjekteve financiare nën mbikëqyrjen e AMF-së si dhe ligji “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” parashikon masa korrigjuese dhe administrative me qëllim parandalimin, korrigjimin apo ndërprerjen e rrethanave e veprimeve që përbëjnë shkelje të dispozitave ligjore ose akteve të Autoritetit.

Bordi AMF-së, gjatë vitit 2020, ka marrë 20 (njëzet) vendime për masa administrative e korrigjuese ndaj subjekteve të mbikëqyrura si rezultat i konstatimeve të bëra nga analizimi i treguesve financiarë, nga inspektimet në vend të kryera nga Autoriteti etj.

Në Tregun e sigurimeve janë marrë 13 vendime, ku sipas llojit të masave paraqiten të detajuara si më poshtë:

- Marrje mase mbikëqyrëse ndaj shoqërive të sigurimit, ku përfshihen plane biznesi, plane veprimi, shkarkim funksionar kryesor/urdhër për ristrukturim, sanksion me gjobë;
- Revokim licence ndaj një shoqërie brokerimi në sigurime;
- Revokim licence ndaj gjashtë vlerësuesve të pavarur;
- Paralajmërim për pezullim licence për një aktuar.

Në Tregun e titujve janë marrë 7 vendime, ku sipas llojit të masave paraqiten të detajuara si më poshtë:

- Çregjistrim të dy shoqërive që ushtrojnë veprimtarinë si agjent i brokerit të huaj;

- Pezullim i veprimtarisë për një shoqëri që ushtron veprimtarinë si agjent i brokerit të huaj;
- Përfundim licence për një shoqëri që ushtron veprimtarinë e këshillimit për investime në tituj;
- Heqje licence për një këshilltar në investime;
- Heqje licence të dy shoqërive për ushtrimin e veprimtarisë së brokerit në tregun e titujve;
- Heqje licence për dy broker në tregun e titujve;
- Sanksion me gjobë agjentit të brokerit të huaj dhe administratorit të tij.

Kapitulli 4

PROCESET INTEGRUESE DHE BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL

4.1 Proceset integruese për tregjet nën mbikëqyrje

Roli i AMF-së në Integrimin Evropian

AMF ka vijuar të japë kontributin në përmbushjen e detyrimeve, që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, Raport e Progresit të Komisionit Evropian, Nënkomitetet e përbashkëta BE-Shqipëri si dhe Planin Kombëtar për Integrimin Evropian. Harmonizimi i legjislacionit të brendshëm të shërbimeve financiare me *acquis* është një nga objektivat e institucionit.

Në fushën e shërbimeve financiare jobankare është konsoliduar puna për rishikimin e kuadrit rregullator dhe mbikëqyrës duke synuar përafrimin e mëtejshëm të tij me *acquis* e BE-së dhe është bërë progres i konsiderueshëm në përafrimin e legjislacionit të tregut të kapitaleve, gjë që nënvizohet edhe në Raportin e fundit të KE-së për Shqipërinë. Në Raportin e KE-së 2020 për Shqipërinë vihet në dukje miratimi i dy ligjeve të rëndësishme, ligji nr. 62/2020 "Për Tregjet e Kapitalit", miratuar më 14.05.2020 dhe hyrë në fuqi më 1.09.2020 dhe ligji nr. 56/2020 "Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive", miratuar më 30.04.2020 dhe hyrë në fuqi më 20.06.2020. Këto dy ligje janë përafëruar me direktiva dhe rregullore shumë të rëndësishme të BE, pjesë e *acquis* së Kapitullit 9. Në lidhje me adresimin e rekomandimeve të dala nga Raporti 2020 i Komisionit Evropian, autoriteti ka punuar për përafrimin e kuadrit rregullator. AMF hartoi projektligjin "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", në zbatim të MSA-së, rekomandimeve të Progres Raporteve, si dhe rekomandimeve të dhëna nga misioni i përbashkët FMN dhe Banka Botërore.

Në kuadër të proceseve integruese, ka vijuar puna për koordinimin dhe përgatitjen e raportimeve në lidhje me Kapitullin 9 "Shërbimet Financiare", kapitull për të cilin Autoriteti është lider. Gjithashtu, Autoriteti kontribuon edhe në kapitujt, Kriteri Ekonomik, Kapitulli 2 - Liria e lëvizjes së punëtorëve, Kapitulli 3 - Liria për të ofruar shërbime, Kapitulli 4 - Lëvizja e lirë e kapitalit, Kapitulli 6 - Legjislacioni për shoqëritë tregtare, Kapitulli 17- Politika ekonomike dhe monetare dhe Kapitulli 28 - Mbrojtja e konsumatorit.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv Z. Ervin Mete është zgjedhur negociator i Kapitullit 9 "Shërbimet Financiare", me Vendimin nr. 422, datë 06.05.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përbërjen, rregullat e funksionimit dhe trajtimit financiar të grupit negociator dhe detyrat e Kryenegociatorit për zhvillimin e negociatave të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian", i ndryshuar. Në kuadër të takimeve mbi proceset integruese, janë realizuar 6 takime me Kryenegociatorin, si dhe raportime javore dhe tremujore mbi ecurinë e proceseve të integritetit si dhe realizimin e akteve ligjore të parashikuara për Kapitullin 9.

Autoriteti ka monitoruar rregullisht zbatimin e MSA-së, si dhe Planin Kombëtar për Integrimin Evropian. Përfaqësues nga autoriteti kanë marrë pjesë në takimet e nënkomiteteve përkatëse si dhe kanë kryer raportime të detajuara në kuadër të Integrimit Evropian, më konkretisht:

- Takimi i 11-të i Nënkomitetit Tregu i Brendshëm dhe Konkurrenca duke përfshirë Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Shëndetit, 22 prill 2020;
- Takimi i 12-të i Nënkomitetit Çështjet Ekonomike – Financiare & Statistikat, 11-12 nëntor 2020;

Vlerësimi i palës evropiane gjatë këtyre raportimeve ishte pozitiv për veprimtarinë e AMF-së dhe rekomandimi për AMF në Raportin e KE-së për Shqipërinë ishte miratimi i projektligjit “Për sigurimin e detyrueshëm motorik në sektorin e transportit”.

AMF ka vazhduar bashkëpunimin me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme si institucioni koordinues në procesin e integrimit evropian. Janë përgatitur raporte të cilat pasqyrojnë progresin e arritur duke kontribuar në hartimin e dokumenteve që lidhen me procesin e Stabilizim-Asociimit. Hartimi dhe miratimi i akteve të parashikuara në Planin Kombëtar të Integrimit Evropian (PKIE) për periudhën 2020-2022, është ndjekur në vazhdimësi.

Janë përgatitur katër kontribute për progresin e bërë nga Autoriteti, për raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2020, për Kapitullin 9 dhe kapitujt e tjerë ku kontribuojmë. Autoriteti, në cilësinë e koordinatorit të Kapitullit 9 “Shërbimet Financiare” në bashkëpunim me institucionet kontribuese në këtë kapitull, Banka e Shqipërisë (BSH), Instituti i Statistikave (INSTAT), Agjencia e Sigurimit të Depozitave (ASD) Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ), ka zhvilluar 3 takime të GNPIE-së, si dhe ka marrë pjesë në takimet e GNPIE-ve të kapitujve ku institucioni është kontribues.

Në kuadër të Takimit Bilateral (*Bilateral Screening*) AMF ka realizuar:

- Hartimin e tabelës së mangësive ligjore për Kapitullin 9 dhe kapitujve ku AMF kontribuon;
- Përgatitjen e tabelës së Analizës së Mangësive Institucionale dhe Administrative për Kapitullin 9 si dhe për kapitujt e tjerë.

4.2 Parandalimi i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

Autoriteti, lidhur me çështjet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit është angazhuar në procesin e adresimit të rekomandimeve të lëna nga Komiteti MONEYVAL i Këshillit të Evropës, si dhe në zbatimin e planit të veprimit të ICRG/FATF në lidhje me masat e marra kundër PP/FT.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është pjesë e grupit ndërinstitutional ngritur me Vendimin nr.1, datë 19.2.2020 të Komitetit të Bashkërendimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave, për

ndjekjen dhe përmbushjen e rekomandimeve të lëna nga Grupi Posaçëm i Veprimit Financiar, (FATF) dhe Grupit të Shqyrtimit të Bashkëpunimit ndërkombëtar (ICRG).

Ndërmjet AMF dhe DPPP më 22 maj 2020, është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit, me qëllim angazhimin, bashkëpunimin e ndërsjellë, ndjekjen dhe raportimin për përmbushjen e rekomandimeve të FATF, si dhe të detyrave në “Planin e veprimit” të ICRG/ FATF. Autoriteti është angazhuar dhe ka dhënë kontribut në realizimin e planit të veprimit të miratuar.

Në kuadër të adresimit të rekomandimeve të lëna nga Komiteti MONEYVAL i Këshillit të Evropës (KiE), si dhe pas miratimeve të Ligjit nr. 66/2020 “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë” dhe Ligjit Nr. 62/2020 “Për tregjet e kapitalit”, Autoriteti ka miratuar disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren 58/2015, e ndryshuar “Mbi masat e vigjilencës së duhur dhe të zgjeruar nga subjektet e ligjit për PPP/FT”.

Gjatë 2020 janë kryer inspektime nga zyra, për subjektet e ligjit për PPP/FT, nën mbikëqyrjen e Autoritetit. Rezultati i analizës për kategorizimin e rrezikut, bazuar në formularët e vetëvlerësimit për vitin 2019, dalë nga matrica e vlerësimit të kriterit, ka rezultuar “*Nivel i Ulët i Rrezikut*”, për të gjitha subjektet e lartpërmendura.

Autoriteti ka vijuar kryerjen e inspektimeve në kuadër të Planit të Veprimit ICRG/FATF, lidhur me verifikimin e zbatimit të dispozitave ligjore përsa i përket sanksioneve ndërkombëtare (TFS). Gjatë vitit 2020 janë kryer 20 inspektime të dedikuara për TFS, nga të cilat 3 (tre) në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë dhe 4 (katër) në bashkëpunim me DPPP, konkretisht: 7 (shtatë) pranë bankave që ushtrojnë veprimtarinë e kujdestarisë; 2 (dy) pranë bankave depozitare; 6 (gjashtë) pranë shoqërive administruese të Fondeve të Pensioneve dhe Fondeve të Investimeve dhe 5 (pesë) pranë shoqërive të sigurimit të Jetës dhe risigurimit.

Autoriteti në bashkëpunim me DPPP, ka organizuar 2 trajnime me temë “Mbi zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare mbi subjektet e ligjit”. Pjesëmarrës në këto trajnime ishin subjektet banka që ushtrojnë veprimtarinë e Kujdestarisë dhe Depozitarët, si dhe subjektet e tregut të sigurimeve (shoqërive të sigurimit të Jetës dhe risigurimit), si dhe tregut të fondeve.

Lidhur me forcimin e kapaciteteve të AMF-së, për PP/FT, stafi i Autoritetit ka marrë pjesë në disa trajnime të organizuara nga Këshilli i Evropës dhe FATF, organizuar për institucionet raportuese.

4.3 Bashkëpunimi Rajonal dhe Ndërkombëtar

Edhe gjatë vitit 2020 Autoriteti ka vijuar *online* bashkëpunimin me institucionet homologe të rajonit, nëpërmjet shkëmbimit të informacionit dhe eksperiencave në aspektin rregullator e

mbikëqyrës, sidomos në kuadër të situatës së pandemisë Covid-19, me synim rritjen e efektivitetit të mbikëqyrjes së tregjeve financiare jobankare.

Banka Qendrore e Kosovës (BQK)

Bashkëpunimi i AMF-së me Bankën Qendrore të Kosovës (BQK) vijoi edhe gjatë vitit 2020. Në muajin nëntor është finalizuar Memorandumi i Mirëkuptimit midis dy autoriteteve. Rivitalizimi i marrëveshjes ndërmjet AMF dhe BQK ka në fokus forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional në funksion të mirëregullimit të tregjeve nën mbikëqyrje. Nëpërmjet këtij Memorandumi, autoritetet do të bashkëpunojnë më ngushtë në çështje lidhur me grupet e sigurimit që ushtrojnë veprimtari në të dy vendet dhe do të adresojnë çështje e problematika të shfaqura nga subjektet nën mbikëqyrje.

Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut (ISA)

AMF ka një bashkëpunim të mire me Agjencinë e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut (ISA). Marrëveshja e Mirëkuptimit midis dy institucioneve, e cila është në fuqi që prej vitit 2010, ndikon pozitivisht në efikasitetin e mbikëqyrjes dhe rregullimit të industrisë së sigurimeve të dy vendeve, sidomos në kushtet e shtrirjes së veprimtarisë të shoqërive shqiptare të sigurimit në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në këtë kuadër edhe gjatë vitit 2020 AMF ka pasur korrespondencë dhe shkëmbime informacioni me ISA.

Agjencia Kroate e Mbikëqyrjes së Shërbimeve Financiare (HANFA)

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Agjencia Kroate e Mbikëqyrjes së Shërbimeve Financiare (HANFA), duke parë nevojën për bashkëpunim të ndërsjellë, gjatë vitit 2020 shprehën gatishmërinë e tyre për të bashkëpunuar në bazë të besimit dhe mirëkuptimit të ndërsjellë. Gjatë vitit 2020 u punua për hartimin e MoU me HANFA e cila synon vendosjen e marrëdhënieve zyrtare për bashkëpunim dhe asistencë të ndërsjellë, si dhe shkëmbim informacioni dhe eksperience lidhur me praktikat mbikëqyrëse dhe rregullatore për tregjet e sigurimeve, fondeve të pensioneve private dhe kapitaleve. MoU do t'i hapë rrugë një bashkëpunimi të frytshëm për projekte të përbashkëta në kuadër të forcimit të rolit të AMF-së dhe në kuadër të proceseve të saj integruese në BE.

Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Sllovenisë (AZN)

Në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit të nënshkruar ndërmjet Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve (AZN) për bashkëpunimin reciprok, edhe gjatë vitit 2020 ka vijuar shkëmbimi i informacionit dhe eksperiencave më të mira të të dy vendeve për mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve. AZN në bashkëpunim me Qendrën e

Ekselencës në Financë (CEF) organizuan një seminar rajonal *online*, me fokus mbikëqyrjen në sektorin e sigurimeve dhe menaxhimin e rrezikut, ku morën pjesë edhe përfaqësues të Autoritetit.

Iniciativa Rajonale për mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve në rajonin e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore (CESEE-ISI)

AMF është pjesëmarrëse aktive në nismën rajonale “Iniciativa Rajonale për mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve në rajonin e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore (CESEE-ISI). Si pjesë e kësaj iniciative, përfaqësues të Autoritetit morën pjesë në webinarin “Insurtech Israel Virtual Showcase”, me fokus gjenerimin e inovacioneve teknologjike në sektorin e sigurimeve, dedikuar vendeve të rajonit të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore.

Takimi i Autoriteteve të tregut të Kapitalit të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor (WB6)

Në kuadër të bashkëpunimit midis vendeve të rajonit, gjatë muajit shkurt të vitit 2020, u organizua në Podgoricë, Mali i Zi një *workshop* me temë: “*Technical Workshop on Markets in Financial Instruments Directive (MiFID II) Western Balkan’s Perspective*”. Agjenda e Tregjeve Financiare të Ballkanit Perëndimor është një komponent i rëndësishëm i zhvillimeve të Planit Shumëvjeçar të Veprimit për Zonën Ekonomike Rajonale (MAP REA), koordinuar nga Sekretariati i Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RCC). Platforma kryesore rajonale përgjegjëse e kësaj agjende është Grupi i Punës për Tregjet Financiare që kontribuon në zbatimin e agjendave përkatëse të MAP REA, me synim përmirësimin e tregut financiar të Ballkanit Perëndimor si dhe harmonizimin e legjislacionit të shërbimeve financiare me atë të BE-së.

Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS)

AMF është anëtare e Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS), që prej vitit 2001. Themeluar në vitin 1994, IAIS përfaqëson rregullatorët dhe mbikëqyrësit e më shumë se 200 juridiksioneve në rreth 140 vende. Objektivat e saj janë mbikëqyrja sa më efektive e industrisë së sigurimeve për zhvillimin dhe ruajtjen e tregjeve, mbrojtjen e të siguruarit, si dhe duke kontribuar në stabilitetin financiar global.

Në përballimin e situatës së krijuar nga COVID-19, IAIS vuri në dispozicion të anëtarëve një bazë të dhënash të posaçme për informim dhe plotësim të përditësuar mbi masat mbikëqyrëse të ndërmarra nga çdo vend anëtar në përballimin e situatës së jashtëzakonshme.

Gjatë vitit 2020, AMF mori pjesë aktive në takimet e nivelit të lartë, Mbledhjet e Përgjithshme Vjetore, mbledhjet e Komiteteve Teknike dhe Ekzekutive dhe Konferencën Vjetore të 27-të të kësaj organizate të zhvilluara në format virtual. Gjatë Mbledhjes së përgjithshme vjetore Komiteti Ekzekutiv përcaktoi 4 (katër) prioritetet të cilat janë vlerësuar dhe nga AMF si shumë të domosdoshme për periudhën pandemike.

Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Titujve (IOSCO)

AMF është anëtare me të drejta të plota në Organizatën Ndërkombëtare të Komisioneve të Titujve (IOSCO) dhe njëkohësisht nënshkruese e Memorandumit Shumëpalësh të Mirëkuptimit të IOSCO-s që prej vitit 2009. Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Titujve është organ ndërkombëtar që mbledh së bashku pjesën më të madhe të rregullatorëve të titujve në gjithë botën dhe njihet si hartues i standardeve globale për sektorin e titujve. IOSCO zhvillon, zbaton dhe promovon respektimin e standardeve të njohura ndërkombëtare për rregullimin e titujve.

AMF mori pjesë në mbledhjet e Komitetit Rajonal të Evropës të IOSCO-s, *European Regional Committee (ERC)*, Komitetit të Tregjeve në Rritje e Zhvillim, *Growth and Emerging Markets Committee (GEMC)*, Komitetit të Presidentëve dhe në grupin e Monitorimit të Marrëveshjeve Shumëpalëshe të Mirëkuptimit, *MMoU Monitoring Group*, të cilat u zhvilluan në format virtual. IOSCO në kuadër të krizës COVID-19 përcaktoi disa rekomandime, të cilat u përshtatën dhe nga Autoriteti.

Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Pensioneve (IOPS)

AMF është anëtare me të drejta të plota, si dhe pjesë aktive e strukturave të kësaj organizate që nga viti 2006. IOPS është organizatë e pavarur ndërkombëtare e krijuar në vitin 2004 me iniciativë të OECD-së, Rrjetit Ndërkombëtar të Rregullatorëve dhe Mbikëqyrësve të Pensioneve (INPRS), me qëllim përfaqësimin e interesave të enteve rregullatorë të pensioneve private.

Gjatë vitit 2020, midis AMF-së dhe IOPS-it ka patur një bashkëpunim të mirë nëpërmjet rekomandimeve dhe planeve të veprimit për përballimin e situatës emergjente të shkaktuar nga COVID-19, duke patur si prioritet përmbushjen e udhëzimeve *ad-hoc* bazuar në planin e veprimit të grupit të punës të pensioneve private. AMF i është përgjigjur në kohën e duhur pyetësorëve lidhur me masat e marra dhe politikat e ndjekura për mbrojtjen e konsumatorëve në rastin e situatave emergjente. Njëkohësisht Autoriteti ka kontribuar si çdo vit në raportimet e përvitshme lidhur me indikatorët dhe statistikën, trendet dhe ndryshimet e fondeve të pensioneve 2019 dhe kontratat e sigurimeve, praktikë që ndiqet çdo vit nga të gjitha vendet anëtare të IOPS/OECD. Në qershor 2020, OECD zhvilloi një takim-seksion special mbi Task-Force për mbrojtjen e konsumit financiar dhe FinCoNet.

Gjithashtu, vlen të përmendet kontributi i IOSCO-s dhe IAIS-it në organizimin e trajnimeve dhe seminareve teknike-profesionale për stafet e autoriteteve të vendeve anëtare, programeve të asistencës teknike dhe konferencave në bashkëpunim dhe me organizma ndërkombëtare financiare.

4.4 Projekte

Projekti “Përmirësimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare – BB/ SECO - II: “Fokus Zhvillimi i Tregut të Kapitaleve” (2020-2022)

Projekti “Fuqizimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare: Fokusi tek zhvillimi i tregut të kapitaleve” synon të mbështesë AMF-në në forcimin e kapaciteteve të saj në rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregut të kapitalit, si dhe të zhvillojë tregun e kapitalit dhe produktet e tij përmes rritjes së ndërgjegjësimit, edukimit financiar dhe nxitjes së inovacionit financiar. Ky projekt financohet nga granti dhënë nga Qeveria e Konfederatës Zvicerane e përfaqësuar nga Sekretariati Shtetëror për Çështje Ekonomike (SECO), dhe mbështetet nga Banka Botërore. Projekti pritet të nisë zbatimin gjatë vitit 2021 dhe do të zgjasë deri në Dhjetor të vitit 2022.

Fushat kryesore të asistencës teknike janë:

- Fuqizimi i funksioneve rregullatore dhe mbikëqyrëse të AMF-së. Mbështetje për përgatitjen e rregulloreve dhe udhëzimeve përkatëse në lidhje me ligjet e miratuara rishtazi për tregjet e kapitalit në Shqipëri;
- Fuqizimi i mbikëqyrjes me bazë rrezikun për tregjet e kapitalit;
- Zhvillimi i kapaciteteve të AMF-së për të monitoruar dhe mbikëqyrur tregjet e letrave me vlerë;
- Mbështetja e AMF-së në punën për zhvillimin e tregjeve të kapitalit, nëpërmjet ndërgjegjësimit dhe edukimit financiar.

Gjatë vitit 2020 është punuar për hartimin dhe publikimin e Termave të Referencës së këtij projekti dhe në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Financimeve dhe Kontaktimeve për fondet e BE-së, BB-së, dhe Donatorëve të tjerë (CFCU) pritet të përmbyllet procedura e tenderimit në fillim të vitit të ardhshëm.

Projekti “Përmirësimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare – BB/ SECO - II: “Fokus Zhvillimi i Tregut të Sigurimeve” (2019-2022)

AMF siguroi mbështetje me asistencë teknike nga Banka Botërore dhe po vijon bashkëpunimin me konsulentët dhe grupin e punës në Autoritet për zbatimin e projektit të financuar nga SECO, “Përmirësimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare -“Fokus Zhvillimi i Tregut të Sigurimeve”.

Objekti i zhvillimit të projektit është të (a) të forcojë kapacitetin e AMF-së për të rregulluar dhe mbikëqyrur sektorin e sigurimeve dhe (b) të forcojë zhvillimin e tregut për sigurimet përmes rritjes së vetëdijes dhe besimit të konsumatorit.

Gjatë vitit 2020 për realizimin e komponentëve të këtij projekti, është punuar sipas planit të zbatimit të dakordësuar në drejtim të forcimit të kapaciteteve mbikëqyrëse, konkretisht me:

- **Metodologjia e treguesve të rrezikut të sigurimit**

Mbështetja e AMF-së për të forcuar kapacitetin e mbikëqyrjes së sigurimeve dhe për të zbatuar rregulloret ekzistuese. Metodologjia e analizës mbikëqyrëse të parashikuar nga treguesit e rrezikut të sigurimit pas diagnostikimit; Përmirësimi i aftësisë së AMF për të vlerësuar disponueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e modeleve të biznesit të ndërmarra të sigurimeve. Zhvillimi i një qasje mbikëqyrëse efektive me shpërndarje të qartë të roleve.

- **Zhvillimin e një udhërrëfyese të nivelit të lartë për zbatimin e Solvency II, në përputhje me strategjinë e aprovuar nga AMF**

Asistencë në procesin e vlerësimi të praktikave mbikëqyrëse të AMF-së kundrejt standardeve ndërkombëtare të sigurimeve; Rishikimi i kornizës rregullatore në lidhje me mbikëqyrjen e grupeve të sigurimeve dhe dhënia e rekomandimeve për fushat kryesore të mbikëqyrjes së grupeve të sigurimeve.

- **Përmirësimin e kuadrit rregullator dhe të procedurave të falimentimit dhe likuidimit të kompanive të sigurimit**

Rishikimi i procedurave të falimentimit dhe likuidimit të kompanive të sigurimit, ligjeve dhe rregulloreve përkatëse; Këshillim për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe rregullator, si dhe të procedurave; Mbështetja për ngritjen e kapaciteteve.

- **Rritja e besimit të konsumatorit në sigurime** duke përfshirë transparencën dhe llogaridhënien e subjekteve të sigurimit tek konsumatorët, zhvillimi i një sistemi të monitorimit publik të cilësisë së shërbimit të siguruesve dhe performancës së kërkesë-ankesave.

Projekte me asistencë teknike të Korpusit Vullnetar të Shërbimeve Financiare – FSVC

Në kuadër bashkëpunimit me Korpusin Vullnetar të Shërbimeve Financiare (FSVC) mbështetur nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), puna gjatë 2020 është përqendruar në: konsulencën për hartimin e draft dispozitave mbi mënyrën e trajtimit të posaçëm të aseteve të fondit të pensionit në rast falimentimi të shoqërisë administruese.

Gjithashtu, FSVC gjatë tremujorit të fundit të vitit 2020, ndihmoi Autoritetin me ekspertizën e konsulentëve të saj, në hartimin e Planit të Vazhdimësisë së Aktivitetit (*Business Continuity Plan*). Plani i vazhdimësisë së biznesit (operacional), u vlerësua si prioritet për Autoritetin në kushtet e pandemisë COVID-19. Ky plan ndihmon në rritjen e qëndrueshmërisë dhe kundërpërgjigjes së çdo pasojë, me synim ruajtjen e standardeve në funksion të mbikëqyrjes të tregjeve në tërësi.

Bashkëpunim me Sparkassenstiftung -SIZ, mbështetur nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) për përmirësimin e njohurive financiare në Shqipëri

Sparkassenstiftung für internationale Kooperation është një agjenci implementuese e Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ), e cila synon të rrisë aksesin, përdorimin dhe cilësinë e shërbimeve financiare në të gjithë botën, duke mbështetur partnerë qeveritarë, joqeveritarë dhe sektorët privatë në zbatimin e masave të përbashkëta të zhvillimit. Ka filluar bashkëpunimi për zbatimin e një projekti për edukimin financiar duke përfshirë ndërtimin e kapaciteteve trajnuese të AMF-së për bizneset e vogla dhe sipërmarrësit rurale, si dhe mbështetjen e sektorit financiar në zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve relevante.

4.5 Bashkëpunimi me institucionet e vendit

AMF ka një rol të rëndësishëm për zhvillimin dhe ruajtjen e stabilitetit të qëndrueshëm financiar të vendit. Bashkëpunimi i rregullatorëve të ndryshëm është konsideruar mjaft i rëndësishëm për ecurinë e tregjeve financiare. Për t'i shërbyer këtij bashkëpunimi edhe gjatë vitit 2020 janë thelluar marrëdhëniet me institucionet më të rëndësishme financiare në vend apo institucione e grupe të tjera interesi, veprimtaria e të cilëve lidhet direkt ose indirekt me aktivitetin mbikëqyrës apo rregullator.

MoU me Bankën e Shqipërisë në kuadër të një mbikëqyrjeje të konsoliduar të tregjeve.

Gjatë vitit 2020 është kryer puna përgatitore për hartimin dhe nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet AMF-së dhe Bankës së Shqipërisë. Kjo marrëveshje do të ketë në fokus forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, në funksion të rritjes dhe forcimit të sistemit financiar, si edhe garantimit të një mbikëqyrjeje të konsoliduar të tregjeve financiare. Nëpërmjet kësaj MoU, dy autoritetet rregullatore të tregjeve financiare do të bashkëpunojnë më ngushtë në çështje që lidhen me shkëmbime të ndërsjellta në kuadër të Grupit Kombëtar të Stabilitetit Financiar dhe krijimin e komiteteve të përbashkëta në kuadër të zhvillimit të tregjeve, trajtimin e krizave dhe situatave të jashtëzakonshme dhe bashkëpunimin në funksion të luftës kundër pastrimit të parave.

MoU me Autoritetin e Konkurrencës në funksion të mbrojtjes konsumatore

Në kuadër të fuqizimit dhe të rivitalizimit të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet dy autoriteteve e cila datonte që në 2006, ku fokus është mbrojtja konsumatore, gjatë vitit 2020 është punuar për hartimin dhe nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit mes AMF-së dhe AK-së. Ky Memorandum Mirëkuptimi, u miratua në nëntor 2020, do të bashkërendojë më tej veprimet dhe mbështetjen reciproke në funksion të mbrojtjes së konkurrencës së lirë dhe efektive në tregjet nën mbikëqyrje të AMF-së.

Kapitulli 5

MBROJTJA KONSUMATORE DHE TRANSPARENCA ME PUBLIKUN

5.1 Mbrojtja e Konsumatorit dhe Investitorit

Mbrojtja e interesave të investitorëve dhe të personave të siguruar është një nga objektivat kryesore të Autoritetit, në përmbushjen e funksioneve dhe kompetencave të shprehura në misionin e tij. Edhe gjatë vitit 2020, mbrojtja e konsumatorëve dhe investitorëve ka zënë një vend të rëndësishëm në veprimtarinë e Autoritetit. Në këtë drejtim puna dhe angazhimi i Autoritetit është fokusuar kryesisht në:

- Shqyrtimin e ankesave të konsumatorëve apo të investitorëve; dhe
- Monitorimin e veprimtarisë promociionale të subjekteve të mbikëqyrura.

Shqyrtimi dhe trajtimi i ankesave të konsumatorëve dhe investitorëve

Regjistri i ankesave bën të mundur depozitimin dhe ndjekjen nga ankimuesi të procesit të trajtimit të ankesës nëpërmjet sistemit *online*, për çdo pretendim që mund të kenë konsumatorët për shërbimet që ata përfitojnë nga subjektet që veprojnë në tregjet e mbikëqyrura nga Autoriteti. Nëpërmjet regjistrit *online* të ankesave u depozituan në Autoritet 181 ankesa lidhur me çështje të sigurimeve, ose rreth 93% më shumë se gjatë vitit 2019. Gjithashtu, ka pasur përkatësisht dhe nga një ankesë, lidhur me fondet e investimeve dhe fondet vullnetare të pensioneve.


Trajtimi i ankesave është bërë brenda afateve, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, në mënyrë profesionale, të paanshme e të shpejtë. Pas përfundimit të shqyrtimit të ankimit, në rastet kur është konstatuar që shoqëria e sigurimit nuk ka zbatuar kërkesat e ligjit dhe/apo kushtet e kontratës së sigurimit, çështja e ankimit është kthyer për rishqyrtim shoqërisë së sigurimit, duke vënë në dijeni dhe ankimuesin.

Nëpërmjet shqyrtimit të ankesave të depozituara, Autoriteti merr informacion mbi cilësinë e shërbimeve të ofruara konsumatorëve dhe investitorëve nga subjektet nën mbikëqyrje dhe sipas rastit ndërhyr për përmirësimin e politikave dhe procedurave të subjekteve të mbikëqyrura, me qëllim parandalimin e sjelljeve jo-korrekte ndaj konsumatorit. Nëpërmjet shqyrtimit të ankesave synohet gjithashtu të sigurohet zbatimi i kuadrit ligjor nga ana e subjekteve të mbikëqyrura, me transparencë, në mirëbesim dhe në respektim të të drejtave të personave të siguruar.

Siç pasqyrohet në grafikun e mëposhtëm, nga statistikatat e ankesave për çështje lidhur me sigurimet, konstatohet se pjesa më e madhe e tyre i përket sigurimit të detyrueshëm motorik në sektorin e transportit, me gjithsej 92 raste (51%), nga 181 ankesa të depozituara në Autoritet gjatë vitit 2020.

Pas ankesave në lidhje me sigurimin e detyrueshëm motorik në sektorin e transportit, një pjesë e konsiderueshme e ankesave lidhen me sigurimin nga tërmeti, për rastet e dëmeve të tërmetit të datës 26 nëntor 2019. Këto janë 33 raste, ose 18% e totalit të ankesave në tregun e sigurimeve, duke vijuar me 9 raste për sigurimin Kasko, 6 raste dëmsh të Fondit të Kompensimit, 4 raste sigurimi i Jetës dhe shëndetit, 2 raste të sigurimeve inxhinierike (CAR), 2 raste sigurimi të ndërtuesve, si dhe lloje të tjera mbulimesh në sigurime me nga 1 rast.

Grafik 25. Ankesat sipas klasës së sigurimit (Në %)




Shkaqet kryesore të ankesave gjatë vitit 2020, kanë qenë:

- Tejkalmi i afatit të pagesës apo trajtimit të praktikave të dëmit nga shoqëria e sigurimit;
- Mospajtim nga i siguruari me vlerën e dëmshpërblimit;
- Refuzim i ngjarjes së sigurimit nga shoqëria e sigurimit.


Nga analizimi i shkaqeve të ankesave gjatë vitit 2020, siç paraqitet edhe në grafikun e mëposhtëm, për 92 rastet e sigurimit TPL rezulton se: 52 ankesa kanë qenë për tejkalm afati të trajtimit të dëmit, 21 ankesa për mos pajtim të të siguruarit me vlerën e dëmshpërblimit, 8 ankesa për shkak të refuzimit të ngjarjes së sigurimit dhe 11 ankesa për shkaqe të tjera.

Autoriteti ka marrë masa në lidhje me ankesat e konsumatorëve për sigurimin TPL, sipas rastit, duke i kërkuar shoqërive të sigurimit të kryejnë rivlerësim të vlerës së dëmit, apo në rast të refuzimit të ngjarjes së sigurimit nga shoqëria, të rishikojnë praktikën e dëmit.

Në konkluzion, referuar të dhënave të pasqyruara në regjistrin e ankesave për vitin 2020, ka përfunduar trajtimi për 99% të ankesave të depozituara (181 ankesa të depozituara, 2 në proces, 179 të përfunduara).

Grafik 26. Ankesat sipas arsyes së anketimit për sigurimin TPL e Brendshme (Në %)

Nga analizimi i shkaqeve për 33 rastet e ankesave të depozituara në lidhje me Sigurimin nga Tërmeti, siç ilustruhet në grafikun e mëposhtëm, rezulton se: 13 ankesa kanë qenë për tejkalim afati, 17 ankesa për vlerën e dëmshpërblimit dhe 3 ankesa për shkak të refuzimit të ngjarjes së sigurimit. Në disa raste ankesash nga të sigurvearit në lidhje me vlerën e dëmshpërblimit, nga shoqëria e sigurimit është kryer rivlerësimi i dëmit pas ndërhyrjes së Autoritetit.

Grafik 27: Ankesat sipas arsyes së anketimit për sigurimin nga tërmeti (Në %)

Monitorimi i nivelit të informacionit të disponueshëm për publikun gjatë veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregjet nën mbikëqyrje

Përveç shqyrtimit të ankesave të konsumatorëve, Autoriteti, në zbatim të nenit 66, të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit”, ka bërë edhe monitorim e faqeve web të shoqërive të sigurimit, lidhur me detyrimin për informimin e publikut mbi:

- Informacione të përgjithshme rreth shoqërisë së sigurimit, aksionarëve dhe strukturës administrative, si dhe kapitalit;
- Klasat e sigurimit ku ushtron veprimtari, shërbimet e sigurimit dhe produktet e ofruara për ato klasa;
- Informacione për kushtet e veçanta, rreziqet dhe mbulimet që nuk ofrohen rregullisht për një produkt sigurimi, por që mund të përfshihen si shtesë në dispozitat e kushteve të veçanta;
- Informacione për të drejtat dhe detyrimet e të sigurvearit dhe palëve të tjera të interesuara, si dhe për procedurën që duhet ndjekur në rast të ndodhjes së rrezikut;
- Informacionin për taksat/tatimet e zbatueshme;
- Adresën, adresën e postës elektronike, numrin e telefonit dhe faksit të të gjitha strukturave dhe njësive të shoqërisë së sigurimit, përfshirë edhe atë të selisë qendrore të saj;
- Procedurën për trajtimin e kërkesës për dëmshpërblim;
- Formularët elektronikë që i lejojnë të sigurvearit dhe palëve të tjera të interesuara të depozitojnë kërkesa për informacion dhe dëmshpërblim nëpërmjet internetit;
- Statistika dhe informacione të tjera të rëndësishme;
- Pasqyrat financiare më të fundit të audituara, së bashku me opinionin e audituesit.

Informacioni për produktet e ofruara konsumatorëve, duhet të përmbajë të dhëna të qarta, të vërteta dhe të plota, me qëllim mbrojtjen e konsumatorit. Pas verifikimeve, situata e informacionit të detyrueshëm për t’u publikuar paraqitet e përmbushur.

5.2 Monitorimi i Ndërmjetësve Financiarë

Monitorimi i ndërmjetësve në tregut e sigurimeve

Gjatë vitit 2020, Autoriteti në kuadër të mbrojtjes së interesave të konsumatorit, si objektiv kryesor të tij, ka monitoruar rast pas rasti nëpërmjet raportimeve periodike, apo verifikimeve në vend, zbatimin e kërkesave ligjore dhe rregullatore të aktivitetit të agjentëve/punonjësve, kryesisht të atyre që ushtrojnë veprimtarinë e shitjes së policave të sigurimit të detyrueshëm TPL, si dhe shoqërive të brokerimit në sigurime. Pjesë e këtyre verifikimeve ka qenë edhe shqyrtimi i ankesave të depozituara në Autoritet.

Gjithashtu, për shkak të situatës së krijuar prej pandemisë globale COVID-19, Autoriteti në kuadër të ndjekjes me kujdes të zhvillimeve në tregun e sigurimeve, me qëllim marrjen e masave për

minimizimin e pasojave të kësaj situate dhe sigurimin e mbrojtjes konsumatore në çdo kohë, i kërkoi shoqërive të brokerimit në sigurime:

- Të hartojnë Planin e Masave për vazhdimësinë e biznesit (BCP – *Business Continuity Plan*);
- Të hartojnë Planin e veprimit në lidhje me reduktimin e stafit dhe/apo orareve në punë;
- Të hartojnë Planin e veprimit për të realizuar vazhdimësinë e shërbimit ndaj klientëve;
- Të raportojnë në kohë mbi çështje të tjera, apo problematika të evidentuara gjatë punës.

Nga Autoriteti, u kërkua që shoqëritë e brokerimit të jenë vazhdimisht pranë klientëve, për të mundësuar vazhdimësinë e punës, si dhe të jenë të gatshëm për t'u dhënë këshillat, apo sugjerimet e nevojshme për të vijuar aktivitetin, duke qenë në kontakt të vazhdueshëm edhe me shoqëritë e sigurimit.

Monitorimi i ndërmjetësve të tregut të kapitaleve

Përveç monitorimeve të kryera nëpërmjet raportimeve periodike, në periudhën tetor-dhjetor 2020, Autoriteti zhvilloi inspekte në vend pranë të 5 shoqërive të njohura nga Autoriteti për të kryer veprimtarinë e agjentit për llogari të shoqërive të huaja të brokerimit që administrojnë platforma të tregtimit *online*. Këto inspekte kishin në fokus: kushtet teknike dhe organizative të këtyre shoqërive dhe kryesisht infrastrukturën për kryerjen e veprimtarisë, mënyrën e identifikimit të klientëve dhe bazat e të dhënave të tyre, mënyrën e evidentimit dhe raportimit të aktivitetit të kryer, si dhe respektimin e detyrimeve kontraktuale me shoqëritë e huaja të brokerimit.

Në fund të procesit të inspektimit, Autoriteti doli në konkluzione për secilën nga shoqëritë e inspektuara dhe mori masa konkrete, sipas problematikave të ndeshura në to. Konkretisht, Bordi i Autoritetit vendosi masa administrative për njërin prej shoqërive, si dhe la rekomandime për shoqëritë e tjera. Zbatimi i këtyre rekomandimeve po monitorohet në vazhdimësi nga Autoriteti.

5.3 Edukimi Financiar

Autoriteti vlerëson shumë të rëndësishme nevojën për informim dhe edukim financiar të konsumatorit për tregjet nën mbikëqyrje dhe rritjen e kulturës financiare në vend. Duke patur në vëmendje risitë që prodhojnë në treg veprimtaritë investuese financiare, me informacione jo gjithmonë të kuptueshme nga publiku, Autoritetit ka theksuar nevojën që konsumatori/investitori shqiptar të edukohet mbi rreziqet që paraqesin investimet dhe të marrë informacion mbi produktet e ndryshme financiare të ofruara.

Viti 2020 përmbylli Strategjinë tre vjeçare “Për rritjen e besimit të konsumatorit /investitorit në tregjet nën mbikëqyrje”. Bashkëpunimi me të gjithë aktorët e tregut dhe institucionet financiare e arsimore është konsideruar mjaft i rëndësishëm në përpjekje për të rritur nivelin e njohurive

financiare. Autoriteti ka vijuar të mbajë kontakte me universitetet partnere në vend, sipas marrëveshjeve të nënshkruara dhe ka mundësuar kryerjen e praktikave mësimore për studentë, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë, nëpërmjet Programit Kombëtar të Praktikave të Punës.

U përmbyll projekti “Vlerësimi i Njohurive dhe Krijimi i Guidave për Edukimin Financiar për tregjet financiare jobankare nën mbikëqyrjen e AMF-së”, në funksion edhe të strategjisë 5-vjeçare të institucionit. U punua për broshurën informuese për sigurimin e pronës dhe u ndërtua një fjalor termash financiarë, i cili u publikua në faqen zyrtare në Internet.

Pjesëtarë të stafit të Autoritetit morën pjesë në aktivitetin e parë të projektit të Sparkassenstiftung, mbështetur nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, me qëllim përgatitjen e trajnerëve për edukimin financiar.

Ka vijuar procesi i zhvillimit të aktiviteteve për kualifikim profesional dhe edukimin në vazhdim për profesionistët të cilët ushtrojnë veprimtari në tregjet nën mbikëqyrje. Autoriteti ka forcuar bashkëpunimin ndërinstitutional dhe ka marrë pjesë në takimet e organizuara për edukim financiar nga Rrjeti Shqiptar i Edukimit Financiar (ANFE).

Autoriteti vijon punën për hartimin e një Strategjie për Edukimin Financiar, me qëllim rritjen e njohurive financiare të konsumatorëve dhe investitorëve të tregjeve financiare.

5.4 Transparenca dhe Marrëdhëniet me Publikun

Komunikimi publik i Autoritetit, gjatë vitit 2020, u përball me sfida të reja, diktuar kryesisht nga Pandemia Covid-19. Shpërndarja e informacionit u orientua më tepër drejt komunikimit në distancë dhe nëpërmjet faqes zyrtare në Internet të AMF-së, duke përcjellë zhvillimet e reja, aktet rregullative të miratuara dhe informacionet e domosdoshme statistikore. Konsumatorët dhe investitorët në tregjet financiare jobankare u informuan për mundësinë e depozitimit *online* në faqen zyrtare të AMF-së të problematikave dhe kërkesave të tyre dhe nga ana e AMF-së u siguria përgjigja në kohë për çdo problematikë apo kërkesë.

Cilësia e informacionit të ofruar për tregjet financiare nën mbikëqyrje, ka qenë një ndër prioritetet e punës së AMF-së. Tematikat më të shpeshta të pasqyruara në media lidhen me tregun e sigurimeve. Sigurimi i pronës ishte tematika e pasqyruar më shpesh në media. Kjo u ndikua shumë edhe nga problematikat e lidhura me dëmshpërblimin e pronës pas tërmeteve të ndodhura në shtator dhe nëntor të vitit 2019. Gjatë kësaj periudhe u zhvillua një fushatë promovuese në media lidhur me nevojën e sigurimit të banesave, pronës nga dëmtimet e ndryshme nga forcat e natyrës. Edhe sigurimi motorik vijoi të ishte një ndër tematikat gjerësisht të pasqyruara në media.


Në media u trajtuan edhe ligjet për tregun e kapitaleve Ligji Nr. 62/2020, datë 14.05.2020 “Për Tregjet e Kapitalit”, Ligji “Për marrjen në kontroll të shoqërive me ofertë publike” dhe Ligji “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”, si edhe Ligji Nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, të cilat u miratuan nga Kuvendi i Shqipërisë. Vetëm gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2020, AMF nxori për konsultim publik 12 akte rregullative që lidheshin me ligjet e reja të aprovuar në tregun e kapitalit dhe atë të sipërmarrjeve të investimeve kolektive.

Një tjetër publikim i rëndësishëm ishte edhe “Karta e të drejtave të konsumatorit dhe investitorit në tregjet nën mbikëqyrje”. Karta përcakton të drejtat themelore që gëzon konsumatori dhe investitori në marrjen e shërbimeve në tregjet financiare nën mbikëqyrjen e Autoritetit, në përputhje me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e AMF-së dhe ligjeve specifike, që rregullojnë secilin nga tregjet financiare jobankare.

Gjatë vitit 2020 vijoi tendenca rritëse e numrit të klikimeve në faqen *online* të AMF-së. Numri i klikimeve arriti në 638,085 klikime nga 43,615 përdorues të faqes web. Përdoruesit e faqes web, edhe gjatë vitit 2020 kanë konsultuar mesatarisht 4 nënseksione të saj, pra nuk janë kufizuar vetëm me informacionin në ndërfaqen kryesore. Faqja *online* e AMF-së është lehtësisht e aksesueshëm në formatet e ndryshme teknologjike. Këtë e vërtetojnë edhe shifrat e klikimeve *online* të cilat tregojnë se rreth 57% e përdoruesve të faqes e kanë aksesuar atë nga desktop, ndër pjesa tjetër prej rreth 43% e kanë vëzhguar faqen *online* nga aparatet e telefonisë celulare dhe tabletet. Duke ju referuar informacioneve të publikuara në faqen *online*, pjesa më e madhe e përdoruesve kërkojnë informacione lidhur me kuadrin ligjor, rregulloret, vendimet e miratuara nga AMF, si edhe direktivat e ndryshme. Mbi 45% e klikimeve në faqen *online* janë kryer për leximin e lajmeve e publikimet e ndryshme. Një pjesë e rëndësishme e klikimeve, mbi 29% ka qenë për informacionet lidhur me sigurimin e detyrueshëm motorik.

Grafik 28: Struktura e klikimeve në faqen *online* të AMF-së, 2020

(Në %)



Faqja është e organizuar në dy gjuhë, shqip dhe anglisht dhe në këtë mënyrë ajo i shërben edhe investitorëve apo analistëve të huaj si burim informacioni për strukturën dhe zhvillimin e tregjeve financiare të sigurimeve, pensioneve private dhe letrave me vlerë në Shqipëri. Faqja vizitohet edhe nga vizitorë jashtë vendit dhe pjesa më e madhe e tyre janë nga vende si nga SHBA, Italia, Gjermania, Kosova, Holanda, Anglia, India, Kanadaja dhe Spanja.

Botimet e AMF-së të realizuara në vitin 2020

- Buletini Zyrtar
- Raporti Vjetor 2019
- Raporti i Mbikëqyrjes 2019
- Gjeografia e Sigurimeve

Publikime elektronike të AMF-së

- Periodiku mujor informativ
- Buletini Statistikor i tregut të sigurimeve
- Buletini Statistikor i tregut të letrave me vlerë
- Buletini Statistikor i tregut të pensioneve private vullnetare
- Buletini Statistikor i tregut të fondeve të investimeve

Kapitulli 6

ORGANIZIMI INSTITUCIONAL

6.1 Burime Njerëzore

Gjatë vitit 2020 Autoriteti ka vijuar punën në përmbushje të funksioneve dhe kompetencave të tij. Bazuar në "Procedurën e Mbikëqyrjes në Raste Krizash" të Autoritetit, u aktivizuan ekipet e punës, për të siguruar vazhdimësinë e aktiviteteve për një mbikëqyrje efektive të tregjeve në kushtet e një situate të jashtëzakonshme. Gjatë periudhës së mbylljes dhe në periudhën që pasoi u morën masat e nevojshme për të siguruar që çdo punonjës i Autoritetit të mund të punonte në distancë dhe proceset e punës të vijonin normalisht, duke filluar nga akseset e sistemeve informative, raportimet e tregut në kohë reale, ofrimin e pajisjeve teknologjike të nevojshme për punë në distancë, etj.

Aktiviteti i burimeve njerëzore ka synuar krijimin e një mjedisi pune të përshtatshëm dhe motivues për punonjësit, rritjen profesionale, por edhe përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve administrative, në mbështetje të realizimit të objektivave strategjike të Autoritetit.

Puna përgjatë vitit 2020 konsistoi në:


- Optimizimin e strukturës organizative të AMF-së;
- Organizimin e punës për sigurimin e vazhdimësisë operacionale në kushtet e pandemisë shkaktuar nga Covid-19;
- Zhvillimin profesional të punonjësve;
- Aktivitete për përgjegjësinë sociale.

Optimizimi i strukturës organizative të AMF-së


Në përgjigje të kërkesave të brendshme të Autoritetit për ridimensionimin e disa funksioneve, për reflektimin e ndryshimeve të fundit në kuadrin ligjor të fushës së veprimtarisë së Autoritetit si dhe për t'iu përshtatur kërkesave në përballimin e situatës së jashtëzakonshme, me Vendimin e Bordit nr. 107, datë 29.07.2020, u miratua struktura e re organizative e AMF-së.

Plotësimi i strukturës dhe organikës së AMF-së u realizua nëpërmjet një plani të strukturuar, bazuar në nevojat më kryesore të njësive të Autoritetit për burime njerëzore, për një përshtatje më të mirë të vendeve të punës me profilet, përvojën dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

Konkretisht, u riorganizuan funksionet e mbrojtjes konsumatore dhe monitorimit të ndërmjetësve në një departament të ri, funksionet e licencimit u qendërzuan në një njësi të vetme. Gjithashtu, u krijua Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregjeve Financiare të Regjistrave të Shpërndarë, si domosdoshmëri për mbulimin e detyrave specifike të punës.

Grafik 29: Ndarjet funksionale sipas Departamenteve (Në %)

Aktualisht, mosha mesatare e stafit është 41 vjeç. Përfaqësimi gjinor në Autoritet, raporti meshkuj - femra në nivel drejtues është 44.4% kundrejt 55.6%.

Grafik 30: Struktura e punonjësve të AMF-së sipas grupmoshës (Në %)

Vazhdimësia operationale në kushtet e pandemisë Covid-19

Kushtet e reja të krijuara për shkak të pandemisë në vitin 2020, sollën nevojën për ridimensionimin e planit për organizimin e punës me qëllim realizimin e detyrave të Autoritetit me burimet njerëzore të mundshme në dispozicion.

Njësia e burimeve njerëzore në këtë proces, u përball me specifika të reja në çështjet e organizimit dhe menaxhimit të stafit në situata të jashtëzakonshme. Për këtë arsye, për të reaguar sa më shpejt u ndërmorën një sërë masash, më konkretisht:

- U hartua një plan i detajuar i menaxhimit të stafit në kushtet e pandemisë duke përshtatur dhe kryer praktika të përditshme të punës për të ruajtur shëndetin dhe mirëqenien e stafit dhe njëkohësisht për të siguruar vazhdimësinë e aktivitetit;
- U hartuan dhe u miratuan procedurat dhe rregullat e reja për zbatimin e masave higjieno-sanitare të kërkuara;
- U vendos një orar pune fleksibël për punonjësit, në oraret e lejuara dhe u siguria infrastruktura e nevojshme për të realizuar me efektivitet punën në distancë;
- U hartua një kalendar i veçantë pune për punonjësit me sëmundje kronike apo dhe punonjësve që kishin nevojë për përkujdesje të fëmijëve;
- Në mënyrë të vazhdueshme është komunikuar me stafin nëpërmjet emailit zyrtar për lajmërimet apo edhe këshillim për menaxhimin e stresit në mënyrë të përditshme gjatë këtij realiteti të ri.

Gjatë pandemisë u zbatuan protokollet e mirëpërcaktuara në aktet e brendshme të Autoritetit, u hartua një plan specifik i trajnimeve të stafit në përballimin e këtyre situatave, si dhe u zhvilluan stres-teste për të vlerësuar funksionimin e planit të vazhdimësisë.

Zhvillimi profesional dhe përgjegjësia sociale

Në fushën e burimeve njerëzore, Autoriteti i kushton rëndësi të veçantë zhvillimit profesional të punonjësve. Viti 2020 pati veçori në mënyrën e ndjekjes së trajnimeve, pasi ato janë ndjekur në distancë nëpërmjet webinarëve, për shkak të situatës së shkaktuar nga Covid-19. Gjatë vitit, rreth 53% e stafit teknik ka ndjekur aktivitete trajnuese.

Autoriteti synon të forcojë më tej vlerat shoqërore, të rrisë përgjegjësinë sociale dhe ndërgjegjësimin e punonjësve, nëpërmjet aktiviteteve vullnetare në ndihmë të komuniteteve në nevojë dhe të situatave emergjente. Në kushtet e pandemisë së COVID-19 dhe të shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, drejtuesit e Autoritetit kontribuan vullnetarisht në Fondin anti Covid -19, duke shprehur solidaritetin dhe ndihmesën e tyre në përballimin e kësaj situate të vështirë. Në kuadër të ndjeshmërisë dhe reagimit qytetar, punonjësit e Autoritetit, në muajin dhjetor 2020, në pragun e festave të fundvitit, përmes një qendre sociale kanë kontribuar financiarisht në baza vullnetare për të ofruar ndihmë dhe përkujdesje të të pastrehëve dhe atyre pa përkrahje sociale.

6.2 Sistemet e Teknologjisë së Informacionit

Gjatë vitit 2020 janë kryer zhvillime sa i takon infrastrukturës kompjuterike si dhe përmirësimeve të sistemeve informative ekzistuese. Këto zhvillime janë kryer duke iu referuar planifikimeve, por një pjesë e tyre jashtë planifikimeve, në funksion të situatës që diktoi pandemia Covid-19.

Gjatë periudhës së mbylljes dhe në periudhën që pasoi, Drejtoria e IT mori masat e nevojshme për të siguruar që çdo punonjës i AMF të mund të punonte në distancë dhe proceset e punës të vijonin normalisht, duke filluar nga aksesimi i sistemeve informative, raportimet e tregut në kohë reale, ofrimin e pajisjeve teknologjike të nevojshme për punë në distancë, etj. Masat e ndërmarra gjatë kësaj periudhe u reflektuan dhe në Planin e Vazhdimësisë së Aktivitetit të miratuar në fund të vitit 2020.

Aktivitetet kryesore të ndodhura gjatë vitit 2020 përfshijnë:

- Mirëmbajtja dhe përmirësimi i rrjetit kompjuterik qendror në AMF, si dhe në sistemet e ruajtjes pranë AKSHI (*backup*);
- Përshtatja e infrastrukturës ekzistuese në kushtet e punës në distancë nga stafi gjatë periudhës së mbylljes me qëllim vijueshmërinë e punës;
- Përgatitja dhe konfigurimi i sistemeve të brendshme të AMF-së, si administrimi i postës elektronike, e cila kaloi pranë infrastrukturës së AKSHI;
- Investime në blerje të pajisjes elektronike, veçanërisht ato që mundësojnë punën në distancë;
- Përditësimi i faqes zyrtare *online* të AMF-së me shërbime të reja për publikun, si dhe përmirësimin e rubrikës së transparencës;
- Ndjekja dhe zbatimi i politikave të sigurisë së informacionit, duke ruajtur konfidencialitetin, integritetin dhe besueshmërinë e informacioneve të AMF-së;
- Zhvillimi dhe përshtatja me *web* serviset e reja të institucioneve me të cilat AMF shkëmben informacion në sistemet e saj;
- Monitorimi dhe përmirësimi i sistemit të raportimit *online* për tregun e fondeve të investimeve dhe të pensione;
- Përmirësimet në sistemet ekzistuese si Regjistri i Dëmeve, sistemi i inventarizimit, i pagave, etj.

Disa nga zhvillimet kryesore të sistemeve në vitin 2020 janë:

Digjitalizimi dhe modernizimi i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit

COVID-19 bëri të domosdoshme zhvillimet dhe përmirësimet në teknologjinë dhe digjitalizimin e shumë proceseve të punës. Në këtë kuadër, Autoriteti ka ngritur një grup pune në funksion të shndërrimit digjital të proceseve që lidhen me raportimin e informacioneve në AMF, si dhe shërbimet që mund t'i ofrohen qytetarëve në distancë (*online*). Për realizimin e analizës paraprake është punuar ngushtësisht me grupet përkatëse këshillimore, me ekspertë të fushës nga tregjet nën mbikëqyrje, si dhe me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI-t). AMF ka analizuar të rejat teknologjike të lidhura me sigurinë kibernetike, sistemet e dedikuara për autoritetet mbikëqyrëse (SuppTech) si dhe për tregun e sigurimeve (Insurtech) duke synuar adoptimin e tyre apo dhe ndërgjegjësimin e tregjeve për përparësitë që rrjedhin prej digjitalizimit. Në kuadër të digjitalizimit të shërbimeve, në bashkëpunim dhe me AKSHI-n ka përfunduar analiza teknike si dhe dokumentacioni i nevojshëm për prokurimin e zhvillimeve të nevojshme për

integrimin e AMF me platformën qeveritare e-Albania për disa nga shërbimet që ofron Autoriteti të cilat priten të sjellin shërbim më të shpejtë për qytetarët, duke rritur dhe eficiencën e vetë Autoritetit. Këto zhvillime janë në fazën e prokurimit.

Në kuadër të digjitalizimit të proceseve të brendshme të AMF-së janë realizuar hulumtimet përkatëse në lidhje me kërkesat e diktura nga pandemia, si dhe KLSH, të cilat priten të zbatohen gjatë 2021. Janë përgatitur analizat përkatëse të “log-eve” të quajtur në gjuhën teknike “SIEM” (*Security Information and Event Management*) dhe të sistemeve “*Smart working*”, sisteme që do të mundësojnë punonjësit e AMF duke rritur ndjeshëm produktivitetin e punës, në kushtet e punës pranë zyrave, si dhe gjatë punës në distancë.

Sistemi i Raportimit Online

U përditësua ambienti ku vepron Sistemi AMF In-Reg, si një sistem që mundëson raportimin në mënyrë elektronike të shoqërive të sigurimit në AMF.

Sistemi SRF, i cili ka për qëllim mundësimin e raportimit nga operatorët e tregut të fondeve të investimeve dhe pensioneve private vullnetare, u zhvillua e përmirësua me qëllim gjenerimin e raporteve të plota për gjithë tregjet në mbulim. Pavarësisht problematikave që solli pandemia, u realizua krijimi dhe përmirësimi i raporteve të shumta me qëllim përmbushjen e funksioneve dhe detyrave për punonjësit e AMF-së.

Sistemi qendror në dhomën e serverëve

Gjatë vitit 2020 u përmirësua rrjeti kompjuterik qendror në AMF, si dhe u rikonceptua sistemi i ruajtjes së serverave brenda institucionit, por edhe pranë AKSHI-t në infrastrukturën dytësore (*disaster recovery site*). Në përfundim të tij, ky proces solli përfitime në përditësimin e rregullt të “*backup-eve*”, duke rritur sigurinë në nivel rrjeti, si dhe në nivel të dhënash.

Regjistri Elektronik Online i Sigurimit të detyrueshëm motorik

Një ndër sistemet që merr vëmendje të veçantë është Regjistri Elektronik Online i Shitjeve të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik, i cili gjatë vitit 2020 pësoi disa zhvillime si rezultat i sistemeve të reja të institucioneve me të cilat bashkëvepron sistemi i AMF-së. Periudha e kalimit nga sistemi ekzistues në sistemin e ri u përballua me sukses, pa krijuar problematika në procesin e shitjeve dhe aktualisht situata paraqitet e stabilizuar.

Përveç sa më sipër, specialistët e TI-së kanë ofruar mbështetje të vazhdueshme për problematika që lidhen me funksionimin dhe aksesin në Regjistrin e Shitjeve nga shoqëritë e sigurimeve.

6.3 Auditi i Brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm e ka orientuar aktivitetin në përmbushjen dhe realizimin e objektivave të përcaktuara në Planin Strategjik dhe Vjetor të miratuar me Vendim Bordi nr. 205, datë 14.10.2019.

Njësia e Auditimit të Brendshëm ka funksionuar me strukturë të plotë, me një drejtues të njësisë, një auditues të profilit të përgjithshëm financiar, si dhe një auditues të Teknologjisë së Informacionit dhe Vlerësimit të Rrezikut. Veprimtaria audituese është bazuar në procedurat e auditimit të rregulluara në aktet ligjore në fuqi dhe në standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm.

Puna audituese është përqendruar kryesisht në fushat për të cilat Njësia e Auditimit të Brendshëm, ka vlerësuar një nivel të mesëm rreziku. Njësia e Auditimit të Brendshëm e ka konsideruar cilësinë e auditimit, jo vetëm faktorin më të rëndësishëm në prezantimin auditimit (raportit) dhe rezultateve të tij: opinionit, konkluzioneve, gjetjeve dhe rekomandimeve; por edhe në rritjen e përgjegjshmërisë së audituesve gjatë auditimit dhe subjekteve të audituara për zbatimin e rekomandimeve.

Situata e krijuar nga pandemia e COVID-19 pati ndikim dhe në fushën e auditimit. Angazhimet e auditimeve të kryera gjatë vitit 2020 janë fokusuar në dhënien e opinionit mbi mjaftueshmërinë e kontrolleve të brendshme për funksionet/proceset e audituara, përfshirë dhe aplikacionet mbështetëse për kryerjen e aktiviteteve. Rekomandimet e lëna kanë synim përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, uljen e nivelit të rrezikut dhe përmirësimin e proceseve në të ardhmen.

STRATEGJI DHE OBJEKTIVA

Gjatë vitit 2021 drejtimet kryesore të veprimtarisë së Autoritetit do të përqendrohen në objektivat e mëposhtme:

- Nxitja e qëndrueshmërisë financiare nëpërmjet mbikëqyrjes efektive të tregjeve;
- Plotësimi i kuadrit ligjor/rregullator dhe zhvillimi i tregjeve;
- Rritja e kapaciteteve mbikëqyrëse përmes projekteve të asistencës teknike;
- Digjitalizimi dhe përmirësimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit;
- Mbrojtja e personave të siguruar dhe investitorëve.

1. Nxitja e qëndrueshmërisë financiare nëpërmjet mbikëqyrjes efektive të tregjeve

Autoriteti do të avancojë qasjen drejt mbikëqyrjes së plotë me bazë rreziku për tregjet nën mbikëqyrje. Synohet cilësi e lartë e mbikëqyrjes, bazuar në pajtueshmërinë me kërkesat rregullatore, nëpërmjet identifikimit të rreziqeve, vlerësimit të administrimit të rrezikut, si dhe hapat e nevojshëm për zbutjen e rrezikut të evidentuar, duke identifikuar dhe përmirësimet e mundshme. Do të vijohet me përmirësimin dhe unifikimin e procedurave të inspektimit, me qëllim standardizimin e tyre për të gjitha subjektet nën mbikëqyrje dhe përafrimin me praktikën ndërkombëtare.

Nisur nga dinamika dhe zhvillimet e tregut të sigurimeve, AMF ka nisur procesin e vetëvlerësimit të përputhshmërisë së kuadrit të saj ligjor dhe rregullator me Parimet Themelore të Sigurimeve (*Insurance Core Principles, ICP*), me synim përafrimin me këto parime, të cilat janë miratuar nga Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS). Ky proces do të vijojë me një rishikim të këtij vlerësimi nga anëtarët e kësaj organizate, me qëllim identifikimin e nevojave për ndryshime të mundshme ligjore apo rregullatore, në linjë dhe me standardet dhe praktikën më të mira në mbikëqyrjen e sigurimeve. Sa i përket këtij tregu, fokusi do të jetë gjithashtu te ngritja e kapaciteteve institucionale, në lidhje me mbikëqyrjen e grupeve të sigurimeve, si dhe zhvillimin e një metodologjie të përshtatur për nevojat e tregut, bazuar në treguesit sasiore të riskut.

2. Plotësimi i kuadrit ligjor/rregullator dhe zhvillimi i tregjeve

Autoriteti është i angazhuar për të përmyllur procesin e hartimit të akteve rregullatore, në funksion të tre ligjeve të miratuara nga Kuvendi në vitin 2020 (Ligji “Për Tregjet e Kapitalit”, “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive” dhe “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”). AMF do të fokusohet gjithashtu në hartimin dhe miratimin e akteve

rregullatore në zbatim të Ligjit nr. 32/2021, datë 16.03.2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

Autoriteti synon të analizojë rishikimet e nevojshme në disa ligje të rëndësishme si në funksion të mbarëvajtjes së tij institucionale, ashtu edhe në funksion të zhvillimit të tregjeve nën mbikëqyrje. Në këtë kuadër, AMF synon të rishikojë Ligjin nr. 9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” i ndryshuar, Ligjin nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”, duke e përshtatur atë me Direktivat Evropiane, si edhe Ligjin nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

Plotësimi i kuadrit ligjor pritet jo vetëm të modernizojë tregjet, por edhe të krijojë mundësi të tjera për zhvillimin e tyre. Autoriteti do të vijojë nismat dhe angazhimin e tij në funksion të nxitjes së zhvillimit dhe qëndrueshmërisë së tregjeve financiare nën mbikëqyrje. Në këtë kuadër, do të vijojë procesi i hartimit dhe më pas zbatimit të dokumentit strategjik “Për zhvillimin e tregjeve të kapitalit”.

3. Rritja e kapaciteteve mbikëqyrëse përmes projekteve të asistencës teknike

Autoriteti do të ndjekë në vazhdimësi zbatimin e projektit “Forcimi i kapaciteteve të Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Sigurimeve” i financuar nga Sekretariati Zviceran për Çështje Ekonomike (SECO) dhe i mbështetur nga Banka Botërore. Ky projekt synon forcimin e kapaciteteve të Autoritetit për rregullimin dhe mbikëqyrjen e këtyre dy tregjeve, në funksion të zhvillimit të tyre, si edhe rritjes së ndërgjegjësimit dhe edukimit financiar. Autoriteti është gjithashtu pjesë e projektit të asistencës të Korpusit të Vullnetarëve për Shërbimet Financiare (FSVC), me qëllim rritjen e kapaciteteve dhe forcimit të luftës për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Autoriteti do të vijojë të ketë në fokus zhvillimin profesional dhe motivimin e punonjësve për arritjen e objektivave, duke i përfshirë ata në trajnime të profilizuara sipas dinamikës së tregjeve nën mbikëqyrje, ose në realizimin e trajnimeve bazë për punonjësit e rinj.

4. Digjitalizimi dhe përmirësimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit

Autoriteti do të ketë në fokus modernizimin e vazhdueshëm të infrastrukturës së teknologjisë së informacionit dhe përmirësimin e sistemeve të raportimit. Në lidhje me sistemet e menaxhimit të informacionit, synohet përmirësimi i raporteve ekzistuese dhe rritja e numrit të raportimeve sipas kërkesave të mbikëqyrjes. Synohet të realizohen përmirësime dhe zhvillime të mëtejshme teknologjike në Regjistrin Online të Shitjeve dhe të Dëmeve në kuadër të zbatimit të ligjit të ri për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit. Një tjetër objektiv është digjitalizimi i disa

shërbimeve për qytetarët, me qëllim heqjen e barrierave, uljen e kostove dhe rritjen e eficiencës në mbikëqyrje.

Autoriteti do të mbështesë iniciativat e subjekteve nën mbikëqyrje për përdorimin e teknologjisë dhe inovacionit në funksion të zhvillimit të tregjeve, nëpërmjet zgjerimit të produkteve të reja.

5. Mbrojtja e personave të siguruar dhe investitorëve

Autoriteti do të fokusohet në përafrimin me praktikat e Direktivës së Bashkimit Evropian 2016/97 “Mbi shpërndarjen e produkteve të sigurimit”, e ndryshuar (EU 2016/97 *Directive of the European Parliament and of the Council on Insurance Distribution*). Ky përafrim do të synohet kryesisht në drejtim të informimit parakontraktual të klientit për produktet e sigurimit sipas një dokumenti të standardizuar. Autoriteti do të monitorojë në vijimësi ndërmjetësit që operojnë në tregjet nën mbikëqyrje, të konsideruar si vija e parë e prezantimit të shoqërive me konsumatorët dhe investitorët.

Paralelisht, Autoriteti do të vijojë nismat për rritjen e njohurive financiare për tregjet nën mbikëqyrje. Gjithashtu, AMF do të publikojë informacion mbi ecurinë e tregjeve nën mbikëqyrje, paralajmërime në funksion të mbrojtjes së investitorëve, si edhe do të angazhohet në nisma e aktivitete promovuese dhe edukuese për tregjet financiare jobankare.

SHTOJCA A

Struktura Organizative e AMF-së, 2020

